

Korrik 2018
Numri: 124
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro



Nga
**DUHET të
FILLOJMË**



revistaetika



progresibotime

*Shtëpia botuese Progresi
vjen me 6 libra të rinj, të cilët
do të ushqejnë botën tonë shpirtërore
dhe do t'i japin drejtim jetës sonë
individuale dhe shoqërore.*

TË
RINJ

Një këshillë
1001 mësimë
350 Lekë
3 Euro



Si edukonte
Ai (s.a.v.s.)
150 Lekë
1 Euro



101 Parime
në shërbim
200 Lekë
1.5 Euro



Shoqetësimi
për brezat
200 Lekë
1.5 Euro



Udhëtimi
drejt Zotit
200 Lekë
1.5 Euro



Shërbimi
200 Lekë
1.5 Euro

Korrik 2018

VITI: XII

NUMRI: 124

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

REDAKTOR

Zija Vukaj

PËRKTHYES

Albert Halili

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 340 6182

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

WEBSITE

www.progresibotime.com

KOSOVË

Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 45 639 143

Prishtinë; Kosovë

Mob: +377 44 566 577

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Makedonija

Mob: +389 7145 6003

ABONIMI VJETOR

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Kjo është ngjarja, largimi i njerëzve/shoqërive nga shpallja, pozicionimi i tyre kundër saj dhe devijimi i tyre si rezultat i këtij fenomeni, apo qëndrimi i shpalljes në një luginë dhe i atyre në një luginë tjetër.

Për shkak se ky proces funksionon me kohë të gjatë dhe pa zë, krahas këtij largimi dhe qëndrimi në luginë të ndryshme vazhdon derisa njerëzit/shoqëritë, pa e kuptuar mendojnë se janë në rrugë të drejtë, mendojnë se konceptimi dhe jetesa e tyre fetare është në përputhje me shpalljen, se e ruajnë identitetin e tyre dhe se e kënaqin Allahun duke mashtruar veten.

Siç ishte kështu gjendja e popujve të mëparshëm, që kishin devijuar nga shpallja edhe struktura e popullit arab në kohën e xhahiljetit, kur Muhamed u bë Pejgamber nuk kishte ndonjë ndryshim nga ajo. Edhe ata pohonin se akoma janë në rrugën e Ibrahim dhe se janë të lidhur ndaj fesë së tij. Por Kurani thotë se Ibrahim ishte Hanif/i lidhur me fenë e tevhidit, se nuk ishte prej politeistëve. I paralajmëron ata se janë në rrugë të gabuar dhe se mendojnë shumë gabim. Allahu Teala, thotë:

“Me të vërtetë, Ibrahim ka qenë prijës shembullor (me të gjitha virtytet e mira), i përlulur para Allahut, me besim monoteist dhe nuk ka qenë prej idhujtarëve.” (Nahl, 120)

Kurani duhet të mbahet gjithmonë në qendër, në pozitën e subjektit dhe në pikën e autoritetit përcaktues, në mënyrë që mendjen, besimin, personalitetin dhe jetën tonë, ta ndërtojë me masat e shpalljes. Të na pastrojë, të na japë nder e krenari dhe të na bëjë që të fitojmë kënaqësinë e Zotit.

Nëse nuk veprojmë kështu, por i afrohem Kuranit me një mendje që e kanë ndotur e kushtëzuar paragjykimet, me synimin për të qëndruar larg ndriçimit të tij dhe për të kërkuar dispozita që mund të mbështesin mendimet tona, të cilat janë produkt i epsheve, Kurani nuk do të na i hapë thesaret e tij, nuk do të na udhëzojë dhe nuk do të na ndriçojë.

Përkundrazi, për të aprovuar përvetësimet që kemi, ne duhet t'i kuptojmë mirë ajetet e Allahut, të vërtetojmë të drejtën tonë dhe dëshirat t'ia përshtasim Kuranit. Por nëse përpiqemi që Kurantin t'ia përshtasim dëshirave tona, ai do të jetë shkak kryesor për të na zvarritur në pozita të poshtëruara dhe të trishtuara.

Zoti i Madhëruar na ruajtë të gjithëve, që të mos zvarritemi në gjendje të tilla devijuese dhe mos na bëftë prej atyre që nuk përfitojnë nga Kurani, për shkak të një konceptimi të gabuar, ndërkohë që e lexojmë atë çdo ditë.


Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.



Martesa, pothuajse një mrekulli
Mustafa Erish

18

Përmbajtja



14

Bindja
Doç. dr. Fahredin Jëlldëz



Edukata dhe mirësjellja
Osman Nuri Topbash

34



30



44

Udhëzimi i Kuranit në paqen familjare
Dr. Adem Ergyl

- 5 Koha e vëllazërisë**
Ahmet Tashgetiren
- 10 Nga duhet të fillojmë që ta lexojmë dhe mësojmë Islamin?**
Mustafa Erish
- 16 Dashuri dhe vëllazëri**
Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz
- 20 Mere Hysejn Pasha**
Dr. Ardian Muhaj
- 22 Gjendja është mesazhi**
Edison Çeraj
- 26 Dy bazat e identitetit të myslimanit**
Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan
- 29 Plaku i urtë**
Urtësi
- 30 Njeriu në hapësirë**
Muaz Erdem




47

- Ekuilibri ndërmjet fesë dhe botës** 40
Prof. dr. Sulejman Derin
- Refleksione -5** 42
Nuredin Nazarko
- Jeta si ripohim i paktit të kryehershëm me Zotin** 46
Vehap S. Kola
- Boshti i Teuhidit** 48
Idris Arpat
- Istigfari, orientim dhe përtëritje** 54
M. Lutfi Arslan
- Pse je i mërzitur?** 56
Sait Çamllëxha
- Antibiotikë që nuk skadojnë** 58
Shëndet
- Zbulohet planeti ku një vit zgjat 20 ditë** 60
Shkencë



51

Falëndero Zotin!
Neslihan Nur Turk



Akoma në gjumë
Muhamed Gazali

48



Koha e vëllazërisë

— Ahmet Tashgetiren —

Vallë, a kemi paqe me veten? A janë të gjitha organet e trupit në harmoni me njëra-tjetrën?

A janë mendja dhe shpirti në paqe me egon tonë? A janë trupi dhe shpirti ynë në gjendjen e prehjes apo kënaqësisë që prodhon dashuria? Apo mos janë në gjendje nevoje me to?

A jeton familja, e cila duhet të jetë edhe vatra e dashurisë, por njëkohësisht edhe atmosfera e lumturisë ku gjendet dashuria, brenda një dashurie të thellë? A janë marrëdhëniet mes bashkëshortëve, mes vëllezërve, mes prindërve dhe fëmijëve, marrëdhënie mëshire dhe dashurie të thellë? Apo mos vallë dosjet e shkurorëzimit që vihen palë-palë çdo ditë, lajmërojnë ftohtësinë që kaplon zemrat brenda familjes? Çfarë paralajmërojnë krimet brenda familjeve?

A ekziston ndjenja e thellë e dashurisë dhe dedikimi në marrëdhëniet e tubimeve dhe bashkimeve të formuara për shërbim në rrugën e Allahut? Apo mos vallë ndjenjat që brejnë zemrat dhe shkrijnë sinqeritetin, siç janë mendjemadhësia, dëshira për të dalë në plan të parë, dëshira për leadership, përvojimi, kanë marrë dhenë së bashku me njerëzit dhe janë duke asgjësuar virtytet e hijshme?

Çfarë sundon në marrëdhëniet ndërmjet këtyre grupeve që i shërbejnë fesë? Opinioni i mirë për njëri-tjetrin, lutjet që tjetri të jetë i suksesshëm aq sa dëshirojmë të jemi edhe ne vetë, lutje mëshire dhe dashurie për njëri-tjetrin? Një miqësi e ngrohtë? Apo mos ndoshta edhe zili për mëshirën hyjnore? Të qëmtosh të metat e tjetrit? Të cilësosh të mangët çdo punë të tjetrit? Të përgojosh? Madje edhe të shpifësh? Të përpiqesh të ngresh pengesa të vazhdueshme, që të presësh rrugën e të tjerëve drejt xhenetit?

Përkatësia ndaj një medhhebi, që është formuar në rrjedhën e historisë islame, a është lufta jonë që çdo gjë tonën ta “shndërrojë në çdo gjë për Allahun” apo përpjekje që të përjashtojmë të tjerët “nga rruga e Allahut”? Të kapur nga ndjenjat e garës për hir të Allahut, a shohim me mirëkuptim përpjekjet më të mëdha që bëjnë të tjerët në këtë drejtim dhe ndjejmë gëzim apo përpiqemi që të pengojmë njëri-tjetrin në këtë rrugë, duke futur shkopinj në rrota? Çdo të thotë të hedhësh bomba nëpër “faltoret” e pjesëtarëve të këtij apo atij medh-

hebi mysliman, kur feja jonë islame është treguar aq delikate, saqë ka urdhëruar që të mos preken as faltoret e feve të tjera? Pra, çfarë shkruhet në regjistrin e veprave të atyre që hedhin bomba në vendet ku i bëhet sexhde Allahut? Si do ta shpien atë regjistër veprash përpara Allahut?

Po fakti që dy bashkësi myslimane luftojnë me njëra-tjetrën, në emër të kombeve dhe shteteve të ndryshme, të cilave u përkasin? Me vite të tëra... Duke u derdhur gjaku i dhjetëra dhe qindra mijëra njerëzve? Cila përkatësi myslimane e ushqen këtë gjë? Çfarë qëndrimi pret prej Krijuesit ai që thotë se “është mysliman iranian, prandaj ka vuarë kaq ose aq myslimanë irakenë” apo myslimani iraken që shpalos një listë të ngjashme masakrash? A nuk do të takohen këta njerëz me njëri-tjetrin të nesërmen nën flamurin e Lavdërimit të të dërguarit të Allahut? Mos vallë do të zhveshin shpatat dhe do të derdhin bomba mbi njëri-tjetrin, kur të takohen nën atë flamur? A do të kërkojnë edhe nën atë flamur që të marrin jetë njerëzish? A do të përtypin mishin e vëllait mysliman që kanë vuarë?

Po dëshira për t’u quajtur më superiorë, që ushqejnë ndaj njëri-tjetrit popujt myslimanë, që jetojnë brenda një shteti... dëshira për t’u hequr me të madhe... Tregtia e tyre prej urrejtjeje dhe smire... Prendimet e tyre për epërsi ndaj njëri-tjetrit, përjashta afërsisë së Allahut... Në hapësirën e mahsherit, aty ku kombet dhe shtetet humbasin kuptimin e tyre, për cilin konflikt do të hidhen njerëzit? Çfarë do të shpien ata përpara Allahut në ditën e gjykimit? Smirën që ushqejnë për njëri-tjetrin apo ndjenjën e robërisë ndaj Allahut?

A mund të vlerësohet kjo si diçka prej myslimani?

Pa mendo njëherë rreth “begatisë që të ka dhuruar Allahu”...

Kujtoni atë begati dhe...

Kapuni fort pas litarit të Allahut...

Ja pra, ju që ishit armiq të njëri-tjetrit...

Që ishit në skaj të gropës së zjarrit...

Zemrat tuaja ishin shndërruar në gropa prej zjarri. Smira, urrejtja dhe armiqësia jua kishin kapluar zemrat tuaja...

Allahu ju shpëtoi juve prej aty.

“Zemrat tuaja u ngrohën për njëra-tjetrën dhe me begatinë e Zotit ju u bëtë vëllezër të njëri-tjetrit.” (Ali Imran, 103.)

Vëllazëria...

Krijesa që ngroh zemrat me njëra-tjetrën dhe e konsiderojmë si “vëllazëri” në marrëdhëniet tona,

është mirësi nga Krijuesi ynë.

Zoti caktoi parimin që **“Besimtarët janë vëllezër me njëri-tjetrin”**.

Afrimi i zemrave me njëra-tjetrën ka qenë përherë i vështirë.

Ja çfarë i thotë Krijuesi të dërguarit të Tij besnik:

“...Sikur të shpenzoje tërë pasurinë që gjendet në tokë, nuk do të mund t’i bashkoje zemrat e tyre, por Allahu i bashkoi ato. Ai është vërtet i Plotfuqishëm dhe i Urtë.” (Enfal, 63.)

Zoti bëri që ne ta duam imanin...

Ai e gdhendi besimin në zemrat tona...

“Ai bëri që ne të mos pëlqejmë mosbesimin, largimin nga rruga e drejtë dhe gjynahun...” (Huxhurat, 7-8.)

Pra zemrat janë lidhur pas kritereve të Zotit.

Kështu u arrit që zemrat të afrohen me njëra-tjetrën.

Kështu u realizua vëllazëria.

I Dërguari i Allahut e pati ndërtuar nga mesi i shoqërisë, që njihej si “shoqëria e injorancës” këtë shoqëri dashurie nën dritën e vahjit, me shenjat e Zotit të Plotfuqishëm, duke u strehuar nën ndihmën dhe favorizimin (lutuf) e Tij, por dhe duke punuar sikur të ishte duke “thurur zemrën e ndjeshme” të kësaj shoqërie.

Populli injorant e kishte mposhtur krenarinë e tij të sëmurë...

Shoqëria e kishte mposhtur krenarinë e saj të sëmurë...

Gjuha e lëkurës, raca dhe gjuha që flitet, e patën mposhtur krenarinë e tyre të sëmurë...

Pasuria, paraja, familja dhe rrethi familjar, e patën mposhtur krenarinë e tyre të sëmurë...

Në zemra që gdhendur kriteri se “arabi nuk është më i mirë se joarabi, sepse përparësia matej vetëm me devotshmëri”... ndonëse që arab, populli i tij që lidhur pas një konsistence humane që vinte në vend të parë cilësinë e njeriut, devotshmërinë dhe varësinë ndaj Krijuesit.

Ata që dridheshin nga madhështia e tij, profeti i kishte qetësuar me fjalët: **“Unë jam djali i një gruaje prej fisit kurejsh, që ushqehet me mish të thatë.”**

Ai që larguar nga kjo jetë duke shpallur me fjalët: **“Binduni ndaj kryetarit tuaj, edhe në qoftë se ai është një i ri, etiopian me lëkurë të zezë si rushi i thatë”,** se madje edhe maja e drejtimit të shoqërisë nuk u takon statuseve të veçanta.

Ai kishte shkelur mbi ndjenjat e veta, kur kishte falur edhe vrasësin e xhaxhait të tij më të dashur; edhe personin që i kishte shqyer mushkëritë dhe ia kishte ngrënë të gjalla...

Ai kishte shkallmuar vrerin dhe urrejtjen e formuar mes fiseve Evs dhe Hazrexh ndër vite luftëra.

Duke realizuar vëllazërimin mes besimtarëve të Mekës me ata të Medinës, ai pati arritur të gdhendte në zemra se pronësia mbi paratë dhe objektet, në një shkallë të caktuar është vetëm relative...

Ja, në këtë pikë përreth tij gjendeshin:

Ebu Bekri, që ishte arab...

Selmani persian...

Suhejbi romak...

Bilali etiopian...

Duke qëndruar krahu për krahu për të formuar umetin...

Kjo ishte një bashkësi besimi...

Duke gdhendur në histori përfundimin se “kjo është shoqëria që ndërton feja islame”.

Një ditë Ebu Dheri, njëri nga besimtarët që qëndronte pranë të dërguarit të bekuar, i pati thënë Bilal etiopianit: “O djali me nënë të zezë”... Bilali qe pikëlluar shumë nga këto fjalë. Atë që ngjau, ia patën treguar të dërguarit të Allahut. Ai e pati thirrur Ebu Dherin dhe e pati vënë në dijeni për mërzinë që kishte ndjerë nga ato fjalë. Fjalët e tij: “O Ebu Dher, fëmija me nënë të bardhë nuk ka ndonjë epërsi ndaj fëmijës me nënë të zezë”, qenë bërë përmendore të kriterit islam të humanizmit.

Pasi e kishte kuptuar se sa fjalë të rëndë kishte thënë, Ebu Dheri qe shtrirë përdhe dhe i pati thënë Bilalit:

- Nuk ngrihem, pa më shkelur ti faqen me këmbë.

Bilali nuk pranonte një gjë të tillë, por e kishte kapur Ebu Dherin për krahu dhe e kishte ngritur në këmbë. Të dy qenë përqaftuar vëllazërisht në prani të Profetit.

Ja pra...

Ky është kriteri që Islami vendosi për të dalluar të saktën nga e gabuara.

Purifikimi dhe stolisja e personalitetit.

Feja islame ka realizuar këto dy gjëra në mënyrë që të sigurojë konsistencën e “vëllazërisë” në mesin e myslimanëve. Ai arriti që myslimanët ta purifikonin dhe ta stolisin personalitetin e tyre.

E para: Synoi të purifikonte njerëzit nga ndjenjat dhe prirjet që pengojnë vëllazërimin.

E dyta: U përpoq që tek njerëzit, të ndërtonte ato veçori që e forcojnë vëllazërinë në zemra.

Islami dëshiroi që njerëzit të purifikoheshin prej:

- Përgojimeve. Pra që besimtari të mos flasë gjëra që vëllai i tij nuk dëshiron t'i thuhet.

Kurani e ka krahasuar përgojimin me ngrënien e mishit të njeriut, pra me një gjë shumë të neveritshme. Nga kjo mund të kuptojmë këtë gjë:

Përgojim pra, është si të vrasësh vëllain tënd të dashur dhe më pas të përtypësh mishin e tij. **“E neveritshme apo jo?”**

kumbon mesazhi i Krijuesit të Lartë. (Huxhurat, 12.)

Ja një ngjarje për të marrë mësim:

Një ditë, Aishja po fliste me të dërguarin e Allahut, në lidhje me Safijen dhe përdori një fjalë me të cilën dëshironte të thoshte se Safija qe trupshkurtër. I Dërguari i Allahut i tha Aishes:

“Ti the një fjalë të atillë që, po të përzihej me ujin e detit, do ta kishte fëlliqur atë.”

Sa fjalë rrënjëqethëse apo jo?

- Të flasësh pa e menduar atë që thua. Të flasësh rreth të tjerëve pa pasur njohuri të sigurt, është një veprim që nuk pajtohet me kriteret e Kuranit.

Mos shko pas diçkaje për të cilën nuk ke dijeni. Vërtet, dëgjimi, shikimi dhe zemra, të gjitha do të merren në llogari. (Isra, 36.)

- Mendimi i keq për tjetrin. Të pandehësh ashtu siç të vijnë, gjëra të ndryshme rreth njerëzve. Edhe kjo bie ndesh me kriteret e Kuranit.

“O ju që keni besuar! Mënjaroni shumë dyshime, se vërtet, disa dyshime janë gjynah.” (Huxhurat, 12.)

- Tallja. Edhe talljen duke bërë shenjë me sy e me vetulla, Kurani e konsideron ndër sjelljet që nuk i kanë hije personalitetit të besimtarit.



“Mjerë për çdo përqeshës!” (Humeze, 1)

- Të mbartësh fjalë.
 - Të shash një mysliman dhe ta fyesh atë, konsiderohet mëkat, ndërsa të luftosh me të, konsiderohet kufr.
 - Të shkelësh mbi gjakun, nderin dhe personalitetin e një myslimani.
 - Të shpifësh. Shpifja është një faj më i rëndë sesa përgojimi, sepse do të thotë të cilësosh një mysliman me një gjë që ai nuk e ka.
 - Të ushqesh armiqësi.
 - Ndërprerja e marrëdhënieve me një mysliman apo t'i kthesh shpinën atij, kur ka nevojë për ty.
 - Të nënvleftësosh një mysliman.
 - Ta konsiderosh se je kushedi se çfarë.
 - Të ushqesh zili.
 - Të kesh smirë. Të dëshirosh që myslimani të humbasë një të mirë që zotëron.
 - Të kërkosh të dish të metat dhe gabimet e një myslimani. Kjo është e ndaluar.
 - Të përpiqesh të mësosh një të fshehtë të tjetrit, të cilën ai nuk dëshiron t'i bëhet publike.
 - Të mburrësh me ndonjë gjë përpara të tjerëve.
 - Të shtypësh.
 - Të prishësh pazarin e tjetrit.
 - Të etiketosh të tjerët me gjëra negative.
 - Të gëzohesh për fatkeqësinë në të cilën ka rënë një mysliman.
- I Dërguari i Allahut thotë: *“Mos u gëzo me fatkeqësinë që i ka ndodhur vëllait tënd besimtar, sepse mund të ndodhë që Allahu e mëshiron atë dhe ta sjell ty atë fatkeqësi.”*
- Të bësh dredhi.
 - Të hash fjalën e dhënë.
 - Të bësh premtime të gënjeshtëta.
 - Të mos e ruash amanetin.
 - Të tregohesh mosmirënjohës për të mirën që të është bërë.
 - Të mbjellësh armiqësinë, ngatërresën dhe përçarjen mes myslimanëve.
 - Të flasësh kur je në grup, duke pëshpëritur në vesh me njerëz.
 - Të pozosh.
 - Ti thuash një myslimani se është qafir.
 - Të debatosh me myslimanët. Ta kalosh kufirin kur diskuton me një mysliman.
 - Të dëmtosh me fjalë dhe me veprime një mys-

liman tjetër.

Të gjitha këto që numëruam janë karakteristikat e sjelljeve që plagosin personalitetin e myslimanit në rrugën e vëllazërimit, prandaj një mysliman duhet ta pastrojë personalitetin e tij nga këto vese. Në suren Huxhurat në Kuran, janë përcaktuar kritere shumë të qarta në lidhje me “marrëdhëniet ndërmjet myslimanëve”. Format e sjelljeve që përmendëm më lart, përmenden edhe në hadithet fisnike të Profetit Muhamed.

NDËRTIMI I NJË PERSONALITETI TË SHËNDOSHË

Përkrah kësaj edhe ndërtimi i veçorive që e forcojnë vëllazërinë në zemra, është përkufizuar si në fjalën hyjnore që gjendet në Kuran, ashtu edhe në kriteret e bekuara të Profetit Muhamed.

Në krye të këtyre veçorive vjen **“Të kapesh fort pas Allahut”** (Haxh, 78.) dhe **“Kapja e të gjithë besimtarëve pas litarit të Allahut dhe mospërçarja.”** (Ali Imran, 103.) Aty është edhe enigma e punës. Me çfarë i keni të zëna duart? Me kë janë të lidhura zemrat tuaja? Çfarë do të thotë për ju që të kapeni pas Allahut? Këto janë pyetjet themelore të vetëllogarisë në këtë botë dhe të llogaridhënies në botën tjetër? Të gjitha lidhjet, përkatësitë, pasionet që formohen pa menduar më parë këtë, të shpjen në rrugë të gabuara. Të gjitha varësitë dhe përkatësitë, të gjitha emocionet dhe dashuritë, duhet të rreshtohen rreth “varësisë ndaj Allahut”. Thelbi i personalitetit të myslimanit duhet të formohet në këtë mënyrë.

Përveç bindjes ndaj Allahut dhe të dërguarit të Tij, na kujtohet nevoja që “të mos grindemi dhe të mos sulmojmë njëri-tjetrin”, sepse këto situata nuk duhet harruar se dobësojnë besimtarët, ua thyejnë fuqinë që kanë, madje edhe shtetin që i mban. Prandaj duhet të tregohemi durimtarë gjatë sprovimëve të vështira... (Enfal, 46.) Kurani shprehet: **“Në qoftë se grindeni me njëri-tjetrin, atëherë do të dobësoheni”**. Një myfesor e ka komentuar këtë ajet me fjalët “Humbni edhe shtetin tuaj”. Po të shohim se si myslimanët i kanë humbur shtetet e tyre në shekullin e fundit, për shkak të grindjeve të brendshme, mund të themi se ky komentim nuk është i huaj për ditët e sotme.

Një tjetër këshillë e Kuranit në lidhje me marrëdhëniet mes besimtarëve, në mënyrë që të ushqehet atmosfera vëllazërore, është nxjerrja në pah e modestisë. **“Modest me besimtarët dhe hijerëndë me qafirët...”** (Maide, 54.) apo “të paepur përpara qafirëve dhe të mëshirshëm për njëri-tjetrin”, është lloji i marrëdhënies. Pra i thuhet jo tolerancës me qafirët, kundrejt marrëdhënieve të ashpra me

njëri-tjetrin...

Në marrëdhëniet mes besimtarëve vepron sipas parimit të kundërshtimit dhe refuzimit të gabimeve dhe gjynaheve që bën një person tjetër, jo kundër personalitetit të tij, si dhe sipas parimit që atë ta pastrojmë nga gabimet, jo ta fshijmë fare nga lista. Pra, qasja është shpëtimi i tjetrit nga mëkatet dhe jo distancimi total prej tij.

Dhe lutja... Të lutesh për të gjithë besimtarët... që zemra jonë të kërkojë që Zoti t'i falë të tjerët dhe të lutet që t'i pastrojë ata nga mëkatet.

Në këtë ajet na mësohet kjo dua:

“O Zoti ynë, na fal ne dhe vëllezërit tanë, të cilët kanë besuar para nesh dhe mos lejo që në zemrat tona të ketë asnjë të keqe ndaj besimtarëve! O Zoti ynë, Ti je vërtet i Butë dhe Mëshirëplotë!” (Hashr, 10.)

Duhet që zemrat tona të duan dhe të përbuzin vetëm për hir të Allahut.

Thelbi i gjithë këtyre që shprehëm në këto rreshta, është kërkimi i një personaliteti, i cili është bërë një me dhembshurinë, dashurinë, mëshirën, gëzimin dhe keqardhjen dhe i cili e ka shndërruar në themelin e ndërtimit të marrëdhënieve njerëzore dhe të shoqërisë, dashurinë që pasqyrohet nga atributi Vedud i Zotit dhe mëshirën që pasqyrohet nga atributet Rrahman dhe Rrahim të Tij.

Pa harruar këtë hadith të transmetuar nga i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ve sellem):

“Nuk do të hyni në xhenet, derisa të besoni dhe nuk keni besuar siç duhet, përderisa nuk e doni njëri-tjetrin.”

EDUKIMI

Me kaq veçori të personalitetit që numëruam më lart, është e qartë edhe nevoja e edukimit të personalitetit të vendosur, në mënyrë që edhe të pastrohemi, edhe të stolisemi.

Pasi këto veçori mund të ndërtojnë një shoqëri myslimane dhe një personalitet mysliman që e ka përthithur ndjenjën e vëllazërisë, vetëm nëse arrijnë të zbatohen në jetën e përditshme.

Të arrijmë të edukohemi, duhet që të të jetojmë 24 orët e ditës sipas kësaj përpikmërie dhe në çdo

çast t'i mësojmë nefsit tonë domosdoshmërinë e dashurisë për besimtarët.

Në thelb të edukimit duhet të qëndrojmë ndjeshmëria, që çdo besimtar duhet ta pranojmë si një pjesë të trupit tonë. Kjo mund të realizohet, vetëm nëse ekziston përcimi mes zemrave. Për këtë arsye, zemrat duhet t'i shndërrojmë në burime që mund të përçojnë rrymën mes tyre.

Sot besimtarët janë të pafuqishëm, shtetet e tyre shemben, umeti është disa herë më i madh për nga numri po të krahasohet me umetin e kohës së Profetit Muhamed, por shumë më i dobët në vendimmarrje...

Përse?

Ngaqë nuk zotëron nivelin e vëllazërisë që kishin sahabët mes tyre, kur gjendeshin përreth Profetit. Dinjitetin e umetit të formuar nga besimtarë që janë vëllazëruar aq shumë, saqë janë shkrirë në njëri-tjetrin... Po të realizohet kjo gjë, çdo njëri prej nesh bëhet njëmijë. Po të realizohet kjo, vetë melekët vijnë të na ndihmojnë. Po të realizohet kjo, mëshira e Zotit do të jetë mbi umetin. Në qoftë se umeti mysliman bëhet si muri i formuar nga tullat e thurura mirë me njëra-tjetrën (bunjanun mersus), atëherë shndërrohet në një shoqëri sypatrembur, që mund të thotë: “Në kraharorin tonë shuajmë edhe flakët e xhehenemit, sepse kjo rrugë është rruga e Zotit dhe nuk ka kthim pas”.

Atëherë me fjalët “umeti mysliman” nuk do të nënkuptohen hapësira gjeografike ku jetojnë njerëz të shtypur, por do të na vijë ndërmend një bum qytetërimi.

Fjala e fundit:

Të shohim zemrat tona. Çfarë ndjejmë për besimtarët në lindje dhe në perëndim? Çfarë ndjeni kur vlerësoni marrëdhënien tuaj me Zotin? Çfarë ndjejmë tek shëtisim mes zemrës, mendjes dhe nefsit?

Një umet që meritonte Profeti.

Këtë do të na kërkojnë të nesërmen në fushën e mahsherit.

Myslimani është njeriu që nuk e harron kurrë se çdo të ngjasë në mahsher dhe që përgatitet çdo çast për llogarinë që do të japë atje.



Nga duhet të fillojmë që ta lexojmë dhe mësojmë islamin?

— Mustafa Erish —

Kjo është ngjarja, largimi i njerëzve/shoqërive nga shpallja, pozicionimi i tyre kundër saj dhe devijimi i tyre si rezultat i këtij fenomeni, apo qëndrimi i shpalljes në një luginë dhe i atyre në një luginë tjetër.

Për shkak se ky proces funksionon me kohë të gjatë dhe pa zë, krahas këtij largimi dhe qëndrimi në luginë të ndryshme vazhdon derisa njerëzit/shoqëritë, pa e kuptuar mendojnë se janë në rrugë të drejtë, mendojnë se konceptimi dhe jetesa e tyre fetare është në përputhje me shpalljen, se e ruajnë identitetin e tyre dhe se e kënaqin Allahun duke mashtruar veten.

Siç ishte kështu gjendja e popujve të mëparshëm, që kishin devijuar nga shpallja edhe struktura e popullit arab në kohën e xhahilijetit, kur Muhamed u bë Pejgamber nuk kishte ndonjë ndryshim nga ajo. Edhe ata pohonin se akoma janë në rrugën e Ibrahim dhe se janë të lidhur ndaj fesë së tij. Por Kurani thotë se Ibrahim ishte Hanif/i lidhur me fenë e tevhidit, se nuk ishte prej politeistëve.

I paralajmëron ata se janë në rrugë të gabuar dhe se mendojnë shumë gabim. Allahu Teala, thotë:

“Me të vërtetë, Ibrahim,

ihimi ka qenë prijës shembullor (me të gjitha virtytet e mira), **i përlurur para Allahut, me besim monoteist dhe nuk ka qenë prej idhujtarëve.”** (Nahl, 120)

Edhe gjendja e ehli kitabit nuk ka ndonjë ndryshim me ato që thamë më sipër. Ata pohonin se ishin në rrugën e Ibrahim dhe se rridhnin nga soji i tij. Këtë e thonë shpesh edhe zëdhënësit e mbledhjeve të “Dialogut Ndërfetar” që organizohet në seri kohët e fundit.

Edhe pse Kurani thotë se fetë e tyre janë manipuluar dhe se ky fakt është i vërtetuar edhe me përmbajtjen e librave të tyre, ata e shohin kristianizmin dhe judaizmin si vlerë të njëjtë me Kuranin, thonë se janë ithtarë të së njëjtës fe dhe se janë fëmijët e Pejgamberit Ibrahim.

Ndërsa Kurani thotë qartë se pohimet e atyre nuk janë të vërteta, përkundrazi ata po mashtrojnë veten e tyre. Allahu i Madhëruar, thotë:

“Ibrahim nuk ka qenë as hebre, as i krishterë, por ka qenë besimtar i vërtetë (monoteist) i përlurur ndaj Allahut dhe nuk ka qenë prej politeistëve.” (Ali Imran, 67)

“A nuk i sheh ata (hebrenjtë) që u është dhënë një pjesë e Librit?! Atyre u bëhet thirrje të vijnë te Libri i Allahut për t’u gjykuar, por një pjesë e tyre kthejnë shpinën, duke mos ia vënë veshin. Kjo, sepse ata thonë: “Neve nuk do të na prekë zjarri i Xhehenemit, përveçse disa ditë”. Shpifjet që bënin, i kanë mashtruar ata në besimin e tyre.” (Ali Imran, 23-24)

Kjo është gjendja e përgjithshme e gjithë gjeografisë islame. Megjithëse emri dhe identiteti është islam, ky është shkaku që mësimet e shpalljes janë në një luginë, ndërsa shumica dërmuese e myslimanve jetojnë në një luginë tjetër dhe kanë

rënë në gjendjen e sotme.

Miku ynë i nderuar, Umer Shevki Hotar, e shpreh kështu faktin se myslimanët gabojnë, kur konceptimet fetare nuk i marrin drejt nga Kurani, por së pari nga rrugë dhe burime të tjera:

“Shkaku kryesor i kontradiktave të njerëzve në çështjen e islamit, qofshin myslimanë apo ithtarë të feve të tjera, është konceptimi i gabuar ndaj fesë dhe rruga e gabuar që ndiqet për të mësuar fenë islame.

Çdo fe, çdo ideologji, çdo mendim filozofik, madje çdo dije teknike, në formën më të saktë mësohet nga burimi i saj.

Për të mësuar se çfarë është kristianizmi, Ungjilli që e ka përhapur jep të dhënat më të sakta para librave që janë shkruar rreth kristianizmit. Judaizmin mund ta mësoni në mënyrën më të qartë dhe direkte nga Dhjata e Vjetër ose Talmuti, Torah dhe Mishna që përbëjnë mentalitetin e sotëm çifut, Marksizmin nga veprat e Karl Marksit dhe kapitalizmin nga ekonomisti Anglez, Adam Smith.

Nëse përpiqeni që këto të dhëna t'i merrni nga dora e dytë apo e tretë, së pari do të zgjatni rrugën dhe së dyti shtohet mundësia për të marrë të dhëna të gabuara, për shkak se në to përzihen komentimet e personave të dytë apo të tretë.

Të mësosh kristianizmin nga një prift, ndërkohë që në dorë keni Ungjillin e sotëm, është një rrugë e lehtë por e gabuar, sepse ajo që do të mësoni, më shumë se kristianizmi, është komentimi i atij prifti rreth Ungjillit apo rreth kristianizmit. Këto komentime mund t'ju devijojnë në çështjen e kristianizmit.

Kjo metodë, krahas feve, mendimeve filozofike dhe ideologjive, është e vlefshme edhe për njohjen dhe vlerësimin e njerëzve. Nëse doni të dini për një njeri, në vend që të vendosni sipas atyre që thuhet, flisni ballë për ballë me të, sepse kjo është rruga më e saktë.

Ndërkohë që ky rregull më i lehtë logjik pranohet teorikisht, për fat të keq në praktikë nuk përdoret aq shumë...”

Një shkrimtar tjetër, i cili është miku ynë, e

shpreh kështu faktin se në çdo konceptim, në çdo mënyrë jetese, në çdo vlerësim dhe në çdo përcaktim, Kurani nuk duhet të jetë objekt por subjekt:

“Të nxjerrësh Kurandin nga subjektiviteti duke e objektivizuar, ta nxjerrësh nga të qenët përcaktues në pozitën e atij që përcaktohet, të vërtetojmë paragjykimet tona me Kuran dhe t'i afrohem atij për të aprovuar mendimet tona, përsëri përbën një vlerësim tjetër të gabuar, i cili është i përhapur.

Kurani duhet të mbahet gjithmonë në qendër, në pozitën e subjektit dhe në pikën e autoritetit përcaktues, në mënyrë që mendjen, besimin, personalitetin dhe jetën tonë, ta ndërtojë me masat e shpalljes. Të na pastrojë, të na japë nder e krenari dhe të na bëjë që të fitojmë kënaqësinë e Zotit.

Nëse nuk veprojmë kështu, por i afrohem Kuranit me një mendje që e kanë ndotur e kushtëzuar paragjykimet, me synimin për të qëndruar larg ndriçimit të tij dhe për të kërkuar dispozita që mund të mbështesin mendimet tona, të cilat janë produkt i epsheve, Kurani nuk do të na i hapë thesaret e tij, nuk do të na udhëzojë dhe nuk do të na ndriçojë.

Përkundrazi, për të aprovuar përvetësimet që kemi, ne duhet t'i kuptojmë mirë ajetet e Allahut, të vërtetojmë të drejtën tonë dhe dëshirat t'ia përshtasim Kuranit. Por nëse përpiqemi që Kurandin t'ia përshtasim dëshirave tona, ai do të jetë shkaku kryesor për të na zvarritur në pozita të poshtëruara dhe të trishtuara.

Zoti i Madhëruar na ruajtë të gjithëve, që të mos zvarritemi në gjendje të tilla devijuese dhe mos na bëftë prej atyre që nuk përfitojnë nga Kurani, për shkak të një konceptimi të gabuar, ndërkohë që e lexojmë atë çdo ditë. (Fundnot: Mehmet Pamak, Kulluk Eksenli Hayatta Ramazan ve Kur'an, 34-35, ilim ve Kültür Yayınları, Ankara, 2005, Botimi i tretë).

Mund të shtrohet pyetja: “I kuptuam ata që mjaftohen duke e lexuar Islamit nga të tjerët, por a është kështu edhe mjaftimi me leximin e tefsirit për të kuptuar Kurandin?” Pa e zgjatur fjalën, në mënyrë të kushtëzuar mund të them “po”, sepse



ata që mjaftohen me komentimet e komentuesve, pa u përpjekur për ta kuptuar Kuranin vetë, pa i testuar fjalët e komentuesve me të dhe që me këto formojnë shabllonet e konceptimit e të vlerësimit, shumë mësim të Kuranit janë të detyruar t'i kuptojnë në mënyrë të përshtatshme me shabllonet që kanë në kokën e tyre.

Këtë mund ta kuptojmë nga fakti se komentuesi i njohur Fahreddin Razi, ajetet që flasin për shefatit në Kuran, i ka kuptuar dhe shfaqur sipas konceptimit të një medhhebi të caktuar, i cili është formuar si rezultat i kontradiktave ndërmjet medhhebeve të tjera. Një studiues e vlerëson kështu shpjegimin që u bën Raziu ajeteve, në të cilat përmendet shefati duke marrë për bazë mendimin e një medhhebi të caktuar:

Shefati për të cilin po flasim, është bërë objekt debati në shkallë përkrahësish të kundërt. Kështu është bërë shkak që tema të kalojë nga dimensionin i konceptimit në dimensionin e mbrojtjes.

Kjo situatë, i ka nxjerrë ajetet në fjalë nga konceptimi brenda kornizave të tërësisë së temës e të mendimit ndaj kësaj bote që ka formuar Kurani dhe i ka vënë plotësisht në pozitën e mbrojtjes sipas konceptimeve dhe përvetësimeve fraksionale. Kjo në vetvete, është bërë shkak për disa qorrsoke.

Fjalët e Fahreddin Razit në lidhje me ajetin 110 të sures Taha, mund t'i japim si shembull për këtë çështje. Sipas Raziut, për kë të jetë bërë shefati, atij i jep dobi, sepse veçimi që bëhet me anë të nefjit (negatives), do të thotë vërtetim.

Kur Razi i tha këto, nuk e mori parasysh kontekstin e ajetit në fjalë dhe duke e tërhequr debatin në një fushë teorike ndërmjet ehli sunetit e mutezilesë dhe duke pohuar se do të ketë shefat e se patjetër ai ka dobi, e sjell problemin te pika nëse shefati vlen apo jo për njeriun mëkatar dhe si mendim i ehli sunetit i drejtohet faktit se mëkatarin mund të përfitojë nga shefati. Për këtë arsye, ai arrin në rezultatin që thamë më sipër, duke e vërtetuar këtë nga veçimi negativ.

Por dy kushtet e ndryshme të veçimit në ajet, që janë: "Leja e Allahut dhe kënaqësia nga fjala", në kuptimin konceptual, duke mos u marrë parasysh se çfarë vendi zënë brenda tërësisë së Kuranit, shprehet se, kush thotë fjalën "lailahe illallah" do të përfitojë nga shefati, për shkak se ka thënë një fjalë prej të cilës Allahu është i kënaqur.

Ne mund të themi se ajo gjë që e imponon Raziun të bëjë kaq komentim dhe të qëndrojë në

bazën e konceptimit, i cili e shkëput nga tërësia, është refleksi i mbrojtjes së mendhhebit. Ajetet për të cilat flitet në një mjedis të tillë, bëhen temë e polemikave aktuale duke u shkëputur nga bota e kuptimit të Kuranit.

Në lidhje me këtë çështje, Ibnu'l-Kajjim Xhevziije thotë: "Ti e pranon Kuranin sikur të ketë zbritur në përputhje me mendimet, pohimet dhe fraksionet e të gjitha grupeve të devijuara. Apo sikur Kurani është një xehmi te xehmitë, një mutezili te mutezilitë, një kaderi te kaderitë dhe një rafidi te rafiditë."

Ndërkohë, gjëja që komentuesi duhet të ketë parasysh nuk është mbrojtja e medhhebit dhe qëndrimin të tij, por përpjekja për të kuptuar synimin e Allahut, sa të jetë e mundur.

Kurani Fisnik nuk është një libër për të vërtetuar apo refuzuar mendimet e këtij apo atij medhhebi, por është një shpjegim hyjnor për të shfaqur një kuptim botëror për botën e ekzistencës, në mënyrë që njerëzit të formojnë një metodë sjelljeje të përshtatshme me të, duke kuptuar përgjegjësitë që kanë.

Siç dihet, sado që një komentues i Kuranit të qëndrojë larg faktorëve negativë të kulturës, e cila vazhdon si një trashëgimi, në fund komenton me të dhënat e asaj kulture, duke u ndikuar nga ajo.

Për këtë arsye, nuk ka asnjë tefsir që të mos jetë ndikuar nga anët negative të kulturës, e cila ka filluar nga shekulli i parë e deri më sot, të mos ketë bërë vlerësime subjektive dhe të mos përfshijë të dhëna të pasakta apo të paaprovuara.

Kjo është një gjendje normale, sepse sado që njeriu të ketë dije, së fundi është njeri dhe njeriu është një krijesë që harron, gabon, mëson gabim, merr të dhëna të gabuara, është i kushtëzuar, bën vlerësime të mangëta etj. Shkurtime, njeriu nuk është i pagabueshëm. Për këtë arsye, komentuesit në librat e tyre japin shumë të dhëna si rivajete/hadithe apo tregime/histori nga historia e popujve të mëparshëm. Krahas atyre të cilët i kanë filtruar këto me filtrën e Kuranit, shumica dërmuese bëjnë komentime nga aspekti i këndvështrimit fraksional, imitojnë gjërat e njëri-tjetrit, tregojnë shumë rivajete e histori, të cilat njihen si israilijate (tregime të pasakta të marra nga feja e çifutëve) dhe këto ua shfaqin lexuesve, duke i përvetësuar sikur të ishin shpjegimet e ajeteve.

Kështu, me këto gjëra formohen e drejtohen të dhënat dhe kultura e lexuesve. Edhe pranimet

apo refuzimet e tyre bëhen sipas këtyre. Shembuj për këtë ka qaq shumë, saqë nuk mund të numërohen.

Për shembull, cilësitë “Rahman” dhe “Rahim” që gjenden në suren Fatiha dhe në ajetin e 30 të sures Nahl, janë dy cilësi që shprehin madhështi. Njëra shpreh fatkin se Allahu i Lartësuar është shumë i mëshirshëm, ndërsa tjetra tregon se kjo cilësi është e pandashme nga ai.

Kurse komentuesit për cilësinë “Rahman” thonë se është e përgjithshme në këtë botë, për besimtarët dhe për qafirët, ndërsa cilësia “Rahim” do të thotë se Allahu Teala në ahiret do të mëshirojë vetëm besimtarët.

Edhe ata që i lexojnë tefsiret apo përkthimet e Kuranit që janë bërë në këtë mënyrë, mësojnë se të dy fjalët gjithmonë kanë këto kuptime. Ndërkohe, as Kurani, as suneti dhe as gjuha nuk thonë se cilësitë “Rahman” e “Rahim” mbartin këto kuptime. Ata që shkruajnë se kanë këto kuptime, përsërisin të njëjtin gabim, duke imituar njëri-tjetrin në ato që shkruajnë.

Ebu'l-Kasim Hui, i cili tregon se fjalët Rahman dhe Rahim nuk kanë këto kuptime, thotë kështu:

“Mënyra failun, tregon cilësitë që ka një qenie dhe të cilat nuk ndahen prej tij. Edhe urtësia që fjala Rahim ka ardhur pas fjalës Rahman, është kuptuar në këtë mënyrë, sepse fjala Rahman shpreh përgjithësinë dhe gjerësinë e mëshirës, por jo pandashmërinë nga qenia.

Fjala Rahim ka ardhur pas saj për të treguar se cilësia e mëshirës është një cilësi e pandashme nga qenia e Allahut Teala. Retorika e Kuranit ka synuar të shprehë edhe këto dy qëllime, në këtë ajet të begatë. Allahu është Rahman në kuptimin “mëshira e tij ka përfshirë çdo gjë” dhe është Rahim në kuptimin “atributi mëshirë nuk ndahet kurrë prej tij”.

Shumë prej komentuesve të Kuranit, për shkak se nuk e kanë perceptuar këtë gjë delikate, me justifikimin se shumica e shkronjave në fjalë argumenton gjerësinë e madhe të kuptimit, kanë pandehur se kuptimi i fjalës Rahman është më i gjerë se kuptimi i fjalës Rahim. Por ky është një justifikim qesharak, sepse argumentimi i fjalëve

është i lidhur me kuptimin e parë që ka fjala dhe nuk ka asnjë lidhje me pakicën apo shumicën e shkronjave. (Shënim: Ebu'l-Kasim Hui, Bejan fi Tefsiri'l-Kur'an, 438, Muessesetu'l-A'lemi, Bejrut, 1974, Botimi i tretë).

Gabimin për ta mësuar islamin nga e kundërta, nga islami i shoqërisë apo nga mësimet e shkencave teologjike, në vend që të lexohet dhe të mësohet nga Kurani, Muhamed Gazaliu e tregon kështu, në shembullin e leximit pak nga Kurani dhe shumë nga hadithi:


“Të lexosh pak nga Kurani dhe shumë nga hadithi, nuk siguron një konceptim të drejtë për islamin. Kjo i ngjan ushqyerjes së keqe, sepse ndërmjet faktorëve që ushqejnë mendjen dhe trupin, duhet të ketë një ekuilibër. Le ta shpjegojmë me shembuj këtë:

San'ani thotë se nezri (kurbani që bëhet për të mbajtur zotimin) është haram, duke u mbështetur në transmetimin e Ibn Umerit, i cili shprehet: “I Dërguarii Allahu e ka ndaluar flinë dhe ka thënë”: «Ajo nuk ka ndonjë dobi, vetëm pakëson pasurinë e kopracit». (Shënim: Buhari, Ejman, 26/2, kader,6, Muslim, kader, 2-6, Ebu Davud, ejman,18, Tirmidhi, nuzur,11, Nesai, ejman, 24-26, Ibn Maxhe, keffarat, 26/2, Ibn Hanbel, dhe në shumë vende të tjera.)

Por nezri që nuk ka dobi, ashtu siç vepohet në ndërrim tek punët tregtare, është nezri që bëhet në këtë mënyrë: Nëse shërohem apo nëse biri im bëhet i suksesshëm, do të bëj këtë gjë për Allahun. Por përderisa të jetë i saktë nga aspekti juridik, nuk ka ndonjë problem që të bësh nezr duke synuar bindjen ndaj Allahut.

Ne duhet të pyesim: Si mund të thuhet se nezri si parim është haram, ndërkohë që Allahu i lartësuar, kur i cilëson dhe i lavdëron njerëzit e mirë, thotë: **“Ata e zbatojnë premtimin dhe i frikësohen Ditës (së Kiametit), tmëri i së cilës përhapet gjithkund.”** (Insan, 7), dhe në një vend tjetër: **“Pastaj, haxhinjtë le të pastrojnë trupin e tyre, le t'i kryejnë zotimet e tyre dhe le t'i bëjnë tavaf Qabes.”** (Haxh, 29)





— Doç. dr. Fahredin Jëlldëz —

Islami, i cili i shpie njerëzit te e vërteta dhe te e drejta në besim e te mirësia në sjellje është feja e Allahut që e ka predikuar Pejgamberi i fundit, (a.s.). Kjo fe së cilës i shikohen rezultatet praktike në çdo vend ku praktikohet dhe e cila i drejton njerëzit për te Allahu në mendime e sjellje, “Besimin ndaj Allahut” e pranon si rregullin bazë të jetës. Është shumë e qartë se për të fituar vlerë punët që bëhen, duhet të jenë të lidhura me këtë bazë themelore.

Islami, i cili është një sistem besimi aktiv, siç nuk i shikon të përshtatshme që besimi të ngelë i ngrirë dhe jofunksional, po ashtu nuk pranon edhe veprat, të cilat nuk mbështeten në bazën e besimit. Islami e pranon si detyrë “Bindjen ndaj Allahut” duke synuar sigurimin e shfaqjes së besimit dhe të gjithë lumturinë e ka lidhur me kryerjen e kësaj detyrë në formën më të mirë. Tani le të mundohemi që të kuptojmë konceptin “Bindje” të cilin mund ta quajmë fruti i pemës së besimit që ka hedhur rrënjë në thellësitë e zemrës.

KUPTIMET DHE PËRKUFIZIMI I FJALËS

Koncepti bindje që në fjalor do të thotë “të nënshtrohesh, të dëgjosh dhe t’i bindesh urdhrat të marrë, në Islam më shumë përdoret në kuptimin që “të zbatosh urdhrat e Allahut”.

Ndërsa si një term fetar, bindje do të thotë që “të bësh një punë sipas udhëzimeve të Kuranit e të Sunetit e cila në fund ka sevap”. Siç kuptohet edhe nga përkufizimi, bindja shpreh “besimin që do të thotë Tevhid e Islam dhe veprat që duhet të bëhen si domosdoshmëri e këtij besimi”.

FORMA DHE KUFIRI I BINDJES

Kurani urdhëron bindje ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij.² Kurani, i cili urdhëron bindjen edhe ndaj “Ulul Emrit” të cilët i dinë, i pranojnë dhe i praktikojnë dispozitat e Islamit, i ka pranuar si bindje kryerjen e veprave që nuk bien ndesh me fenë e Allahut dhe me sunetin e të Dërguarit të Tij. Ndërsa e ka ndaluar kryerjen e veprave që nuk i përshtaten Islamit. Në Kuran dhe sunet është shprehur

qartë se njeriu nuk mund ta arrijë botën e lumturisë që përbëhet nga hallallet duke bërë vepra që sipas Islamit janë të ndaluara në mënyrë të qartë. Zoti i Madhëruar e ka shprehur formën dhe masën e bindjes duke thënë: **“Kini frikë nga Allahu dhe bindmuni mua! Mos iu bindni urdhërit të atyre që e teprojnë!”** (Shuara, 150-151) Veçanërisht edhe ky hadith i të Dërguarit të Allahut e shpjegon mjaftueshëm këtë temë.

I Dërguari i Allahut (a.s.) emëroi prijës njërin prej ensarëve në krye të një njësie ushtarake të cilën e kishte dërguar. Komandanti që kryesonte njësinë ushtarake i urdhëroi ushtarët që të mblihdnin dru, të ndiznin zjarre dhe pastaj të hidheshin në to. Ata i thanë se nuk mund të ketë bindje për një urdhër të tillë dhe për këtë njoftuan të Dërguarin e Allahut. I Dërguari i Allahut (s.a.v.) sipas urdhrin për të cilin u njoftua, tha:

“Sikur të kishit hyrë në atë zjarr nuk do të dilni më kurrë prej aty. Bindja është vetëm në çështjen e mirësisë.”⁴ Për shkak se bindja është një shprehje reale e dashurisë ndaj Allahut, e fitimit të kënaqësisë dhe e ruajtjes nga zemërimi i Tij siç e pamë edhe më sipër, veprat të cilat nuk e mbartin këtë veçori sipas Islamit nuk pranohen si bindje por si mëkat. Përsëri i Dërguari i Allahut ka theksuar se bindja duhet të jetë për Allahun duke thënë: *“Nuk ka bindje ndaj asnjë krijese në mëkat ndaj Krijuesit.”⁵*

BINDJE DO TË THOTË TË JETOSH SIPAS KURANIT DHE SUNETIT

Sigurimi i një jete të begatë e të privilegjuar me Islamit mund të arrihet duke i menduar fjalët e Kuranit e të sunetit dhe duke i përjetuar ato. Kështu është bërë e qartë se synimi i Allahut nga fjala “Habl” që do të thotë “litar” e që kalon në urdhrin hyjnor **“O ju që keni besuar! Kapuni pas litarit të Allahut dhe mos u përçani!”⁶** është Kurani dhe Suneti.⁷ Për këtë arsye Kurani dhe Suneti janë shkaku i udhëzimit dhe i lumturisë njerëzore. Edhe emri i dëgjimit të këtyre urdhrave që transmetohen në këto dy burime dhe i sjelljeve sipas tyre është bindje. Faktikisht dija nga Kurani dhe Suneti kanë si qëllim kryerjen e veprave sipas Kuranit e Sunetit. Islami i pranon si një fantezi teorie mendimet të cilat nuk kthehen në vepra dhe si një shfaqje e pakuptimtë punët të cilat nuk mbështeten në besim dhe në Kuran. Kështu, për të fituar një jetesë të qetë duke iu bindur Allahut duhet ta dërgojmë jetën te Islami. Urdhri i mëposhtëm i Kuranit shpreh bukurinë e dërgimit të jetës te Islami dhe se kjo mund

të arrihet vetëm me bindje ndaj Allahut dhe ndaj të Dërguarit të Tij:

“O ju që keni besuar! Bindjuni Allahut, bindjuni të Dërguarit dhe prijësve tuaj. Nëse nuk pajtoheni në ndonjë gjë, drejtojuni Allahut dhe të Dërguarit, nëse besoni Allahun dhe Ditën e Kiametit. Kjo është më e mirë për ju dhe shpjegim më i bukur.” (Nisa, 59)

I DËRGUARI I ALLAHUT ËSHTË SHEMBULLI I BINDJES

Komentimi dhe praktikimi më i saktë i shpalljes është bërë me sunetin e Pejgamberit tonë të dashur për shkak se mësimet e marra nga ai janë ligje hyjnore të Allahut. Ky mësues i fundit e i vetëm i kësaj bote i ka mbajtur bashkë Librin dhe urtësinë në mësimet e tij. Mësimet e tij që përfshijnë të gjithë jetën duke ndikuar nëpër zemra, mbështetet në faktin “të bësh ato që thua dhe të qëndrosh i lidhur realisht me ato që u mëson të tjerëve”. Ai, me këtë gjendje u bë vetë shembulli i bindjes ndaj Allahut.

I Dërguari i Allahut nuk ishte vetëm një pejgamber që u shpallte njerëzve urdhrat e Allahut, por në të njëjtën kohë ai ishte një udhëzues i përsosur që u mësonte atyre Librin dhe urtësinë, që u shpjegonte ligjet hyjnore, që i përsoste të mangurit dhe që i ftonte në rrugën e bindjes mëkatarët... Ai ishte i Dërguari i Allahut që u kthente shikimin të verbërve dhe që u hapte rrugët e ndriçimit zemrave të errësuar...

Ai është Pejgamberi ynë i cili na shpjegoi ajetet dhe i cili na tregoi se çfarë rëndësie kanë ato në jetën tonë. Ai është njeriu i parë që jetoi sipas Kuranit dhe që tregoi në mënyrë të qartë formën e praktikimit të këtij libri hyjnor... Domethënë se është e pamundur që ta kuptojmë dhe jetojmë Islamit pa e kthyer vëmendjen tonë drejt sunetit të tij. Vendosja në fushën e praktikimit të një jete e cila parashikohet në Kuran, është e lidhur me ndjekjen e rrugës së Pejgamberit. Ja, Kurani është komentuar dhe praktikuar në një formë të plotë me sunetin ashtu që të veprohet me këtë të vërtetë deri në kiamet.

Së fundi, mund të themi se bindja është një aksion i tillë i mbushur me tevhid dhe sinqeritet i njeriut besimtar. Ajo është përjetim i Islamit sipas parimeve që ka vendosur Kurani dhe i ka shpjeguar suneti.

Shënimet: 1) Mu'xhemu'l Vamid, (T.V.A')Md. 2) Al-i Imran, 32, Enfal, 20, Nisa, 59. 3) Nisa, 59. 4) Ibn Kethir, Tefsiru'l Kuran'il Adhim, II, 324. 5) Kurtubi, Xhami' li-Ahkami'l Kuran, V, 260. 6) Al-i Imran, 103. 7) Texhrid-i Sarih, XII, 401.



DASHURI DHE VËLLAZËRI

— Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz —

Islami paraqet organizmin social si një strukturë me qendër besimin dhe me themel dashurinë dhe vëllazërinë. “Rruga për të hyrë në Xhenet”, si një objektivi i largët i një myslimani, kalon përmes dashurisë dhe vëllazërisë. Andaj dhe i Dërguari i Allahut ka thënë: “Nuk mund të hyni në Xhenet pa besuar. Pa dashur njëri-tjetrin nuk mund të besoni. A t’ju tregoj një vepër që, nëse e bëni, do të bëhet sepse që të doni njëri-tjetrin? Përhapni selam-in ndërmjet njëri-tjetrit!” (Muslimi, Iman, 93.)

Ashtu siç shprehet në këtë hadith raporti mes besimit, dashurisë dhe vëllazërisë, po ashtu edhe në ajetet fisnike (3/103) thuhet që besimtarët që ndajnë të njëjtin besim me njëri-tjetrin, duhet të kapen fort pas litarit të Allahut, të përqafojnë mirë Islamit dhe Kuranit dhe të mos përçahen mes tyre. Vëllazëria dhe dashuria e shoqërisë islame reflektohet ngrohtësisht në çerdhen familjare. Andaj dhe ymeti, sipas qasjes islame, është krahasuar me një çerdhe të ngrohtë familjare, ku Pejgameberi (a.s.), është konsideruar babai, gratë e tij nëna (33/6) dhe besimtarët si vëllëzër, fëmijët e këtyre prindërve. (Ibn Maxhe, Tahara, 16.)

Në një hadith tjetër, i Dërguari i Allahut e krahason organizmin e shoqërisë myslimane me një trup të vetëm. Ashtu si sëmundja apo shqetësimi i një

organi të vetëm sëmur tërë trupin, po ashtu edhe shqetësimet individuale apo të një grupi të tërë, shqetësojnë individët apo grupet e tjera të shoqërisë. (Buhari, Edeb, 27.). Ky botëkuptim është shembulli i të qenit i vetëdijshëm për vëllazërinë sociale të mbështetur në besim dhe dashuri.

Për arsye të dallimit social, ekonomik dhe gjinor të njerëzve, kur shohim përbërjen sociale të periudhës paraislame, vërehet se ata kacafyteshin dhe dhunonin njëri-tjetrin. Trysnia dhe dhuna që ushtronin fisnikët ndaj skllëvërve, të fortit ndaj të pafuqishmëve dhe meshkujt ndaj grave e vajzave në Mekë, kishte shkaktuar një shqetësim dhe një tension të përgjithshëm.

Botëkuptimi social që solli islami, bazohej mbi dashurinë me qendër besimin dhe vëllazërinë. Ky botëkuptim që vuri themelin e barazisë sociale, ka bërë që njerëzit të jetojnë të lirë, ashtu siç kanë lindur dhe me të drejtat e tyre humane.

Kjo atmosferë që ka krijuar islami në Mekë, ka luajtur një rol të rëndësishëm për të ndërtuar një shoqëri të re islame në Medine. Islami, nga njëra anë i dha fund hasmërisë së hershme mes fiseve Evs dhe Hazreth dhe nga ana tjetër, me një projekt vëllazërie, bëri vëllëzër muhaxhirët me ensarët.

Kurani e shpjegon kështu këtë ngjarje historike:

“Kujtoni dhuntinë e Allahut për ju, sepse, kur ishit në armiqësi, Ai i pajtoi zemrat tuaja e, në sajë të dhuntisë së Tij, u bëtë vëllezër. Dhe ju ishit buzë greminës së zjarrit, ndërsa Ai ju shpëtoi prej saj.” (Ali Imran, 103.)

Sikurse bëhet e ditur edhe në ajet, dashuria dhe vëllazëria e bazuar në besim, është ajo që ngroh zemrat e mbushura me hasmëri dhe urrejtje. Besimi i bashkon besimtarët, ua ngroh zemrat dhe i bën të bien dakord mbi fjalën e Allahut. Në sajë të këtij besimi për hir të Allahut, u bënë vëllezër që i duan të mirën dhe mëshirojnë njëri-tjetrin.

Ndjenja e vëllazërisë bën që të lihet mënjanë çdo lloj dallimi mes besimtarëve dhe të njësohen zemrat e tyre, që t'i drejtohen Allahut. Në Mesnevi-në e tij, Mevlana e përkufizon kështu hasmërinë dhe urrejtjen që kishin mes njëri-tjetrit fiset Evs dhe Hazrexh në Medinen paraislame: “armiq të përbetuar, saqë mund t'i pinin gjakun njëri-tjetrit”. Besëlidhja që u krijua në Medine, duke ndjekur formulën profetike **“Besimtarët janë vëllezër. Atëherë, rregulloni marrëdhëniet e vëllezërve tuaj.”** (Huxhurat, 10), bëri që të zhdukeshin urrejtjet mes njëri-tjetrit. Kështu, ata u bënë një, si kokrrat e rrushit në vile.

Në një vile rrushi mund të ketë kokrra me shije të ndryshme. Disa mund të jenë të athëta e disa të ëmbla. Kur shtrydhen, shija e të athëtave përzihet me shijen e të ëmblave dhe në fund del një shije e mrekullueshme. Myslimanët medinas kur u shtrydhën me iman-in, u përzien me shijen e të athtëve; si përfundim doli në pah një vëllazëri e shijshme. Në sajë të kësaj, ymeti islam i përbërë nga muhaxhirët dhe ensarët, të cilët ishin pjesë e Evs-it dhe Hazrexh-it, shijuan unitetin dhe vëllazërinë.

Sa bukur e shpjegon Mevlana përfundimin e unitetit dhe të bashkëjetesës me shembullin e kokrrave të një vileje të rrushit. (*Mesnevî*, II/3699-3715). Kur rrushi është i pabërë, të rrudh buzët prej shijes së athët. Shumë njerëz që nuk kanë fort kuptim individualisht, mbulojnë hapësirat, duke u bërë të vlefshëm në shoqëri. Me një shije dhe aromë tjetër zënë vendin e tyre në unitet.

Ata që ftojnë njerëzit në unitet, janë si ata që i ftojnë për në diell. Dielli një është, por kur rrezet e tij hyjnë në shtëpi nga dritaret, bëhen me mijëra. (*Mesnevî*, IV/415.) Në mendjen e njerëzve, sa ka shtëpi aq ka edhe diell. Por, kur shohim rrezet e diellit në shtëpi dhe prej aty shohim diellin, vërejmë se ai është vetëm një. Prandaj, ata që kërkojnë dritën, vetëm kur kërkojnë ndriçimin arrijnë në unitet, në unitetin e diellit.

Kur njeriu vëren burimin, sado shumë dhe në sasi qoftë gjithçka përreth, aty shikon njëshin dhe unitetin, gjë që e bën të mos i shikojë të tjerët apo veten të ndryshëm, pasi tek të gjithë ka një frymë hyjnore të njëjtë. Andaj, çdo njeri është i çmuar.

Ky shpirt është ai që e shpie njeriun për tek ideja e unitetit. Kurse shpirti shtazor nuk ka ndonjë pasion të tillë për unitetin.

Islami solli bazat kryesore të shuarjes së dallimit mes arabit dhe joarabit, mes të bardhit dhe të ziut, mes shërbëtorit dhe zotërisë së vet (Muslimi, Haxh, 147); duke ndaluar çdo lloj shfaqjeje të klasifikimit shoqëror mes njerëzve dhe diskriminimit racor dhe duke shpallur se, më të dalluarit janë vetëm ata që kanë përkushtim devotshmërie ndaj Allahut. Asnjë qeveri e krijuar gjatë 14 shekujve të historisë islame, nuk ka vepruar asnjëherë sipas qasjes së diskriminimit racor.

Të jesh pjesë e një race apo fisi nuk është në vullnetin e njeriut. Askush nuk pyetet para se të vijë në këtë botë se “fëmijë i cilës familje dëshiron të jesh?” apo “pjesë e cilës racë dëshiron të bëhesh?”. Kësisoj, aq sa është e pakuptimtë mburrja e njeriut me atë çfarë nuk e ka pasur në dorë, po aq e pakuptimtë është edhe përbuzja e tjetrit me atë çfarë nuk ka zgjedhur vetë të jetë.

Cilësia që i bën dobi më shumë besimtarit në dynja dhe ahireti, është të dojë dikë për hir të Allahut dhe atë që nuk e do, të mos e dojë për hir të Allahut. I Dërguari i Allahut e vlerëson këtë veçori si manifestim i përsosmërisë së besimit, duke treguar se ai që ka arritur në një besim, do ta shijojë shijen e besimit. (Buhari, Iman, 9, 14). Në Ahiret do të përfundojnë të gjitha miqësitë, afrimitetet, dashuritë dhe lidhjet, duke u bërë të gjithë armiq të njëri-tjetrit. Me një përjashtim të vetëm: ata do të jenë të devotshmit. (Zuhruf, 67.)

Prandaj dhe *atë që do, dua je për hir të Allahut*, është një portë e lartë dhe një status madhështor etik. Dashuria e sinqertë krijohet pas pastërtisë së brendshme. Zemrat që kanë harmoni ndërmjet njëra-tjetrës, dëlirësohen. Nëse nuk gjendet një harmoni shpirtërore mes zemrave, atëherë bashkëjetesa mes njerëzve mbetet vetëm në varësi të interesave. Vetëm harmonia dhe dashuria me qendër besimin mes zemrave, formojnë terrenin e mirësisë dhe bukurisë.

Ato çfarë përbëjnë identitetin e shoqërisë islame, janë vlerat fetare dhe njerëzore. Kurrë nuk është bërë shkak garimi, dallimi mes gjuhëve dhe racave. Komunikimi me gjuhë të ndryshme i ushtarëve që ruajnë atdheun, kurrë nuk ka krijuar problem.

Në Epokën e Lumturisë, përreth Profetit Muhamed (a.s.), ishin shkrirë nën çatinë islame si myslimanë; si arabi ashtu edhe iranian, ebisinas, romaku, jemenasi dhe të tjerë me kombësi, racë e fe të ndryshme. Gjatë këtij procesi, nga Epoka e Lumturisë gjer më sot, nuk është bërë kurrë problem përkatësia e feve dhe gjuhëve të tjera.

Sot është një detyrë njerëzore t'ia përmendim këto të vërteta çdokujt që vlerëson unitetin dhe bashkëjetesën. Andaj është një përgjegjësi që të kujtohem se e kemi vëlla tjetrin, para se ta tëhuajsojmë.



Martesa pothuajse një rekulli

— Xhafer Durmush —

Po lexoj suren Rrum, buqetën e ajeteve, e cila konsiderohet prej argumenteve që tregojnë fuqinë hyjnore...

Në këtë sure ka shtatë ajete, që fillojnë me shprehjen “ve min ajatihî”. Të gjitha këto ajete na ftojnë në klimën e një meditimi të veçantë. Në njërin prej tyre thuhet:

“Dhe njëra prej shenjave të Tij është që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë.” (Rrum, 21)

I ndjeri Omer Nasuhi Bilmen e shpjegon kështu ajetin fisnik, i cili përbën temën tonë: “Njëri prej argumentave se Zoti do t’i ringjallë përsëri robërit e tij dhe do t’i shpjerë në botën e shpërblimit, është fakti se Ai ka krijuar gjëra me të cilat ata gjejnë qetësi dhe ndërmjet tyre ka vendosur dashurinë e mëshirën.”

Ajeti fisnik inkurajon të menduarit mbi familjen në aspektin e formimit dhe të funksionimit të saj.

Edhe pse në Kuranin Fisnik thuhet se edhe krijesat e tjera janë krijuar çift (En’am 6/143.), aty nuk bëhet fjalë se ndërmjet tyre është vendosur dashuri dhe respekt. Domethënë se Allahu i Madhëruar e ka bekuar lidhjen bashkëshortore ndërmjet njerëzve me ndjenja të larta, si dashuria, besnikëria dhe mëshira. Ajo nuk është e lidhur vetëm me dëshira

dhe pasione. Nisur nga kjo, dëshiron që bashkimin ndërmjet tyre ta bëjnë me një lidhje të shenjtë, e cila quhet martesë. Kështu që, dashuria dhe mëshira, së pari arrin ata të cilët e kanë formuar vatrën e tyre me dashuri dhe mëshirë.

Allahu i Madhëruar dëshiron që kjo lidhje të begatohet me brezat që do të vijnë pas tyre. Ai dëshiron që nga kjo lidhje të lindin fëmijë, të cilët do të fitojnë lumturinë e të dy botëve dhe të formohen civilizime, të cilat mbështeten në dashuri dhe mëshirë. Sepse, sikur të mos ishin këto ndjenja të larta bashkë me faktorët materialë që i bëjnë njerëzit tërheqës për njëri-tjetrin, do të shtoheshin brezat e njerëzve, por nuk mund të formoheshin civilizimet.

Si domosdoshmëri e urtësisë hyjnore, njeriu nuk është krijuar në një lloj të vetëm, por përkundrazi, ai është nxjerrë në ekzistencë si bashkëshort i barabartë me tjetrin. Edhe pse zhvillohet dhe rritet me këtë formulë bazë, ai është krijuar në dy lloje me veçori të ndryshme fizike, me strukturë psikologjike të ndryshme dhe me ndjenja e dëshira të ndryshme.

Ndërmjet burrit dhe gruas ka vendosur një harmoni në mënyrë që të jenë dy bashkëshortë, të cilët e plotësojnë njëri-tjetrin si dy gjysmat e mollës. Nevojat fizike dhe psikologjike të njërit, plotësohen me veçoritë e tjetrit.

Bashkimi i njerëzve me njëri-tjetrin fillon me një

lëvizje, e cila së pari lind në zemër. Këta sythe të miqësisë që çelin aty, lidhet me aktin e martesës gjë, e cila do të thotë: Dy të pjekur, të cilët janë rritur në vende të ndryshme, vendosin të jetojnë me njerëz të tjerë në një vend ndryshe nga mjedisi ku janë rritur. Një njeri, i cili më parë konsiderohej i vogël, tashmë hyn në gjendjet private të tjetrit dhe në këtë kuptim kalon para prindërve.

Nga njëra anë, ai vendos të largohet nga shtëpia në të cilën është mësuar të jetojë deri atë ditë. Më së paku, ai vendos të marrë përsipër përgjatë gjithë jetës shërbimet personale të një personi. Tjetri vendos që, më së paku, të mbartë përgjatë gjithë jetës përgjegjësitë materialo-shpirtërore të një njeriu. Për shkak të dashurisë që Allahu ka vendosur në zemrat e tyre dhe e cila në fund synohet që të kthehet në mëshirë, dy njerëz marrin mbi supë përgjegjësi të mëdha.

Substancat prej të cilave është krijuar njeriu janë xhevahire të vdekura që gjenden në tokë, si karboni, sodiumi dhe kalciumi, por në trupin e tij janë vendosur aftësi si ndjenjat, ndërgjegjja dhe fuqia e të imagjinuarit. Po ashtu, ai nuk është një njeri i tipit të vetëm, i krijuar me një fuqi që t'i mbartë këto veçori prej substancave të pashpirta. Nga i njëjti njeri është krijuar edhe pala tjetër dhe këtyre grimcave të vogla që nuk shikohen me sy, u janë dhënë aftësi që ne nuk ua dimë natyrën.

Nëse kuptohen drejt gjërat delikate, për të cilat bëhet fjalë në ajetin që përbën temën tonë dhe, nëse përdoret në vendin e duhur energjia e njeriut, e cila është e stolitur me aftësi, si mendja, gjykimi, fuqia e imagjinatës dhe të kuptuarit, të gjitha këto kthehen në dashuri në fund të dëshirave. Bashkimet, që në fillim bëhen për shkak të dashurisë së madhe, me kalimin e kohës mund të kthehen në një klimë shpirtërore në të cilën sundon mëshira. Pastaj nga aty, ndiqet një rrugë, e cila të shpie në lumturinë e përhershme.

Në Ruhul-Bejan shkruan se në ajetin fisnik bëhet fjalë për martesën dhe përputhjen e shpirtit me nefsin, sepse Allahu i Madhëruar e ka krijuar nefsin (veten e njeriut) nga shpirti dhe në këtë mënyrë është bërë bashkudhëtare e tij. Siç e ka krijuar Havanë nga Ademi dhe e bëri bashkëshorte të tij, edhe nefset i ka bërë bashkëshorte të shpirtave, që të gjejnë qetësi te ato. Për këtë arsye, Havaja nuk iku nga Ademi në xhenet. Sikur nefsi të mos ishte krijuar nga shpirti, shpirti i cili është i butë dhe i bukur, nuk do të gjente qetësi te ajo.”

Nëse mendojmë për miqësinë, mund të themi: Me kalimin e kohës bashkëshortët ushtrohen me njëri tjetrin, ndërsa shpirti ushtrohet me trupin. Për këtë arsye, ndarja e shpirtit nga trupi dhe ndarja e bashkëshortëve nga njëri-tjetri, është gjithmonë pikëlluese. Ndoshta këtë mund ta shpjegojmë me epërsinë që mëshira ka ndaj dashurisë. Nisur nga kjo, akti i martesës, i cili i bën bashkëshortë dy

njerëz, është një hap madhështor i hedhur drejt së ardhmes, në emër të mbrojtjes dhe të lartësimit të nderit të njerëzisë.

Mendon: Dy njerëz që më parë përmendeshin duke e lidhur emrin me prindërit e tyre, për shkak të kësaj, vijnë në një gjendje që brezi tjetër tashmë lidhet me ta. Me të vërtetë, bashkimet, që kanë pjesë nga Tevhidi kalojnë më me lehtësi nga dashuria në mëshirë dhe vatrën, të cilat formohen brenda kësaj kornize, formojnë bërthamën e bereqetshme të shoqërisë.

Pejgamberi, (a.s.), thotë: *“Mirësinë më të madhe, pas devotshmërisë, besimtari e ka te gruaja e devotshme.”* (Ibn Maxhe, Nikah, 5/1857.)

Mirësia dhe begatia, për të cilat bën fjalë i Dërguari i Allahut (s.a.s.), është e qartë se i përkasin çdo burri dhe çdo gruaje që e meriton cilësinë e devotshmërisë.

Populli ynë e ka formuluar me fjalën “në martesë ka mrekulli”, përmbajtjen e praktikimit të këtij ajeti. Shoqëritë, të cilat nuk e dinë vlerën e mrekullisë, shihet qartë se në çfarë batakut janë zvarritur.

Të pastërtit janë për të pastërtit

Allahu i Lartësuar, thotë: *“Gratë e këqija janë për burrat e këqinj. Burrat e këqinj janë për gratë e këqija. Gratë e pastra janë për burrat e pastër. Burrat e pastër u kanë hije grave të pastra...”* (Nur 26)

Këtë ajet fisnik, i cili ka zbritur në lidhje me ngjarjen e ifkut, në suren Nur, po përiqem ta kuptoj brenda tërësisë së Kuranit Fisnik. Vëmendjen time po e tërheq sugjerimi që u bëhet besimtarëve për të qenë konsequentë ndërmjet tyre dhe për të qëndruar me të drejtët (Shik. Tevbe 119) në Kuranin Fisnik me disa kritere që nuk e lejojnë miqësinë me çifutët dhe me kristianët. (Shik. Maide 5/51.) Pastaj po mendoj për të vërtetën madhështore që ka thënë i Dërguari i Allahut:

“Shpirtat janë si ushtri të rregullta.” Me këtë, ai tregon se çdo njeri do ta kërkojë dhe do ta gjejë atë që i përshtatet atij.

Besimtari duhet të pastrohet që ta meritojë cilësinë “i pastër” dhe të pastrit patjetër duhet të kërkojnë të pastrit.

Rroba mbron trupin, njeriu mbron njeriun.

Në suren Bakara, për të treguar pozitën që kanë bashkëshortët ndaj njëri-tjetrit, thuhet: *“Ato janë (si) petk për ju dhe ju jeni (si) petk për to.”* (Bakara 187)

Rroba e mbron njeriun nga i nxehti, nga i ftohti, nga disa rreziqe të tjera dhe nga sytë e këqinj. I mbulon vendet e turpshme. Të gjitha këto janë nga një shembull për çështjen që u diskutua.

Mbrojtja e njeriut ndaj njeriut është aq e madhe, saqë nuk mund të krahasohet me atë të rrobave.

MERE HYSEJN PASHA

KRYEMINISTRI I SHQUAR OSMAN QË NUK E FLISTE TURQISHTEN.

— Dr. Ardian Muhaj —

Mere Hysejn Pasha (Mere Hüseyin Pasha) ka qenë kryeministër dy herë. Herën e parë më pak se një muaj nga 13 qershori deri më 8 korrik 1622. Herën e dytë për disa muaj nga 5 shkurti deri më 30 gusht 1623.¹ Mbi origjinën shqiptare të tij nuk ka pasur ndonjëherë dyshim.² Ishte nga familja e Begollëve të Pejës³ dhe vdiq në korrik të vitit 1624. Ashtu sikurse në rastet e tjera në postin e sadrazamit vinin vetëm njerëz me aftësi e kontribute të dëshmuara më herët dhe në detyrën kryeministore emëroheshin pikërisht për meritat e tyre. Edhe Hysejn Pasha përpara se të vinte në postin e kryeministrit kishte mbajtur funksione të larta e të rëndësishme, më i spikaturi i tyre ishte ai i bejlerbeut të Egjiptit në vitet 1620 deri më 1622.⁴ Në traditën historiografike konsiderohet si kryeministri i vetëm osman që nuk ka ditur gjuhën turke. Gjithashtu mendohet se epiteti me të cilin ai njihej si “Mere” ka të bëjë me fjalën shqipe “merre”, gjoja sikur ngaqë me këtë fjalë urdhëronte arrestimin dhe ekzekutimin e kundërshtarëve të tij. Kjo duket se nuk është e vërtetë dhe në fakt përbën një shtrembërim të qartë. Në fakt, epitetin “Mere” duket se e ka pasur për shkak të një fjale tjetër shqip të cilën ai me sa duket e përdorte me aq tepri sa që kishte rënë në sy të bashkëkohësve të tij. Bëhet fjalë për shprehjen “more”, si në shprehjen “mre burra!, mre njerëz! etj.

Arsyeja pse nuk e dinte gjuhën turke dhe megjithatë arriti të bëhej një nga kryeministrat më gjurmëlënës në historinë osmane ka të bëjë me karrierën e tij që u zhvillua jashtë zonave turqishtfolëse. Së pari ai nuk vinte nga trupa e jeniçerëve të cilët përfaqësonin bërthamën qendrore të aparatit ushtarak osman dhe që kishte afërsi më të madhe me qendrën politike, Stambollin, por nga trupat e spahinjve që përbënin trupën e provincave. Spahinjët

mund të qëndronin gjithë jetën në detyrë pa qenë nevoja të dalin jashtë vendeve ku banonin. Aq më tepër që në këtë kohë spahinjët po shndroheshin në një shtresë sedentare që i trashëgonte timaret. Nga ana tjetër nuk duhet harruar se shteti osman nuk kishte një gjuhë zyrtare, por kishte disa gjuhë administrative në përputhje me traditën e vendeve e zonave që e përbënin këtë shtet. Kështu Mere Hysejn Pasha mund të arrinte shkallën më të lartë të pushtetit thjesht duke ditur një ose disa nga këto gjuhë. Gjuha amtare shqipe natyrisht që duhet të ketë qenë e mjaftueshme për komunikimin në oborin sulltanor, por edhe arabishtja të cilën mund ta ketë përvetësuar gjatë karrierës së tij në vendet arabe dhe sidomos në postin shumë të rëndësishëm të qeveritarit ose bejlerbeut të Egjiptit në korrik 1620.

Mbi veprimtarinë e tij si guvernator apo bejlerbe i Egjiptit na informon një kronikë e kohës e shkruar nga Shemseddin El Bekri es Sadiki. Autori i saj edhe pse e përshkruan si njeri me karakter të hapët dhe modest dhe sjelljen e tij e quan si të ashpër flet me shumë dashamirësi për këtë figurë. Nga kronika e këtij autori në fakt shohim se Hysejn Pasha ishte një qeveritar shumë i përgjegjshëm dhe administrator i aftë edhe pse i përballur me situata të vështira politike dhe vështirësi të mëdha të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore. Caktimi i tij në postin e guvernatorit të Egjiptit kishte ardhur si pasojë e ankesave të shumta që tregtarët dhe qytetarët e Egjiptit i kishin dërguar sulltanit duke denoncuar korrupsionin dhe keqqeverisjen e bejlerbeut të mëparshëm të quajtur Mustafa Pasha.⁵ Pak kohë pas mbërritjes në Egjipt dhe pak pasi kishte

1. Ismail Hâmi Danismend, *Osmanlı Devlet Erkânı*, Türkiye Yayınevi, İstanbul, 1971

2. İsmail Hakkı Uzunçarşılı, *Osmanlı Tarihi III. Cilt, 2. Kısım*, XVI. Yüzyıl Ortalarından XVII. Yüzyıl Sonuna kadar, Ankara: Türk Tarih Kurumu, 2011, p. 380

3. Nehat Krasniqi, *Zhvillimi i kulturës shqiptare me ndikime orientale prej shekullit XVIII deri në fillimet e Rilindjes Kombtare*, Prishtinë: Instituti Albanologjik, 2017, f. 88.

4. Yılmaz Öztuna, *Büyük Osmanlı Tarihi: Osmanlı Devleti'nin siyasi, medenî, kültür, teskilât ve san'at tarihi*, 1994, 10, f. 412-416.

5. Hysejn Pasha anuloi të gjitha vendimet e padrejta dhe taksat e reja që kishte vendosur guvernatori i mërpashëm Mustafa Pasha. Më pas urdhëroi nisjen e një hetimi dhe mblodhi të gjithë tregtarët që ishin dëmtuar prej veprimeve të tij. Nga dëshmitë e mblledhura dhe nga dëshmia e vetë Mustafa Pashës doli se ai kishte zhvatur padrejtësisht nga tregtarët 33 mijë groshë dhe rezultatet e këtij hetimi iu dërguan Portës. Silvestre de Sacy, ed. “The Book of the Wandering Stars. Containing the History of Egypt and Cairo by the Sheik Schemseddin Mohammed ben Abilsorour al Bakeri al Sadiki. Arabian Manuscript, no. 784” në *Accounts and Extracts of the Manuscripts in the Library of the King of France*, published under the inspection of a committee of the Royal Academie of Sciences at Paris, transl. from the French, Volume 2 London: R. Faulder, 1789, f. 43

rivendosur drejtësinë dhe rregullin, me sa duket ndryshimi i klimës ndikoi në shëndetin e tij. Qëndroi i sëmurë për disa muaj. Pas shërimit fëmijët e tij i bënë një festë të madhe. Madje pati festime edhe nga banorët e Kajros për shërimin e tij. Me sa duket masat e marra kundër korrupsionit të paraardhësit dhe drejtësia e qeverisjes e kishin bërë aq populor sa që shumë njerëz i uronin shërimin duke i sjellë dhurata të panumërta. Po ai shumicën e tyre i kthente mbrapsht dhe mbante vetëm ato me vlerë dhe nga njerëzit e pasur.⁶

Vërshimi i Nilit në përmasa të pazakonta gjatë kohës që ishte guvernator shkaktoi shumë dëme në kulturat bujqësore, duke shkatërruar të mbjellat e për pasojë, duke shkaktuar mungesë ushqimesh.⁷ Pas përballjes edhe me sfidën e menaxhimit të kësaj fatkeqësie natyrore, dhe pas stabilizimit të gjendjes u thirr në Stamboll në pranverë 1622. Kryefinancieri i kabinetit të tij ndërkohë mori në dorë përkohësisht pushtetin si zëvendës i tij (kajmekam) derisa të vinte qeveritari i ri dhe kërkoi që të shlyente një sërë detyrimesh ndaj thesarit duke ngritur pretendimin se Hysejni kishte përfituar shuma nga thesari dhe sasi drithi nga magazinat e hambarit. Hysejn Pasha likujdoi pjesën më të madhe të sasisë që kërkohesh pa diskutuar vërtetësinë e akuzave. Pasi pagoi gjysmën e sasisë së pretenduar kërkoi që pjesën e mbetur ta paguante një hebreu i cili duke përfituar nga shkarkimi i tij nuk kishte përmbushur një marrëveshje mes tyre dhe i kishte borxh atë shumë. Mirëpo hebreu pretendonte se ia kishte paguar borxhin Hysejnit dhe nuk i detyrohej asgjë. Kjo e detyroi Hysejn Pashën që të kërkojë arrestimin e hebreut pasi po përpiqej të mos paguajë detyrimet që nuk i kishte paguar. Kështu pas arrestimit hebreu u dënua për mashtrim dhe u detyrua të paguajë shumën.⁸ Pasi e zgjidhi këtë mosmarrëveshje u nis drejt Rumelisë dhe më pas drejt Stambollit. Fakti që Hysejn Pasha e dëshironte kthimin e tij në Rumeli sa më shpejt dhe bëri ç'ishte e mundur që të zgjidhte mosmarrëveshjet, tregon se nuk është shkarkuar nga posti për paaftësi as për korrupsion, por se po i jepej një post më i lartë. Kështu menjëherë pas kthimit në Stamboll në 13 qershor 1622 u emërua

6. "On this occasion he received an infinite number of presents of all sorts: carpets bordered with gold, horses, sugar, stuffs and even money. He would not accept from any rich person either oil, honey of sheep. If they presented any of these things, he caused them to be sent back to the persons they came and took in the room of them, things of a greater value. Es-Sadiki, në Silvestre de Sacy, ed. "The Book of the Wandering Stars", f. 44.

7. Shkatërrimi i të mbjellave nga përmbytja çoi në rritjen e jashtëz - konshme të çmimeve. Për më tepër përmbytja u shoqërua jo vetëm me mungesa ushqimore por u pasua edhe nga një epidemi murtaje.

8. Hebreu i quajtur Aben amel Albebar pasi u gjet fajtor për mashtrime kolosale u dënua me proces gjyqësor me vdekje. Sipas kronistit "vdekja e tij i lroi njerëzit nga mashtrimet financiare dhe padrejtësitë e tij. Shemsedin Es-Sadiki, në Silvestre de Sacy, ed. "The Book of the Wandering Stars", f. 44.

kryeministër i shtetit osman për herë të parë nga sulltan Mustafa I.

Në këtë detyrë qëndroi për një muaj, deri më 8 korrik të atij viti.

Kronisti na informon mbi arsyen e vërtetë të largimit të tij nga Egjipti. Duket se ishte thirrur nga vetë sulltani për të shtypur revoltën kundër sulltan Osmanit II, i quajtur edhe Osmani i Ri (Genç Osman). Kronisti pohon se popullariteti i tij ishte i tillë sa që të gjitha palët u bashkuan dhe kërkuan caktimin e tij në postin e kryeministrit. Menjëherë Hysejn Pasha riktheu rregullin, emroi nëpër provinca njerëz të denjë për qeverisje dhe u dha fund trazirave.⁹ U emërua sërish kryeministër disa muaj më vonë në 5 shkurt 1623 ku qëndroi deri më 30 gusht 1623. Natyrisht në emërimet e tij do të mbështetej tek shqiptarët. Një nga këto figura ishte edhe Sulejman Pashë Ballgijini, themeluesi i Tiranës, i cili me këtë rast u caktua guvernator i Bagdatit, me detyrën që të rivendoste rregullin në Irak.

Kulmi i veprimtarisë dhe i rolit të tij në politikën e kohës ndodh në zinxhirin e ngjarjeve të vullshme që prekën shtetin më të fuqishëm të botës që nga ardhja në fron për herë të parë e Mustafasë I, në nëntor 1617, ardhja e Osmanit II dhe revoltat që e pasuan ardhjen e tij deri tek vrasja më 20 maj 1622. Mungesa e përvojës politike e Osmanit II dhe paaftësia e tij çoi në braktisjen graduale të tij edhe nga mbështetësit më të afërt, veçanërisht nga ushtria e rregullt. Thellimi i krizës politike e çoi në një dëshpërim aq të madh sa arriti të bënte një plan për zhvendosjen e kryeqytetit në Bursa, Damask ose edhe në Kajro. Mirëpo përhapja e thashethemeve mbi këto plane nuk bënë tjetër veçse e përshkallëzuan edhe më tej krizën dhe çuan tek rivendosja në fron e Mustafait I dhe më pas edhe tek vrasja e Osmanit II. Gabriel Piterberg që i ka kushtuar një libër këtyre ngjarjeve të vullshme në oborrin osman, supozon se drejtuesit e ushtarakëve të pallatit kishin një marrëveshje me Mere Hysejn Pashën për t'u revoltuar.¹⁰ Megjithatë përfshirja e Hysejn Pashës në nxitjen e trazirave nuk është e vërtetuar nga asnjë kronikë dhe dokument i kohës.¹¹ Përkundrazi, dihet roli i tij vendimtar në rivendosjen e rendit dhe qetësisë mbas një situatë kaotike dhe të trazuar.

9. "All parties united to name him to the dignity of grand vizir. He re-established good order, bestowed the government of the provinces of men worthy of such employ and put an end to all troubles." Shemsedin el Bekri Es-Sadiki, në Silvestre de Sacy, ed. "The Book of the Wandering Stars", f. 45.

10. Gabriel Piterberg, *An Ottoman Tragedy: History and Historiography at Play*, Berkeley and Los Angeles: University of California Press, 2003, f. 130.

11. Gottfried Hagen, University of Michigan, në Review për H-Turk.



— Edison Çeraj —

Në njëfarë kuptimi, e gjithë krijimtaria e Myrtezait përqendrohet në heqjen e çdo shtrese¹ që i është mbivendosur subjektit në kushtet e kohës dhe hapësirës, pra në kushtet e qytetërimit, në veçanti të mënjami i skematikes, i konvencionit për korrekten e për konformizmin. Kemi të bëjmë me një rizbulim të subjektit.

Qytetërimi kërkon te njeriu qytetarin, të cilit i jep një funksion, dhe ky funksion është i lidhur me një kohë dhe hapësirë të caktuar ku aplikohet. Me t'u përmbushur detyrimi që dikton funksioni, atëherë kalohet në një funksion të ri, dhe kështu futemi në procesin ose dinamikën e utopisë. Në gjithë këtë ndërmarrje, çdo hap i hedhur duke synuar të ashtuquajturin progres, hap pas hapi (shtresë pas shtrese) është një afrim me tjetërsimin e qenies. Shndërrimi i Gregor Samsa-s në një kandërr nuk është lojë, as gjetje figurative. Sikundërse nuk janë të tilla as deformimet e subjektit – në veçanti të subjektit njeri – në veprat e shumë autorëve, sidomos te Picasso-ja, Bacon-i apo Minjun-i.

Tjetërsimi që arrijmë të shohim, si në rastet e

mësipërme, është rrjedhojë e një tjetërsimi të cilin nuk arrijmë ta shohim.

Duke pasur parasysh këtë, arti vjen te qenia si vetëdije, si kujtesë, pikërisht për këtë lloj tjetërsimi. Kështu, arti është antidoti i tjetërsimit, sepse ai na kujton atë që kemi humbur. Arti është i mundur vetëm atëherë kur nuk diktohet apo tregohet se si duhet të jetë i mundur.

Në rrugëtimin e Myrtezait mund të pikasen tri faza: ajo para viteve '90, e cila shënjohej nga përpjekja për ta çliruar subjektin nga sistemi (realizmi socialist) dhe për t'ia kthyer atë artistit/individit, fazë kjo ku mbizotëron një qasje gati dekorative, herë abstrakte e herë simboliste; ajo pas viteve '90, kur kjo përpjekje gjen rrugën e vet të pritshme dhe identifikon profilin e autorit: tërheqje drejt vetes dhe antikonformizëm, duke bërë kështu që vepra e tij të jetë një prej gurëve kryesorë të themeleve të artit bashkëkohor në Shqipëri; dhe faza e tretë, ku çlirimi i subjektit i gëzohet (ri)zbulimit të tij. Përveç kësaj, në këtë fazë, që është pikërisht e tashmja, vjen edhe lëvrimi i fjalës së shkruar² përmes

1. Kufizime, rregulla, receta, udhëzime përdorimi, shenja, simbole e kështu me radhë.

2. Sidoqë të shkruarit e ka shoqëruar që herët, dhe këtu mund të kujtojmë vëllimin me poezi *Trumçaku*. Por e veçanta e kësaj faze është

rrëfimit (pa harruar eseistikën), që kryesisht merr shkas nga njerëz e rrethana konkrete, që janë një gurrë e llojit të vet për krijimtarinë, në veçanti për romanin; sepse sipas tij, nuk është e nevojshme të thirren në ndihmë njerëz apo gjendje imagjinare, ngaqë mjafton ajo me të cilën përballemi. Mbi të gjitha, autori i beson përjetimit vetjak, që është më real se realja, sepse është e vërteta e tij e jetuar sa në përmasën fizike e sa në atë metafizike. Janë disa gjëra që duhen rrëfyer ashtu siç janë, duke mos pasur nevojë për trillimin.

Rërë, spango, plastmasë, kompensatë, jastëk, çimento, xhama, alarm, spote – ja disa nga lëndët që formësojnë veprat e viteve të fundit të Myrtezait.

“Me t’u përjashtuar e gjithë transcendenca, sendet janë thjesht ato që janë, dhe si të tilla janë të papërballueshme. Ato bëhen menjëherë dhe krejtësisht reale, pa hije, pa koment. Një gjigant i gatshëm.” (Baudrillard)

Përtej përdorimit për qëllime konkrete konceptore të një lënde të caktuar, gjë që përbën një praktikë të rëndomtë në artin bashkëkohor, qasja e tij ndaj sendeve/lëndës të jep idenë e një përmbysjeje që krijon një gjendje të papërcaktuar, e cila e tejkalon konceptin, dhe si rrjedhojë edhe shpjegimin që kuantifikon si përdhunshëm mesazhin. Vetë gjendja e krijuar – që në shumë raste shënjon poetiken – është mesazhi, një mesazh jolëndor, që nuk shkronjëzohet, dhe si i tillë rroket më shumë përmes shqisës së gjashtë.

Pak a shumë këtë e hasim edhe te pikturat e tij, por në një trajtë *under construction*, si e papërmbyshur, gjithnjë për të shmangur të zakonshmen, ose të pritshmen. Shenjat për ndryshimet që do vinin më pas mund t’i pikasim që në këtë fazë.

Prandaj, kalimi në medime si instalacioni apo videoja pas ’90, nuk është thjesht ngaqë me rënien e regjimit “u hap loja”, gjë që do ishte një lexim i pamjaftueshëm i veprës së tij, por ngaqë piktura nuk ia ofronte këto gjendje në atë përmasë përfshirëse sa instalacioni apo videoja; ngaqë piktura, në njëfarë kuptimi, ia kishte dhënë atë që kërkonte prej saj, dhe kalimi në medime të tjera që një fazë që ia kërkonte domosdoshmëria e brendshme, natyrisht edhe kërshtëria për të eksperimentuar. Kjo e fundit e ka shoqëruar dhe vazhdon ta shoqërojë Myrtezain. Pa kërshtërinë dhe dëshirën për të provuar nuk mund të ketë përtëritje as vepra e as autori. Nuk i shkon për shtat natyrës së artistit siguria apo bindja për një zgjedhje/qëndrim estetik të caktuar, pavarësisht se mund t’i ketë dhënë emër kjo zgjedhje, pavarësisht

se mund t’ia çmojnë njohësit e artit apo publiku.

Myrtezai i është ruajtur vazhdimisht kësaj, duke hequr dorë nga shumë “mundësi” e duke u arratisur drejt vetes. Kjo arrati drejt vetes është e vazhdueshme tek ai.

Duhet theksuar se raporti i tij me medimet ka qenë dhe është vazhdimisht i varur nga natyra e mesazhit që kërkon të kodojë te vepra, dhe jo një raport i paramenduar apo i posaçëm. Ai lloj arti që ka si lëndë të vazhdueshme konceptin – pra që është i paramenduar – është futur (duke trokitur) në territorin e filozofisë. Kështu, një tekst filozofik dhe një vepër arti e kësaj natyre është e njëjta gjë, ndryshon vetëm forma ose mjete i paraqitjes. Në këtë rast, ajo që për-fiton është filozofia, duke iu shtuar një modus; ndërsa artit i kanoset racionalizimi. Natyrisht që në këtë kohë kaq reduktuese dhe njësuere, pra kaq objektive, një veprimtari “subjektive” si krijimtaria artistike, më e pakta është e tepërt, dhe si e tillë e padobishme. Edhe vepra e artit po flijohet në altarin e përdorimit, prandaj dhe duhet të ketë përgjigje konkrete për pyetje konkrete. Duhet zërthyer çdo gjë, çdo element, që të jemi sa më të qartë me çfarë kemi të bëjmë. Edhe vepra e artit mund dhe duhet të modifikohet gjenetikut.

Altari më zulumëmadh i përdorimit në ditët e sotme, ai më i pushtetshmi, me sa duket është presioni për “art bashkëkohor”.

Këto dhe erëra të tjera që sjellin rrethanat, Myrtezai i ka tejkalaur herë me dije e herë të tjera instinktivisht.³

Një prej instalacioneve të tij të viteve të para pas ’90, *Pa titull*, përbëhet nga tre jastëkë, një i zi, një i kuq dhe një i bardhë, poshtë të cilëve është hedhur pluhur çimentoje me ngjyrë, ndërsa përsipër mbajnë disa fotografi të vjetra familjare, të ngjitura me disa gjilpëra të vogla. Është edhe një jastëk i katërt i varur nga lart, rreth një metër distancë, i cili ka dhe numrin më të madh të fotografive, ku fotografitë mbi jastëkët e tjerë duken sikur kanë rënë prej tij. Përveç këtij elementi, pjesa tjetër e veprës është vendosur në dysheme. Marrëdhënia mes jastëkut dhe një fotografie, ku jastëku përfaqëson çlodhjen, gjumin, ëndrrat dhe një të tashme të përherëshme, dhe fotografia që shënjon gjithnjë të shkuarën, është një gjetje proverbiale për të transmetuar nostalgji – një tërësi pamore që përthyeret mes zhvendosjes dhe rikthimit. Kjo vepër bën pjesë në ato raste ku intimitja bëhet publike pa iu cenuar thelbi asnjërisht; domethënë, intimitja vazhdon të mbetet e tillë, edhe pse ndahet me të tjerët në një vend publik. Intimitja shënjon publikun si kujtesë për brishtësinë e dalli-

se të shkruarit zë një vend më qendror, kur del dhe libri me rrëfime *Atdheu si Dasanta H.*

3. Në kuptimin krijues të termit.

mit. Dallimi bën testin jo thjesht të shijeve të vizitorëve, por të mendësisë që ata mund të kenë edhe pa vetëdije. Kjo bëhet e përfutueshme vetëm atëherë kur publiku përpiqet të komunikojë me veprën, që nuk mjaftohet vetëm me një shikim memec, siç ndodh rëndom.

Një tjetër vepër tek e cila mund të ndalojmë pak është edhe *No art zone*, që përbëhet pikërisht nga teksti në fjalë dhe nga një fotografi fare “rastësore”⁴, e shkrepur nga ana e artistit në një moment rutinë gjatë një udhëtimit, kur bashkëshortja e tij ndihmon të bijën e vogël për të kryer nevojën personale në një zonë të hapur dhe të errët.

Ndërveprimi i tekstit me imazhin bart të njëjtën rëndësi si te *La Trahison des images* e Magritte-it; që nënkupton se nëse nuk do ishte teksti, do kishim të bënim vetëm me një fotografi e shumta intriguese. Por, falë tekstit “no art zone”, graviteti zhvendoset nga imazhi te mesazhi (koncepti). Skena e fotografuar, nga “profane” bëhet “e shenjta”; nga një kujtim pikant shndërrohet në një lojë filozofike; nga një përvojë rutinë bëhet një përvojë artistike; ashtu siç ndodh me një këngë, ku fjala i jep përfutueshmëri melodisë, po ashtu edhe në këtë rast teksti i jep trajtën e munguar imazhit. Fjala është një ndërmjetëse e pazëvendësueshme.

Të rrëfesh

Duke qenë se në disa raste një e vërtetë për qenësinë nuk mund të thuhet troç apo me dy fjalë, pasi rrezikon të harrohet apo të mos merret seriozisht, ose të mos kuptohet, në këtë pikë lind nevoja për ta veshur me tekst; pra lind nevoja për atë që tashmë njihet si letërsi. Fjala *tekst* rrjedh nga latinishtja, dhe fjalë për fjalë do të thotë “veshje”.

Puna është se esenca lipset përpunuar ca, sepse nuk kapërdihet dot në atë gjendje.

Kur themi “një e vërtetë për qenësinë”⁵, nënkuptojmë atë lloj të vërtetë e cila ka të bëjë drejt-përdrejtë me çdo njeri, ose i drejtohet çdo njeriu, pavarësisht kohës dhe hapësirës nga e cila vjen, dhe pavarësisht besimit e botëkuptimit që mund të ketë. Sido që të jetë dhe çfarëdo ndryshimesh të pësojnë rrethanat, për një të vërtetë të tillë ka nevojë çdo qenie.

Në fakt, pikërisht ngaqë çdo njeri lind e jeton në rrethana të ndryshme, ka “hallet” e veta të ndryshme nga të tjerët, lind natyrshëm nevoja që rrëfimi i një të vërtete të njëjtë, e cila në thelb ka të bëjë me çdonjërin, të shpërfaqet e ndryshme në formë.

Fjala vjen, nëse do marrim romanin e shekullit të XIX, mbase periudha më e begatë e romanit, shohim një gjeografi diverse romanore, që rëndom ndahet si romani rus, francez, amerikan, anglez e kështu me radhë, e cila karakterizohet nga një larmi domethënese në veshje (formë), por të gjitha këto veshja janë endur për njeriun.

E njëjta gjë vlen edhe për një periudhë si ajo e Shakespeare-it dhe e Cervantes-it, që i takojnë të njëjtës periudhë, por, i pari përdor si veshje të të vërtetave tragjedinë, ndërsa i dyti romanin. Kjo sepse, një arsye e domethënese është se këta dy autorë jetonin në rrethana krejt të ndryshme, ku konteksti i Shakespeare-it kishte përbrendësuar teatrin si kult(urë), ndërsa ai i Cervantes-it ishte i lidhur fort me narrativën, me të treguarit.

Pavarësisht se personazhe si Akili, Edipi, Uliksi, Sheherzadja, Hamleti, Don Kishoti, Guliveri, Robinson Kruzo, Zhan Valzhani, Ema Bovari, Aliosha, David Koperfildi, Jozef K., Godoja e shumë të tjerë janë krejtësisht të ndryshëm për sa i takon kohës dhe hapësirës ku janë ngjizur, çdo lexues bëhet njësh sot me ta, pasi ata kulmojnë me një kumt që i drejtohet secilit nga ne në mënyrë të përveçme. Këto personazhe janë vëllezër e motra të të njëjtit urdhër: të mbrohet njerëzorja, pra të mbrohet njeriu nga bota. Ja pra se pse ata na rrëfohen, ngaqë njeriu e ka të domosdoshme të përmendet herë pas here nga narkoza që quhet botë. Prandaj, bota dhe arti rrugëtojnë në drejtime të kundërta, sepse bota e redukon qenien në funksion të..., kurse arti në qëllim; ose arti është antipodi i natyrshëm i botës.

Kur vijmë te rasti i Myrtezait, mund të themi se shumë rrëfime të tij marrin shkas nga njerëz e rrethana konkrete, që janë një gurrë e pashtershme për krijimtarinë, në veçanti për letërsinë, dhe kështu, sipas tij, nuk është e nevojshme të thirren në ndihmë njerëz apo rrethana imagjinare.⁶ Ja se si e shpreh Tarkovski këtë: “Nuk besoj në fuqinë e fiksionit. Nuk u besoj atyre filmave që nuk janë ngjarje/përjetim vetjak.”

Në këtë pikë duhet përmendur koha e komunizmit, që për shkak të një eksperimenti të pashoq me frikën dhe mbylljen qenësore, pati si rrjedhojë një shpërftyrim të llojit të vet, por, natyrisht, edhe forma rezistence (në Shkodër ishte humori) që ishin kaq të mrekullueshme e të çuditshme sa sot tingëllojnë si rrëfime me kreshnikë e zana.

A nuk duhet rrëfyer diç nga kjo, aq më tepër kur je dëshmitar? Për Myrtezain pa dyshim që po, sepse mbi të gjitha kjo është kujtesë. Te rrëfimet që lidhen me atë kohë, ai heton ato gjurmë që u

4. "Rastësia është thjesht mosnjohje e shkakut nga ana jonë." (Borges)

5. Apo thjesht kur themi atë që sipas nesh ia vlen të thuhet, të ndahet me të tjerët.

6. Duhet thënë se vjen një çast dhe bëhet gati e pamundur që të bësh një ndarje mes reales dhe imagjinare, pasi ato marrin e japin me njëra-tjetrën.

shpëtojnë lenteve standarde që dokumentojnë vetëm çfarë mund të matet e të klasifikohet. Po ajo që nuk matet? Në këtë pikë ndërhyt një lente tjetër – ajo e artistit. Është pikërisht ky i fundit që na jep mundësinë për të parë atë që nuk na e ofron dot, fjala vjen, historiani apo gazetari.

Siç e përmendëm, Myrtezait gjurmon për personazhe dhe ngjarje të cilat i kemi përreth, krejt pranë, që shpërfaqen me ne ose pavarësisht nga ne. Por, nën arsyetimin që i klasifikon ato si rutinë, që natyrisht i largon nga fokusi i vëmendjes, na humbet një puls atipik jetësor që dëshmon shumëçka për sa i takon përmasës etike dhe estetike të të jetuarit.

Është fjala për atë lloj pulsi që zakonisht anashkalohehet nga historianët, e po aq edhe nga shkrimtarët, për shkak të angazhimit me të ashtuquajturat tema të mëdha/të rëndësishme.

Pra, Myrtezai hedh një fashë drite mbi një territor që zakonisht nuk vihet re. Personazhet e tij nuk kanë dilema morale si ata të Tolstoit, apo dilema ekzistenciale si ata të Kafka-s, apo kllapi në sjellje si ata të Beckett-it. Personazhet e tij shpërfaqen çlirët, të pamisifikuar, të zhveshur nga çdo orvatje letrarizuese, në një rrugëtim pothuaj të parashikueshëm, të molepsur për të përmbushur nevoja të ngutshme, nga ato që në shumë raste nuk të lënë rehat, që të turbullojnë jo pak, duke të kujtuar “lehtësinë e papërballueshme të qenies”. Kemi të bëjmë me një zhbirillim për gjëra “të vogla”.

Në shikim të parë, këto rrëfime mund të grupohen nën çatinë e realizmit, ngaqë ngjajnë si copëza të fotografuara personash dhe marrëdhëniesh konkrete. Por, nuk është tamam kështu, pasi autori i tyre nuk e ka as mjeshtërinë dhe as durimin që lipset për të qenë një realist, dhe mbi të gjitha nuk është caku i tij.

Fillimisht çdo gjë nis me një shkrepje të beftë, e cila i hap rrugën një reaksioni që kalon nga filtri që përftohet falë simbiozës së kujtesës dhe përjetimit.

Jam i mendimit se kemi të bëjmë me një fenomen që mund ta quajmë *rituali i shkëputjes dhe i kalimit*; sepse stili që ai sheh nga njëri rrëfim në tjetrin, madje brenda një rrëfimi të vetëm, nga njëri episod në tjetrin, përballemi me një nevojë të brendashkruar të tekstit për të ndodhur një ndërprerje e menjëhershme dhe për një kalim po të menjëhershëm drejt e në zemër të një tjetër episodi, që aty për aty, ngjan pa ndonjë lidhje të pritshme logjike.

Për autorin këto mund të jenë disa rryma të cilat

duhet të çojnë ujë te një mulli, gjë që edhe ndodh në fund, kur atuari vë pikën, pikë e cila përfaqëson një sheshpushim në pritje të rrëfimit pasardhës.

Për sa më sipër, ne arrijmë të kuptojmë se muza e autorit është ajo çfarë e tërheq dhe e provokon nga rrethanat e përditshme, ku pleksen personazhe, vende dhe ndodhi të ndryshme, që nëse do i marrim të shkëputura, nuk kanë asgjë të pazakontë, por kur gërshetohen gjatë rrëfimit pikasim përmasën autentike të mëvetësisë së autorit.

Ky lloj gërshetimi është një rrjedhojë e pritur e ritualit të shkëputjes dhe kalimit që përmendëm më lart, për të cilin ka nevojë rrëfimi, dhe si i tillë ngjan disi i ngatërruar, ose me një dozë të fortë subjektiviteti, që në shumë raste nuk merr parasysh as njëfa-

rë objektiviteti minimal për të cilin ka nevojë logjika receptuese e lexuesit. Pikërisht për këtë, lexuesi duhet t'i transcendojë me aq sa mundet kufizimet e logjikës, të cilat shpeshherë shndërrohen në një rretë e cila të bllokton, duke të penguar kështu për të rrokur frymëmarrjet që dihatin ndërmjet rreshtave.

Në këtë rast rreshtat janë përditshmëria nga e cila merr shkas autori, kurse mes rreshtave mund të gjejmë frymët e pagjasshme që i japin fizionomi kësaj lëndë të gatshme, e cila gatuhet nga ne, diku me vetëdije e diku tjetër pa të.

Narrativa e Myrtezait të kujton futjen në një skaner, që megjithëse i sikletshëm, sidomos kur marrim në dorë imazhin (rezultat), është i nevojshëm. Por, këtë imazh-rezultat mund ta lexojë vetëm “specialisti”.

Vepra e tij, qoftë nëpërmjet tekstit e qoftë përmes imazhit është kundërutopike.

Kështu, tani mund të shtojmë edhe këtë: fokusi i Myrtezait është edhe pikasja e atyre personazheve të cilët shkëputen mrekullisht dhe dramatikisht nga rrethanat, nga sistemi. Në kësi rrëfimesh nuk ka vend për njeriun mesatar, për qytetarin korrekt, për atë që bën atë që “duhet” bërë.

Një ndihmë në këtë kontekst na e jep një “përkufizim” i Pasolinit: “Ajo nuk ka kuptuar asgjë, sepse është një njeri mesatar. Një njeri mesatar është një përbindësh, një kriminel i rrezikshëm, konformist, racist, zhuls, indiferent.”

Myrtezai kërkon/krijon atë personazh që i ka rezistuar botës me mënyrën e tij/saj të veçantë, që ka lënë një shenjë e cila meriton vëmendje.



Dy bazat e identitetit të myslimanit

— Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan —

Nga Malik bin Enesi transmetohet se Profeti, (a.s.), ka thënë: "Ju kam lënë dy gjëra që nuk do t'i humbisni. Ato janë: Libri i Allahut (Kurani) dhe Suneti i të Dërguarit të Tij."¹

Dy bazat kryesore të islamit janë Libri (Kurani) dhe Suneti, që do të thotë: jeta dhe udhëzimi i Profetit, (a.s.). Asnjë mendim dhe praktikë që nuk mbështetet drejtpërdrejt ose indirekt dhe që nuk buron prej këtyre dy burimeve, nuk mund të fitojë statusin e përfshirjes në fenë islame.

Hadithi që përmendëm më lart, i cili zë vend në transmetimet që kanë lidhje me Haxhin e Lamtumirës, bën pjesë në fjalitë e fundit këshilluese të Profetit, (a.s.). Siç shihet qartë në transmetimin që është në Muuatta, i cili bazohet në komentimin e Zurkani-ut², këto fjalë i përkasin kohës dyditore "para vdekjes së Profetit, (a.s.)." Prandaj, duhet t'i kushtojmë rëndësi qëndrimit mbi të.

Dy parimet kryesore të islamit, i cili është dërguar si fe e fundit dhe e përsosur, janë Libri (Kurani) dhe Suneti, që do të thotë: jeta dhe udhëzimi i Profetit, (a.s.). Asnjë mendim dhe praktikë që nuk mbështetet drejtpërdrejt ose indirekt dhe që nuk buron prej këtyre dy burimeve, nuk mund të fitojë statusin e përfshirjes në fenë islame. Për këtë, në të kaluarën dijetarët janë përpjekur të vlerësojnë me të gjitha fuqitë dhe metodat shkencore këto dy burime themelore dhe të përcaktojnë mënyrën më të duhur të ekzekutimit, sipas kushteve të periudhës dhe të vendit në të cilën kanë jetuar. Pikërisht kështu, ata kanë mundur t'u fitojnë një "status islam" mendimeve dhe zbatimeve të tyre. Përveç kësaj, ata kanë luftuar duke iu përmbajtur kufijve të Kuranit

dhe Sunetit, për të kundërshtuar çdo zhvillim dhe rrymë të huaj për islamit dhe kanë ndihmuar në ruajtjen e vlerave islame të popujve.

Sipas hadithit të mësipërm, Kurani dhe Suneti, të cilët janë dy parimet kryesore të padiskutueshme të islamit, janë shkaqe për udhëzimin dhe lumturinë e myslimanëve edhe në ditët pas vdekjes së Profetit, (a.s.), me kusht që ata të kapen fort, madje edhe shumë më fort pas tyre. Ky është një sihariq i Profetit, (a.s.). Por fjala që duhet të trajtojmë këtu është *temessuk* ose *i'tisam*, që do të thotë "të kapesh shumë fort." Kësaj mund t'i themi, që të kapesh me të dyja duart fort pas Kuranit dhe Sunetit. Ndërsa frazën "Suneti i të Dërguarit të Allahut" duhet ta kuptojmë si "shpalljet e Profetit, (a.s.), të detyruar nga shpallja e Revelatës."¹

Temat që nxisin për t'u kapur fort pas Kuranit dhe Sunetit (*i'tisam bi'l-kitap ue's-sunne*), të cilat i shohim në librat e haditheve, janë të mbushura me ajete dhe hadithe, që tregojnë për rëndësinë që paraqet Kurani dhe Suneti nga aspekti i arritjes së identitetit islam, të jetuarit sipas tij dhe mbrojtjes së tij. Hadithi që përmendëm më lart, paraqet haptazi objektivin e këtyre ajeteve dhe haditheve: *të mos devijosh... domethënë, "të mos humbësh identitetin tënd."*

"...Juve ju erdhi nga Allahu dritë dhe libër i qartë. Allahu e vë me të (me Kuranin) në rrugët e shpëtimit, atë që ndjek kënaqësinë e tij dhe, me ndihmën e Tij, i nxjerr ata prej errësirave në dritë dhe i udhëzon në një rrugë që është e drejtë." (Maide, 15-16)

“Dhe kapuni që të gjithë ju për litarin (fenë) e Allahut (dhe pasoni Kuranin) e mos u përçani!” (Ali Imran, 103)

“Dhe përmbajuni asaj më të mirës që ju është shpallur (Kuranit) nga Zoti juaj!” (Zumer, 55)

“Ky Kuran është një kumtesë (e mjaftueshme) për njerëzit.” (Ibrahim, 52)

“Thirrjen e të Dërguarit, mos e konsideroni si thirrjen tuaj ndaj njëri-tjetrit. (Duhet t'i përgjigjeni thirrjes së tij.)” (Nur, 63)

Imam Malikut i erdhi një burrë dhe i drejtoi një pyetje. Imami filloi t'i përgjigjej, duke i thënë: “I Dërguari i Allahut ka thënë: ...” Njeriu donte të mësonte mendimin e imamatit dhe e pyeti: “Cili është mendimi yt?” Pas kësaj, Imam Maliku lexoi ajetin sipas kuptimit: **“...prandaj, le të ruhen ata që kundërshtojnë rrugën e të Dërguarit të Allahut, se ata do t'i zërë ndonjë telash ose do t'i godasë dënimi i hidhur!”**⁴ Me këtë ai theksoi se vetëm fjala dhe mendimi i Profetit, (a.s.), është fjala që duhet të dëgjohet dhe mendimi që duhet të mësohet.

“Kush i bindet Pejgamberit, ai i është bindur Allahut...” (Nisa, 80)

“Kur Allahu dhe i Dërguari i Tij kanë vendosur për një çështje, nuk i takon (nuk i lejohet) asnjë besimtar i dhe asnjë besimtareje që në atë çështje të tyre personale të bëjnë ndonjë zgjedhje tjetër. E kush e kundërshton Allahun dhe të Dërguarin e Tij, ai është larguar shumë larg së vërtetës.” (Ahzab, 36)

“Ju kishit shembullin më të lartë (të mrekullueshëm) në të Dërguarin e Allahut...” (Ahzab, 21)

Kur vlerësohen këto ajete, bashkë me to edhe hadithet, të cilat na përcjellin me fjalë rëndësive dhe funksionin e Kuranit dhe Sunetit, për nga aspekti i identitetit dhe personalitetit islam, po të analizohen më hollësisht dhe më nga afër ata që thonë se janë myslimanë, do të dalë në pah se në ç'masë është lidhja dhe pasimi i tyre ndaj këtyre dy burimeve, domethënë, do të shfaqet cilësia dhe identiteti i tyre islam. Në këtë aspekt, ky hadith duhet të vlerësohet patjetër nga të gjithë: **“Askush nga ju nuk mund të**

bëhet besimtar (i përsosur), përderisa nuk ndjek të vërtetat që kam kumtuar unë.”⁵

Institucionet dhe bashkësitë që pretendojnë se edukojnë breza me identitet dhe personalitet islam, duhet të jenë të përgjegjshëm për të pasur shumë kujdes ndaj parimeve të Kuranit dhe Sunetit. Duhet të qëndrojnë absolutisht larg sjelljeve dhe frymëzimeve që kushtëzojnë myslimanët ndaj njëri-tjetrit dhe që kufizojnë islamin sipas botëkuptimeve personale.

Në ecurinë e kohës sonë shumë të ngatërruar dhe dëshpëruese, pasimi i bazave të islamit që kumtoi Profeti, (a.s.), nga emocionet dhe ambiciet që parapëlqejnë një jetë të lirë dhe gjithnjë të shthurur, është një detyrë shumë më e rëndësishme dhe më serioze se sa në të kaluarën. Sot, animi i zemrave të shtresës së rëndësishme të myslimanëve tek një botëkuptim dhe jetë të shkatërruar nga ndjenjat, propaganda dhe elementë jashtë islamit, është një realitet i hidhur që nuk mund të mohohet. Të lokalizosh vështrimin te emocionet dhe ambiciet e myslimanëve, të cilët duhet të ndjekin në çdo rast dhe në çdo konditë Kuranin dhe Sunetin, nga aspekti i identitetit dhe personalitetit islam, tregon se në shoqërinë njerëzore ekziston një patologji e madhe. Pothuajse të gjithë përkujdesen të bëhen myslimanë, sipas emocioneve dhe ambicieve vetjake. Individët kanë filluar t'i komentojnë çështjet duke thënë **“sipas meje...”**, ndërsa grupet e xhema-teve **“sipas nesh...”**, madje nuk janë të vëmendshëm se po neglizhojnë detyrën **“të jesh mysliman, sipas islamit”**. Mirëpo, ne nuk jemi urdhëruar të jemi myslimanë sipas emocioneve dhe ambicieve, por të jemi myslimanë sipas Kuranit dhe Sunetit.

“...e kush është më i humbur se ai që ndjek epshin e vet?...” (Kasas, 50)

“E kush iu frikësua paraqitjes para Zotit të vet dhe ndaloi veten prej epsheve, xheneti është vendi i tij.” (Naziat, 40-44)

Për t'u kapur fort pas Kuranit dhe Sunetit dhe për të pasuar me gjithë zemër ato që na solli Profeti, (a.s.), në fillim duhet t'i njohim dhe t'i mësojmë këto parime. Prandaj hadithi që përmendëm më lart, shpreh bindshëm me fjalë nxitjen për të mësuar Kuranin dhe Sunetin. Mësimi i Kuranit dhe i Sunetit varet nga shqyrtimi që ata u bëjnë këtyre të



dyjave. Ndërsa kjo mund të arrihet duke qëndruar mbi ajetet e hadithet dhe duke përsiatur rreth tyre, si dhe duke mësuar dhe vlerësuar komentimet dhe botëkuptimet e dijetarëve të kaluar. A ka ndonjë sjellje më të mirë dhe më të përshtatshme për myslimanin, se sa të meditojë mbi ajete dhe hadithe për t'i kuptuar, për t'i ndarë në kohë dhe për të marrë dije të nevojshme prej tyre?

Iniciativat e “*islamizimit të dijes*”, që vijnë kohët e fundit në rend të ditës, të sjellin ndër mend nevojën për të islamizuar mendjet dhe zemrat e myslimanëve, madje për të islamizuar edhe shkencat islame. Kjo na bën të mendojmë për nevojën e hulumtimit të të argumentuarit sipas *Kuranit* dhe *Sunetit*. Kapja fort pas *Kuranit* dhe *Sunetit* nuk duhet të bëhet me një pretendim të kotë. Ajo kërkon dije, përsiatje dhe një vullnet të fortë. Gjithashtu, kërkon që të dalësh përtej kushteve të rrethit shoqëror. Që të gjitha këto mund të arrihen duke mbështetur personalitetin tonë islam te burimet bazë, në mënyrë të ndërgjegjshme dhe duke u përpjekur gjithnjë për këtë.

Myslimani me cilësinë dhe detyrën kryesore “*të qenët rob i Allahut*”, i cili është në një pozitë të ndryshme dhe dallon (*është i privilegjuar*) nga njerëzit e tjerë, nuk ka të drejtë të largohet pa asnjë pretekst nga *Libri* (Kurani) dhe *Suneti*. Sepse vazhdimësia e tij në rrugë të drejtë dhe lumturia e tij në të dy botët, varet nga të kapurit e tij fort pas këtyre dy parimeve dhe trashëgimeve të Profetit, (a.s.). Ky realitet mbështetet në deklarinimin e sipërpërmendur të Profetit të fundit Muhamed Mustafa, (a.s.).

Përveç kësaj, duhet të theksojmë se individët dhe grupet shoqërore, të cilët kanë rënë në një agjitacion (*trazirë*) identiteti e personaliteti dhe duket se janë larguar nga epiteti i tyre islam, rezultojnë se nuk janë kapur siç duhet pas *Kuranit* dhe *Sunetit*.

Nuk duhet të harrojmë se feja mund të mbrohet duke e jetuar atë vetë, duke ndërtuar dhe mbajtur gjallë institucionet e saj, duke studiuar e duke u

arsimuar në të. Nëse këto tri obligime realizohen në kuadër të *Kuranit* dhe *Sunetit*, atëherë do të ruhej identiteti dhe personaliteti islam dhe do të ishte shembull edhe për brezat e ardhshëm. Përndryshe, sido që të jetë pretendimi, natyrisht që përballja me pasoja negative do të jetë e paevitueshme, për shkak të mosmarrjes për bazë të *Kuranit* dhe *Sunetit* dhe të mos të jetuarit në përputhje me to.

Institucionet dhe bashkësitë që pretendojnë se edukojnë breza me identitet dhe personalitet islam, duhet të jenë të përgjegjshëm për të pasur shumë kujdes ndaj parimeve të *Kuranit* dhe *Sunetit*. Absolutisht duhet të qëndrojnë larg sjelljeve dhe frymëzimeve (*sugjerimeve* dhe *indoktrinimeve*) që kushtëzojnë myslimanët ndaj njëri-tjetrit dhe që kufizojnë islamit sipas botëkuptimeve personale. Ne jemi të urdhëruar të ndjekim rrugën e drejtë që na orienton *Kurani* dhe *Suneti*, jo duke përshtatur islamit sipas vetes sonë, por duke iu përshtatur atij.

Asnjë ide (*mendim*) dhe doktrinë që parashtrahet dhe që do të parashtrahet si alternativë ndaj islamit ose ndaj *Kuranit* dhe *Sunetit*, nuk mund të mendohet si element përbërës i identitetit të myslimanëve, të cilët janë të obliguar të kapen fort pas këtyre dy parimeve. Në rast të kundërt, është i pashmangshëm erozioni dhe humbja e identitetit dhe e personalitetit.⁶

Referencat:

1. Muvatta, Kader 3; Hakim, *Mustedrek*, 1, 93; Ibn Abdilberr, *el - Xhami*, II, 134, 221; përveç kësaj shiko: Ebu Davud, *Menasik* 56; Ibn Maxhe, *Menasik* 84; Ahmet b. Hanbel, *Musned*, III, 26. 2. Shiko: *Sherhu'l-Muvatta*, V, 236. 3. Aliju'l-Kari, *Mirkatu'l-mefatih*, 1, 210; Baxhi, *Munteka*, VII, 203. 4. Për ngjarjen që përmendet në suretu Nur: 24/63 shiko: Begavi, *Sherhu's-sunne*, 1, 191. 5. Shiko: Tebrizi, *Mishkatu'l-Mesabih*, 1, 66. 6. Për të shqyrtuar më hollësisht çështjen e identitetit, shiko Çakan, *Identiteti i Myslimanit*, Stamboll, 2002.

Adl; i drejtë, i mëshirshëm, që e bën çdo gjë ashtu si duhet.

PLAKU I URTË

Një sundimtar së bashku me shoqëruesit e vet, doli për shëtitje. Gjatë rrugës kaloi nga një fshat ku shikoi një plak, i cili po punonte me shumë zellë kopshtin e vet. E thirri burrin nga larg:

- Baba, përse po mbjell fidanë? Qenke thinjur e të paska ecur goxha mosha, ndoshta nuk do të arrish që të shijosh frytet e këtyre fidanëve.

- Biri im, nuk është e thënë që të korr frytet e asaj që mbjell. Ashtu si kemi ngrënë frutat e të parëve tanë, ashtu do të hanë edhe të rinjtë frutat e punëve tona.

Sundimtarit i pëlqeu shumë kjo përgjigje dhe dha urdhër që t'i jepnin plakut një qese me florinj. Plaku duke komentuar tha:

- E shikove, biri im? Fidanët e mi i dhanë menjëherë frytet.

Edhe kjo përgjigje u pëlqye nga sundimtari, i cili urdhëroi sërish që t'i jepet plakut të urtë edhe një qese tjetër me florinj. Plaku i mençur në vazhdim tha:

- Biri im, fidanët e njerëzve të tjerë japin fryte vetëm një herë në vit ndërsa këta tanët dhanë dy herë në vit.

Edhe kjo përgjigje i pëlqeu shumë sundimtarit dhe urdhëroi që t'i jepet një qese e tretë. Por këtë herë ndërhyri veziri i cili i tha:

- Të lutem o mbreti im, hajde të largohemi prej këtu se kështu si po vete puna, plakut po mbjellë fidanë në arë dhe po korrë thesarin e shtetit!



NJË LUTJE

*"O Allahu im!
Më ushqe dashurinë Tënde,
dashurinë ndaj atyre që të
duan Ty dhe ndaj punëve që
më afrojnë tek Ti."*

(Tirmidhiu, "Dua", 73)

NJË PERLË

*"Besimtari është si dielli.
Perëndon duke u zverdhur
e duke u zbehur por kur lind
(në ahiret) t'i merr sytë me
shkëlqimin e tij."*

Ebubekik Shibli

NJERIU NË HAPËSIRË

✦ *Muaz Erdem* ✦

Kalendarët shënonin vitin 1961. Kishin kaluar pothuajse 4 vite që prej kohës kur Bashkimi Sovjetik dërgoi në hapësirë satelitin e parë artificial Sputnik-1 (83,5 kg). Bashkimi Sovjetik pavarësisht epërsisë që kishte fituar në garën me SHBA-në vazhdonte të prodhonte projekte të reja. Projekti i ri do të hapte një fletë të re në historinë e njerëzimit. Këtë herë në hapësirë do të dërgohej “njeriu i parë”!

Pas qenit të parë të dërguar në hapësirë në datën 3 nëntor 1957, i kishte ardhur radha njeriut. Përgatitjet për dërgimin e njeriut të parë në hapësirë pothuajse kishin përfunduar. Por akoma nuk dihej se kush ishte njeriu që do e kryente këtë udhëtim mbresëlënës. Emri i tij qëndroi sekret deri një ditë përpara nisjes. Me datën 11 prill u tha se njeriu që do të shkonte në hapësirë ishte Juri Gagarin. Ai kishte lindur në Moskë, në vitin 1934. Përfundoi gjimnazin dhe u bë punëtor metal. Babai i tij ishte marangoz. Juri që në periudhën e shkollës ndjente kureshtje për avionët prandaj u regjistrua në Forcat Ajrore Sovjetike dhe u bë kozmonaut vullnetar. Në një farë mënyrë ai mori edhe edukim psikologjik.

Ishte data 12 prill 1961! Akrepat e orës tregonin: 09:07! Vostok-1 u nis drejt qiellit! Udhëtimi i Juri Gagarinit zgjati 108 minuta. Prej këtyre, 89 minuta dhe 34 sekonda i kaloi në orbitën e Tokës. Shpejtësia maksimale arriti në 28.269 km për orë. Lartësia maksimale u regjistrua si 327 km.

Kthimi i Vostokut në Tokë ishte mjaft i vështirë. Në lartësinë prej 7 km Gagarin u shkëput nga anija kozmike dhe bëri një zbritje të lehtë me ndihmën e parashutës. Juri Gagarin u bë njeriu i parë që udhëtoi në hapësirë dhe e shikoi Tokën nga lart! Ai u bë lajmi kryesor në gazetatat e gjithë botës. Ndërkohë ai u nderua me medaljen heroike të Bashkimit Sovjetik.

Më 7 Mars të vitit 1968 (pra 7 vite pas udhëtimit të tij në hapësirë) teksa po merrte pjesë në udhëtimin provë të një avioni i cili u rrëzua

në Tokë, Juri humbi jetën.

Një prej fjalive historike të tij gjatë udhëtimit hapësiror ishte: “Teksa po udhëtoja me anije kozmike rreth Tokës, shikova bukurinë e vërtetë të saj! Miqtë e mi, në vend që ta shkatërrojmë planetin tonë të bukur, le ta ruajmë dhe t’ia shtojmë bukurinë!”

Në këtë mënyrë u realizua udhëtimi i parë i njeriut në hapësirë. Në kujtim të 50-të vjetorit të daljes sonë në Hapësirë, në Youtube u transmetua një dokumentar prej 1 ore e 38 minutash.

“O xhinde dhe njerëz, nëse keni fuqi të përshkoni kufijtë e qiejve dhe të Tokës, atëherë përshkujini ato! Por nuk do të mund ta bëni këtë, përveçse me një fuqi të madhe (nga Allahu)!” (Rahman, 33)

VENDLINDJA E YJEVE: MJEGULLNAJA

Kur mendojmë për hapësirën na vjen në mendje pamja e mjegullnajave sepse ato janë të përbëra prej ngjyrash dhe formash që përkëdhelin syrin e njeriut. Por çfarë janë mjegullnajat dhe si formohen ato? Le të flasim pak më gjatë për këtë temë.

Ylli që e ka përmbushur jetëgjatësinë e vet, bën përpjekjet e veta të fundit dhe fillon që të rritet e të zmadhohet. Në këtë stad shtypja që ndodh tek ai bën të mundur përhapjen e gazeve në hapësirë. Në këtë mënyrë formohet një mjegullnajë.

Më pas këto gazra bashkohen dhe lind një yll i ri. Sigurisht që një proces i tillë kërkon kohën e vet, një



kohë që për ne është shumë e ngadaltë. Shembulli më i afërt është ai i mjegullnajës së Orionit. Në përfundim të vëzhgimeve mund të shikohen lehtësisht yjet e rinj.

Në një ambient shumë të errët, Mjegullnaja e Orionit mund të shikohet edhe me sy të lirë.

Marrja si referencë e kostelacionit të Orionit do ta bëjë më të lehtë gjetjen e mjegullnajës së Orionit. Këtë kostelacion ju mund ta shikoni menjëherë pas perëndimit të Diellit në pjesën lindore të horizontit. Vëzhgim të mbarë...



"O besimtarë! Kërkoni ndihmë për veten nëpërmjet durimit dhe namazit! Në të vërtetë, Allahu është me të duruarit!"

(Bekare, 153)

Një Ajet

Kurani e konsideron jetën si një shkollë, kurse njeriu si nxënësin e saj. Përmes kësaj shkolle njeriu aftësohet e zhvillohet, duke arritur pjekurinë e duhur për të përbushur qëllimin, për të cilin është krijuar. Allahu na urdhëron të largohemi nga kjo shkollë, të pastruar nga veset e këqija dhe të zbukuruar me virtyte.

Në shumë vende të Kuranit flitet për durimin dhe shpërblimin e madh që ai i sjell njerut, duke nxitur që durimi të bëhet veti e pandashme e çdo besimtar. Sepse përgjegjësia me të cilën është ngarkuar njeriu në këtë botë, është e madhe. Nga njëra anë, besimtarit i duhet të përballet me pengesat që i dalin përpara, gjatë rrugës së komunikimit dhe përcimit të mesazhit islam, nga ana tjetër, i duhet të luftojë me botën e tij të brendshme kundër egoizmit, i cili është në natyrën e njeriut dhe ngacmimeve të shejtanit. Për këtë arsye, njeriu duhet të pajiset me vetinë e durimit, për të ngadhënyer mbi vështirësitë.

Durimi është aftësia për të duruar e për të përballur vështirësi, shqetësime vuajtje e fatkeqësi në rrugë të drejtë, pa u ankuar e pa u ligështuar. Ashtu si nuk ka lidhje me kokëfortësinë, durimi nuk ka lidhje as me mungesën e reagimit ndaj së keqes. Besimtarit i duhet të jetë krenar dhe i nderuar dhe jo t'u nënshtrohet padrejtësive. Së pari, durimi është cilësi dalluese e Pejgamberëve të Zotit dhe ndjekësve të tyre besnikë. Një sërë cilësish morale fitohen nëpërmjet durimit. Të jetuarit si mysliman është e lidhur ngushtë me durimin. Kur Pejgamberi (a.s.) u pyet se çfarë është imani, tha: "Të jesh durimtar dhe tolerant." Durimi është faktor dominues në sigurimin e ndihmës së Allahut dhe për pasojë, suksesit. "Sa herë, me ndihmën e Allahut, një ushtri e vogël ka ngadhënyer mbi një ushtri të madhe! Allahu është me të durueshmit". Pra, ndihma e Allahut është pranë durimtarëve. Durimi është një veti që i sjell besimtarit përfitime materiale dhe shpirtërore. Durimi

është formula për sukses në këtë botë dhe lumturi të përjetshme në botën tjetër. Pa durim nuk mund të arrihet, as morali i lartë dhe as ibadetet nuk mund të kryhen siç duhet. Pa durim, njeriu nuk mund të ketë sukses, as në studime, as në jetën profesionale. Besimtari duhet të jetë i durueshëm me familjen, të afërmit, fqinjët, me shokët në çdo kohë dhe mjedis, duke i përballuar me qetësi shqetësimet që mund të vijnë prej tyre.

Një nga mënyrat më të mira për t'i kërkuar ndihmë Allahut, është namazi. Rukuja dhe sexhdja, në një mënyrë është lutje për ndihmë. Durimi dhe namazi janë përmendur puqur për rolin që kanë në arritjen e ndihmës së Allahut. Durimi dhe qëndresa përballë vështirësive të kësaj bote kanë nevojë për mbështetje shpirtërore. Nëpërmjet lidhjes së ngushtë që krijon ndërmjet besimtarit dhe krijuesit, namazi e bën besimtarin të qëndrueshëm përballë vështirësive. Gjatë rrugës së jetës, namazi është ushqimi më i rëndësishëm për besimtarin, sepse e mban njeriun larg nga vesveset e shejtanit dhe kështu, ai vazhdon rrugën e tij pa u ligështuar.

Durimi merr vlerë vetëm në një moment të caktuar dhe ai është momenti i parë i përballjes me vështirësitë. Një karakteristikë e jetës së njeriut është ndryshueshmëria. Për një moment jeton i gëzuar, i lumtur, pastaj papritur mund të përballet me një fatkeqësi ose anasjelltas.

Jeta nuk është gjithmonë bardhezi; ajo është e mbushur me të gjithë spektrin e ngjyrave.

Jeta e njeriut nuk është gjithmonë e lumtur apo e trishtueshme; shpesh këto gjendje zëvendësojnë njëra-tjetrën. Jeta e njeriut rrjedh ndërmjet këtyre dy gjendjeve. Për rrjedhojë, duhet të jemi të përgatitur për çdo të papritur që mund të na ofrojë jeta, me uljet dhe me ngritjet e saj.

Resulullahi (sal-lallahu alejhi ve slem) ka thënë:

“Prej shenjave të besimtarit të mirë është braktisja e të padobishmes.”

(Buhari)

Çdo gjë në këtë botë, Allahu e ka krijuar për dobi të njerëzve. Për rrjedhojë, asgjë në këtë botë nuk është e padobishme, por jo gjithmonë, çdo gjë është në dobi të çdo njeriu. Në hadithin e mësipërm, çdo gjë që nuk sjell përfitim për këtë botë apo botën tjetër, konsiderohet e padobishme.

Pejgamberi (a.s.), përmes hadithit, nxit besimtarët të përsosin besimin e tyre, duke braktisur çdo gjë që nuk është në interes dhe dobi të tyre. Tregues të besimtarit të mirë janë virtyte të tilla, si drejtësia, besnikëria, ndershmëria. Kurse tregues i besimtarit të dobët është gënjeshtria, tradhëtia, pabesia. Ky hadith i drejtohet gjithë bashkësisë islame, për ta pajisur me virtyte, që zbukurojnë besimin dhe i afron njerëzit të Krijuesit. Eliminimi i një sërë dukurive negative në shoqëri, bëhet i mundur me braktisjen e gjërave të padobishme. Preokupimi i njeriut me gjëra të dobishme, është në interes të tij, sepse, nëse ai nuk e bën këtë, do të bjerë në kurthet e mëkateve. Kush preokupohet me njerëzit, harron veten e tij dhe merret me thashetheme.

Një tjetër kuptim i rëndësishëm

që nxjerrim nga hadithi, është edhe rëndësia e kohës, sepse njeriu që merret me gjëra të padobishme, ka harxhuar kohën, mirësinë më të madhe që i është dhuruar njeriut.

Kriter për të përcaktuar saktë çfarë është e dobishme dhe çfarë jo, është feja dhe jo opinioni i njerëzve, sepse sot në mesin e myslimanëve po vihat re indiferentizëm i theksuar ndaj shumë dukurive negative, që janë urdhëruar të pengohen me shariat, me pretekstin se nuk u interesojnë. Ky nuk është largim nga e padobishmja, por shmangie nga përgjegjësitë, siç është këshillimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja.

MËSIMET QË NXJERRIM NGA HADITHI:

1. Mospreokupimi me punë të padobishme është shenjë e besimit të përsosur
2. Njeriu duhet të angazhohet me punë që sjellin përfitime në këtë botë dhe në botën tjetër
3. Braktisja e të padobishmes vjen si pasojë e ndërgjegjësimit të personit se në çdo moment është në mbi-këqyrjen e Allahut.





EDUKATA DHE MIRËSJELLJA



Edukata është një element që e dallon njeriun nga krijesat e tjera. Njeriu fiton vlerë tek Allahu me edukatën, mirësjelljen, delikatesën dhe devotshmërinë e tij. Për këtë arsye, ndër cilësitë e të dashurve të Allahut, edukata dhe mirësjellja gëzojnë një vend të veçantë. Prandaj dhe mistikët e mëdhenj e kanë përkufizuar tasavufin si “moral të bukur dhe edukatë”.

Shah Nakshibendiu (Allahu e mëshiroftë!), i cili u formua me edukatë dhe mirësjellje të veçantë nën kujdesin shpirtëror të të nderuarit Emir Kulal, në vitet e para të mësimeve, për të thyer krenarinë dhe mendjemadhësinë e nefsit (egos) të tij dhe për të arritur gjendjen e “hiç”-it përpara Allahut, u ngarkua me detyrën e shërbimit ndaj njerëzve të sëmurë, kafshëve të plagosura dhe me pastrimin e rrugëve. Për gjendjen e tij në atë kohë, ai tregon:

“Shërbeva për një kohë të gjatë në rrugën që më

urdhëroi mësuesi im. Egoja ime u bë e atillë, sa që duke ecur, ndaloja në vend përpara çdo krijese të Allahut dhe vazhdoja rrugën vetëm pasi kishte kaluar ajo. Shërbimi im vazhdoi shtatë vjet rresht. Si rezultat i kësaj, fillova të dëgjoja edhe zërat e trishtuar të krijesave që luteshin dhe kërkonin strehim tek Allahu”.

Ja pra, për shpirtat e ndriçuar me urtësi, çdo gjë në univers shfaq dhe tregon fuqinë dhe madhësinë hyjnore. Për të arritur këtë gjendje, është kusht që shpirti të fitojë butësi dhe delikatesë me anë të edukimit shpirtëror dhe të marrë mësim prej shfaqjeve hyjnore, duke u thelluar në urtësi. Kjo, sepse shumë të fshehta nuk mund të konceptohen me mendje, por vetëm me urtësi. Të fshehtat shpirtërore nuk bëhen të qarta pa u thelluar në urtësi.

Edukata është kapitali më i çmuar i një udhëtari që ndodhet në rrugë të Allahut. Njeriu nuk mund



të jetë edhe fetar, edhe i paedukuar, sepse thelbi i shpirtit islam në besim, është teuhidi, ndërsa në vepra është edukata dhe mëshira. Prandaj mund të thuhet se feja islame me të gjitha parimet e veta, fund e krye përbëhet nga mirësjellja, delikatesa dhe pastërtia. Pra, nga “edukata e bukur”. I nderuari Mevlana Xhelaledin Rumi thotë:

“Hapi sytë dhe shihi fjalët e Allahut! I gjithë Kurani, ajet për ajet, është mësim edukate!”

Të dashurit e Allahut i kanë arritur gradat vetëm me edukatën e tyre të lartë. Imam Rabbani thotë:

“Ai që nuk respekton edukatën, nuk mund të përparojë në rrugë të Allahut, pra nuk mund të bëhet mik i Tij. Rruga e të mëdhenjve të fesë, është e gjitha edukatë”.

Edukata më e rëndësishme, është ajo ndaj Allahut Teala, i Cili na ka krijuar.

Nuk duhet të harrojmë se shejtani i mallkuar, nuk u dëbua prej mëshirës së Allahut, për shkak të mungesës së diturisë apo punës, por për shkak të mungesës së edukatës. Pra, shejtani e shkatërrroi virtyti më i mirë, edukata. Mevlana shprehet:

“Kur iblisi kundërshtoi urdhrin e Allahut, duke mos i bërë sexhde Adem (a.s.), tha:

- Unë jam prej zjarrit, ndërsa ai prej baltës. A i shkon atij që është më lart, t’i bëjë sexhde atij që është më poshtë?”

Ja pra, iblisi u dëbua nga mëshira e Allahut dhe u mallkua, për shkak se iu përgjigj Allahut në një mënyrë të paedukatë. Mbi të gjitha, debatoi me Krijuesin e tij me arrogancë. (Fih ma fih, faq. 159)

Ebu Ali Dekkak (Allahu e mëshiroftë!), thotë:

“Braktisja e edukatës, meriton dëbimin prej mëshirës së Allahut. Kush tregonet i paedukatë para sulltanit, nxirret tek dera e, kush tregonet i paedukatë tek dera, nxirret në ahur”.

Të moçmit thoshnin: “Edukatën mësoje prej të paedukuarit”. Kjo është një këshillë, që ne të marrim mësim prej përfundimit të atyre që nuk e respektojnë edukatën. Prandaj edhe ne duhet të marrim mësimin e duhur prej gjendjes në të cilën ra shejtani.

Robi, i cili tregon edukatën e duhur ndaj Allahut Teala, ruhet nga sjelljet e pakontrolluara dhe si rezultat, arrin të vërë re mangësitë dhe gabimet që mund të bëjë në adhurimet dhe veprat e tij. Gjithashtu, atë nuk e kap sëmundja e besimit të tepërt në punët e veta.

Të mos harrojmë se, sado të shumta të jenë punët tona të mira, ato janë vetëm sa një kovë ujë e hedhur në oqean. Prandaj, adhurimet dhe punët tona duhet t’i shohim të pakta përpara mirësive që na ka falur Allahu i Madhëruar. Devotshmërinë tonë nuk duhet ta matim me nivelin më të ulët të shoqërisë, por me nivelin e sahabëve dhe të dashurve të Allahut, sepse Allahu i Madhëruar i ka bërë Ensarët dhe Muhaxhirët shembull për ne.

Ata që e jetojnë edukatën e devotshmërisë

në mënyrën e duhur, janë të vetëdijshëm se të gjitha mirësitë janë prej Allahut, ndërsa të gjitha mangësitë burojnë prej vetes së tyre.

Thënia e dikujt që braktis adhurimet dhe futet në rrugë të keqe “Ç’të bëj, kështu qenka thënë!”, është shprehje injorance e nxitur nga shejtani. Ai që dëshiron të falë namaz, Allahu Teala ia bën të mundur të gjitha shkaqet që ai të falet. E nëse nuk dëshiron të falet, pasi t’i jetë bërë e ditur e vërteta, Allahu nuk e pengon atë në zgjedhjen e tij të lirë.

Të shfaqësojmë veten tonë për gjynahet që bëjmë, është “shpifje ndaj kaderit (caktimit)”, që tregon mendjelehtësi dhe mungesë edukate ndaj

“Kapu pas edukatës haptas apo fshehtas qofsh, sepse, nëse dikush tregon mungesë edukate kur është i hapur, merr një dënim të hapur. Por, nëse tregon mungesë edukate kur është në fshehtësi, merr një dënim të fshehtë. Kush humbet edukatën, është larg Allahut, edhe nëse ai kujton se është afër. Gjithashtu, edhe në kujton se është i pranuar, ai është i refuzuar.”



Allahut Teala. Kjo është pika ku i rrëshqiti këmba edhe shejtanit, i cili tregoi mungesë edukate ndaj Allahut. Prandaj dhe ajo që e çmend më së tepërmi shejtanin, është pika në të cilën gaboi vetë. Bindja, pranimi dhe dorëzimi që tregon besimtari ndaj Allahut, është **“edukata e besimit”**.

Një nga qëllimet kryesore të tasavufit, është ta ndërgjegjësojë njeriun për “ndjenjën e mirësisë”. Ta ndërgjegjësojë atë se është gjithmonë në prezencën e Allahut dhe ta bëjë të veprojë me edukatë ndaj Allahut edhe në shoqëri edhe në vetmi. Mistikët e mëdhenj kanë thënë:

“Kapu pas edukatës haptas apo fshehtas qofsh, sepse, nëse dikush tregon mungesë edukate kur është i hapur, merr një dënim të hapur. Por, nëse tregon mungesë edukate kur është në fshehtësi, merr një dënim të fshehtë. Kush humbet edukatën, është larg Allahut, edhe nëse ai kujton se është afër. Gjithashtu, edhe në kujton se është i pranuar, ai është i refuzuar.” (Ruhu'lBejan, X, 401.)

Prandaj, në vend që të debatojmë si shejtani për gjërat që Zoti ynë ka dëshiruar për ne, të ulim kokën menjëherë, të pranojmë, të dorëzohemi dhe të jemi të bindur se ajo është gjëja më e mirë për ne. Kjo është më e rëndësishmja e edukatës së fshehtë.

Një ditë, një prej dijetarëve të hadithit, u kënaq shumë kur pa djaloshin e ri Bejazid Bistamin dhe për t'i matur botëkuptimin dhe zgjuarsinë e pyeti:

-Djalë i mbarë! A di ta falësh namazin?

Bejazid Bistami tha:

-Po, mundem me lejen e Allahut.

-Si?- e pyeti ai.

Bejazid Bistami vazhdoi:

-Them: Urdhëro o Allah. Po qëndroj para teje për të zbatuar urdhrin tënd dhe bëj tekbir. Lexoj Kuranin në mënyrë të qartë dhe ulem me madhështi në ruku. Ulem me modesti në sexhde dhe përshëndes duke dhënë selam.

Dijetari i mahnitur e pyeti:

-O djalë i zgjuar! Me gjithë këtë botëkuptim të thellë që ke, përse i lejon njerëzit të të përkëdhelin kokën? (Dijetari mendonte se lëvdatat dhe

komplimentet do ta çonin në mburrje dhe se ai nuk duhej t'i lejonte këto gjëra.)

Bejazid Bistami iu përgjigj me një urtësi të madhe:

-Ata nuk më përkëdhelin mua, por bukurinë me të cilën më ka zbukuruar Allahu Teala. Si mund t'i pengoj të prekin diçka që nuk më përket?

Ja pra, një pjesë tjetër prej edukatës së devotshmërisë, është të qenët i ndërgjegjshëm se të gjitha bukuritë janë prej Allahut dhe të mos ia atribuosh vetes.

Edukata më e madhe është madhështia që tregohet ndaj Allahut Teala. Shfaqja më e bukur e kësaj tregohet gjatë adhurimeve. Të dashurit e Allahut kanë thënë:

“Adhurimet e çojnë njeriun në xhenet. Ndërsa edukata dhe madhështia që tregohet gjatë adhurimeve, e çojnë atë tek Allahu dhe e bëjnë mik me Të.”

Enes bin Malik (r.a.), ka thënë:

“Edukata në vepra, është tregues se ajo vepër është pranuar”.

Hidri (a.s.), ka këshilluar që të bëjmë këtë dua:

“O Allah! Më fal edukatë të bukur, që të jem i devotshëm ndaj Teje”

Të dashurit e Allahut, përveç se zotëronin këtë edukatë të fshehtë, ata gjithmonë kanë jetuar me vetëdijen se ndodhen në prezencën e Allahut.

Prandaj, ata i kanë dhënë shumë rëndësi edukatës në shoqëri. Kjo mund të shprehet duke ruajtur të njëjtën gjendje nënshtrimi dhe edukate që tregohet gjatë adhurimeve dhe jashtë tyre. Allahu i Madhëruar ka urdhëruar:

“...e që janë të vazhdueshëm në faljet e tyre” (Me'arixh, 23)

“...e që i falin namazet rregullisht.” (Me'arixh, 34)

Mevlana i nderuar, duke komentuar këto ajete, thotë:

“Robi e ruan gjendjen e namazit edhe pas tij. Kështu që, e gjithë jeta e tij kalon me nënshtrim dhe edukatë. Gjithashtu, gjuha dhe zemra e tij janë të ruajtura. Kjo është gjendja e të dashuruarve të vërtetë, pra e miqve të Allahut...”

Qëllimi i edukimit shpirtëror është që ta bëjë



njeriun të vetëdijshëm se ndodhet gjithmonë nën vëzhgimin e kamerave hyjnore. Në sajë të kësaj vetëdijeje, do të mundësohet që virtytet e larta të njeriut, si mirësjellja, delikatessa, edukata dhe turpi, të bëhen themel i natyrës njerëzore.

I nderuari Davud-i Tai tregon:

“Kam qëndruar njëzet vjet me Ebu Hanifen. Gjatë gjithë kësaj kohe kam vënë re se ai edhe kur ishte vetëm, edhe kur ishte në prezencë të dikujt tjetër, nuk ka qëndruar kurrë me kokë të zbuluar dhe asnjëherë nuk i ka zgjatur këmbët, qoftë edhe për t’i çlodhur. Njëherë e pyeta:

- Ç’të keqe ka nëse i zgjat këmbët, kur je i vetmuar?

Ai më tha:

- Të tregosh edukatë përpara Allahut të Madhëruar është më e virtytshme.

Edhe i nderuari Mahmud Sami Ramazanoglu nuk është parë kurrë të jetë ulur duke zgjatur këmbët ose të ketë ngrënë, duke qenë i mbështetur diku. Sami Efendi (Allahu e mëshiroftë!), në bisedat e tij shpesh përsëriste këtë bejte:

EDUKATA ËSHTË NJË KURORË PREJ DRITËS HYJNORE

Vendose atë kurorë dhe sigurohu nga çdo bela...

Edhe i nderuari Hysejn Efendi prej Samsunit, kaloi një jetë plot edukatë dhe mirësjellje. Vëllai ynë Mustafa Okutan, i cili përgatiti xhenazen e Hysejn Efendiut, tregon një ndodhi që e ka jetuar vetë:

“Kur isha duke larë trupin e Hysejn Efendisë, këmba e djathë i ishte mbështetur në kraharor dhe nuk mundëm t’ia hapnim. Por kur e vendosëm në varr, papritur u kthye në të djathtë”.

Padyshim që kjo ishte një ndodhi që na kujton faktin se “Njeriu do të vdesë ashtu siç ka jetuar dhe do të ringjallet ashtu siç ka vdekur”. (Munavi, Fejzu’lKadir, V,663.) Allahu i Madhëruar, i shfaq disa të fshehta, në mënyrë të atillë që prej tyre të merret mësim.

Edhe ata që ndodhen në prezencën e një të dashuri të Allahut, nuk sillen të shkujdesur siç sillen kur janë në ndonjë vend apo kohë tjetër. Miqtë e Allahut janë të vetëdijshëm se ndodhen gjithmonë në prezencën e Allahut dhe zotërojnë

shpirtra të ndriçuar edhe pa pasur nevojë për prova. Pra, ata jetojnë gjithmonë me vetëdijen se ndodhen çdo çast me Allahun: “...**Ai është me ju kudo që të gjendeni...**” (Hadid, 4.) Për këtë arsye, edukata e tyre u jep formë të gjitha sjelljeve të tyre.

Kjo është edhe arsyeja që të dashurit e Allahut janë gjithmonë të edukuar, madje edhe kur ndodhen larg syve të njerëzve. Mbulimi i kokës në namaz shpreh respekt për Allahun. Por të dashurit e Allahut, që jetojnë çdo çast në atmosferën e adhurimit, e respektojnë këtë element edhe jashtë namazit.

Kur një prej sahabëve e pyeti Profetin e Allahut (a.s.), se a mund të sillesh lirisht në lidhje me veshjen, kur ishte larg syve të njerëzve, i Dërguari i Allahut iu përgjigj:

“Allahu e meriton më shumë se njerëzit që të kihet turp prej Tij.” (Ebu Daud, Hammam, 2/4017.)

Edhe të parët tanë, shpirtrat e të cilëve u brumosën me edukatën islame, kanë shfaqur një nivel të lartë edukate, me të cilën kanë mahnitur gjithë botën. Prifti protestant Salomon Schweigger, i cili ishte një fanatik i madh, në sejahatnamen (ditarin e udhëtimit) e tij, kur flet për myslimanët, tregon:

“Myslimanët mbulohen edhe kur hyjnë në hamam. Sa njerëz të edukuar! Edukatën dhe namusin duhet ta mësojmë prej këtyre njerëzve, të cilët i quajmë barbarë.” (I. Ortayli, *Osmanliyi Yeniden Kesfetmek*, s. 88.)

Mbulesa është diçka që mund të diskutohet vetëm për njeriun. Për krijesat e tjera as që mund të zihet në gojë. Mbulesa është një edukatë e lindur e devotshmërisë. Ademi (a.s.) dhe gruaja e tij Havaja, u turpëruan nga lakuriqësia e tyre, edhe pse në xhenet nuk kishte njerëz të tjerë. Kjo do të thotë se mbulesa dhe motivuesit shpirtërorë të saj, edukata dhe turpi, janë prej cilësive rrënjësore që gjenden në natyrën e njeriut.

Edukata që duhet të tregohet në prezencë të Allahut, duhet të tregohet edhe ndaj të gjitha krijesave të tjera, sipas radhës së afërsisë me Të. Pra, pas edukatës që tregohet ndaj Allahut, në radhë të dytë vjen edukata ndaj të Dërguarit të Tij (a.s.).

*“Adhurimet
e çojnë njeriun
në xhenet. Ndërsa
edukata dhe madhështia
që tregohet gjatë adhurimeve,
e çojnë atë tek Allahu dhe e
bëjnë mik me Të.”*



EDUKATA NDAJ TË DËRGUARIT TË ALLAHUT (A.S.)

Sahabët e nderuar kanë shfaqur ndjenjën më të lartë të edukatës dhe respektit që duhet treguar ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.). Këtë gjë ata e kanë shprehur në mënyrën më të bukur, duke thënë:

“Sikur mbi kokat tona kishte ndonjë zog dhe, nëse lëviznim, do të ikte”. (Shih: EbuDaud, Sunnet, 23-24/4753; Ibn-i Maxhe, Xhenaiz, 37.)

Edukata që tregonin sahabët ndaj Profetit (a.s.), ishte e tillë, saqë (në të shumtën e rasteve) e quanin guxim t’i bëje pyetje (Profetit). Edhe pse ndonjëherë tek Profeti vinte ndonjë bedevi (endacak shkretëtire) dhe bëhej shkak për bisedë, sahabët prisnin gjithmonë me padurim që të përfitonin nga bisedat e Profetit (a.s.).

Edhe ata që gjendeshin vazhdimisht bashkë me Profetin (a.s.), prej edukatës dhe respektit që kishin për të, shumë rrallë e kanë parë fytyrën e tij lirshëm dhe për një kohë të gjatë. Madje, gjatë bisedave që zhvillonin me Profetin (a.s.), përveç Ebu Bekrit dhe Omerit (radijallahu anhuma), të cilët mund të shkëmbenin shikime me Profetin (a.s.), të gjithë sahabët e tjerë shikonin përballë vetes. (Tirmidhi, Menakib, 16/3668.). Këtë fakt e ka treguar më vonë në fundin e jetës së tij Amr bin As (r.a.), i cili ka kaluar në histori si çlirimtari i Egjiptit:

“Kam qëndruar një kohë të gjatë me Profetin. Mirëpo, për shkak të respektit dhe turpit që kisha ndaj tij, s’kam mundur ta ngre kokën dhe ta shoh fytyrën e tij të ndritur, aq sa të ngopem. Nëse sot do të më kërkonin ta përshkruaja atë, më besoni se nuk do të mundesha.” (Muslim, Iman, 192.)

Edhe ne kërkojmë falje e strehohemi në oqeanin e mëshirës së Allahut ndaj mangësive që mund të tregojmë padashur gjatë përshkrimit të Profetit tonë të dashur (a.s.), me fjalët tona të kufizuara dhe të pamjaftueshme.

Gjithashtu edhe thënia e salavateve, kur përmendet emri i të Dërguarit të Allahut, Muhamedit (a.s.), është prej edukatës së bukur. Në një ajet fisnik, Allahu i Madhëruar urdhëron:

“Vërtet, Allahu e bekon të Dërguarin dhe engjëjt e Tij lutën për të. O besimtarë, lutuni për atë dhe përshëndeteni me “selam!”” (Ahzab, 56.)

Megjithëse në Kuranin Kerim profetët e tjerë përmenden me emrat e tyre, Profeti ynë (a.s.), në asnjë ajet nuk është thirrur me emër, p.sh., O Muhamed. Për të gjithmonë është përdorur “O Nebi, O Resul”. Prandaj dhe Allahu i fton të gjithë besimtarët në një edukatë të tillë:

“Mos ia drejtoni thirrjen të Dërguarit, njësoj si thirrjen që ia bëni njëri-tjetrit!...” (Nur, 63.)

Ibën Abbasi (radijallahu anhuma), në lidhje me ajetin e mësipërm thotë:

“Njerëzit e thërrisnin Profetin (a.s.), “Ja Muhamed ose ej Ebu’lKasëm”. Por Allahu Teala, për të ngritur nderin e të Dërguarit të Tij, i ndaloi ata nga këto thënie. Që nga ajo kohë, njerëzit e thërrisnin Profetin; “Ja Nebijjallah ose ja Rasulallah”. (Ebu Nuajm, Delail, I, 46.)

Prandaj, përmendja e Profetit tonë (a.s.), vetëm me emër, bie ndesh me parimet e të qenit umet i tij. Bashkë me emrin e tij, duhet të përmendim edhe cilësi dhe virtyte të larta. Gjithashtu, duhet të tregojmë respekt dhe mirësjellje edhe ndaj çdo gjëje që ka afërsi me Profetin (a.s.).

Javuz Selim Hani, është një prej sulltanëve Osmanllinj, që e ka dashur shumë Profetin (a.s.). Në vitin 1517

çliroi Egjiptin dhe iu la amanet detyra e halifes. Në hutben që u mbajt në xhaminë Melik Muejjed, ditën e xhuma, më 20 shkurt, hatibi, duke folur për Javuz Selim Hanin, tha: “**Hakimu’l-Haramejni’sh-Sherifejn**” (Sundimtari i dy qyteteve të bekuara Meke dhe Medine). Sulltani ndërhyri, duke e ndërprerë hatibin dhe me sy të përplotur, tha:

“**Jo, jo! Hadimu’l-Haramejni’sh-Sherifejn**” (Shërbyesi i dy qyteteve të bekuara).

Më pas, ngriti tapetin dhe, duke bërë sexhde në tokë, falënderoi Allahun. Pastaj, për të shprehur qartë se ishte shërbyesi i dy qyteteve të bekuara, vendosi në çallmën e tij një kreshtë që ngjante si fshesë.



Respekt të madh ndaj qytetit të Profetit (a.s.), ka treguar edhe sulltani dëshmor, Abdulaziz Hani.

Një ditë, kur ishte i shtrirë në shtratin e tij, i sëmurë dhe i pafuqishëm, iu tha:

- Ka ardhur një kërkesë prej popullit të Medine-i Muneveres.

Abdulaziz Hani u tha ndihmësve të tij:

- Më ngrini menjëherë! Kërkesat që vijnë prej Haramejnit dua t'i dëgjoj në këmbë! Kërkesat e fqinjëve të Resulullahut nuk dëgjohen duke zgjatur këmbët kështu, në mënyrë të paedukatë...

Sa herë që vinte postë prej Medine-i Muneveres, merrte abdest, i puthte letrat, i vinte në ballë dhe thoshte: "Këto kanë pluhur të Medine-i Muneveres!", pastaj ia zgjaste sekretarit të parë dhe i thoshte: "Hape dhe lexoj!".

EDUKATA NDAJ MIQVE TË ALLAHUT

Ebu'l -Lejsi (Allahu e mëshiroftë!), pas komentimit të ajetit "**Mos ia drejtoni thirrjen të Dërguarit, njësoj si thirrjen që ia bëni njëri-tjetrit!..**" (Nur, 63,), thotë:

"Gjithashtu, nga ky ajet kuptojmë se edhe mësuesit e sinqertë që mësojnë të tjerët me dituri të dobishme, duhen respektuar. Pra, në këtë ajet nënkuptohet se edhe mësuesit dhe njerëzit e virtytshëm duhen respektuar.

Prandaj, kur përmenden njerëzit e dashur të Allahut, duhen përdorur fjalë që tregojnë respekt, në çfarëdo gjuhe qofshin. Kjo, sepse ne jemi të urdhëruar që të mos i thërrasim në emër as baballarët tanë biologjikë. Pra, mendoni se sa mungesë edukate do të ishte, nëse do t'i thërrisnim në emër baballarët tanë shpirtërorë!" (Ruhu'l Bejan, VII, 447.)

Për përparimin në rrugën shpirtërore, duhet qëndruar me edukatë e modesti pranë dijetarëve, që njëkohësisht, janë edhe trashëgimtarët e profetëve dhe të të dashurve të Allahut duke ndjekur dhe praktikuar këshillat e tyre. Qëndrimin pranë të dashurve të Allahut dhe marrjen e edukatës prej tyre, duhet t'i shohim si një mirësi e madhe, sepse kush shkon tek ata me edukatë, përfiton shumë prej tyre.

Profeti ynë i dashur (a.s.), thotë:

"*Ruhuni nga urtësia e besimtarit, sepse ai sheh me dritën e Allahut!*" (Tirmidhi, Tefsir, 15.). Paralajmërimi i hadithit, që shprehet me fjalën "Ruhuni!", nënkupton; "Mos shkoni tek besimtarët e përsosur me synime të fshehta dhe me zemër të turbullt! Ata, me një urtësi të veçantë, shohin edhe ato që ju mundoheni t'i fshihni". Për këtë

arsye, është thënë: "Pranë dijetarit ruaj gjuhën, pranë evlijasë ruaj zemrën!".

Prandaj duhet treguar një respekt i madh dhe i veçantë ndaj të dashurve të Allahut, të cilët gëzojnë një vend të veçantë në mëshirën e Allahut Teala. Është normë edukate, që në prezencë të tyre të mos flasësh, të mos ulesh dhe ngrihesh pa leje. Të tregosh mungesë edukate, sa të prishësh atmosferën shpirtërore, mund të nxisë edhe hidhërimin e Allahut të Madhëruar.

Sulltani i zemrave, Javuz Selim Hani, kur hynte tek ndonjë njeri i ditur, tregonte edukatë dhe nuk fliste asnjë fjalë pa qenë nevoja. Njëherë, kur shkoi për vizitë tek i nderuari Muhamed Bedahshi, një nga dijetarët e mëdhenj të Shamit, nuk foli asnjë fjalë, por vetëm dëgjoi dhe po në atë mënyrë u nda prej tij. Shoqëruesit e tij, shumë të habitur nga kjo gjë, e pyetën:

- O sulltan! Ju vetëm dëgjuat dhe nuk folët asnjë fjalë. Ku qëndron urtësia?

Javuz Selim Hani u përgjigj:

- Nuk është e përshtatshme të flasësh në mexhlisin e të dashurve të Allahut, kur ata janë duke folur, qofsh edhe sundimtar i botës. Edhe pse jemi sulltanë, gjithmonë jemi nevojtarë për urtësitë e tyre. Nëse do ishte nevoja të flisja, ata do të ma kërkonin vetë këtë gjë.

Shkurtimisht, edukata është një element që islami ua mëson njerëzve dhe i jep një rëndësi të veçantë. Kjo ndjenjë tregohet ndaj Allahut, Profetit, të dashurve të Allahut, prindërve, besimtarëve dhe të gjitha krijesave me radhë. Pasuria e arit dhe argjendit shkon, por pasuria e edukatës ngelet përgjithmonë. Prandaj, ne si besimtarë, duhet të mësojmë rregullat e edukatës, duhet t'i mbajmë të gjalla dhe të mundohemi që, duke u bërë shembull, t'ua mësojmë edhe të tjerëve. Për këtë, duhet të lexojmë librat e rregullave të edukatës dhe të mësojmë se si mund ta përmirojmë veten tonë. Por më e rëndësishme është të shoqërohemi me besimtarë të edukuar e të sinqertë, që janë si libra të gjallë dhe të përfitojmë prej tyre.

Allahu na mundësoftë të edukohemi me edukatën e Resulullahut (a.s.), të cilin Vetë Allahu e ka edukuar me edukatën hyjnore! Allahu na bëftë besimtarë të edukuar e të sjellshëm, të cilët përfitojnë prej dijetarëve dhe të dashurve të Allahut.

Amin!..



Ekuilibrin ndërmjet fesë dhe botës

— Prof. dr. Sulejman Derin —

Parimet kryesore të besimeve dhe ideologjive përcaktohen nga këndvështrimet e tyre ndaj kësaj bote dhe besimit në ahiret. E rëndësishme për mendimet filozofike si komunizmi, është bota në të cilën jetojmë dhe ndarja e saj me të tjerët. Sipas kësaj filozofie, bota është e vërteta e vetme, kështu që besimi në ahiret nuk ka kuptim.

Ndërsa kapitalizmi, megjithëse i bën idhuj pasionet e njerëzve, nuk e refuzon tërësisht besimin në ahiret. Madje, kur i leverdis, e përdor lehtë edhe fenë për interes. Në të njëjtën mënyrë edhe ithtarët e feve hyjnore kanë nxjerrë teza të ndryshme me njëra-tjetrën, në lidhje me këtë botë dhe botën tjetër.

Sipas ithtarëve të feve të tjera, çifutët e kanë tepruar në përfitimin nga mirësitë e kësaj bote. Kur po përparonin në rrugën e shpëtimit hyjnor që ua tregoi Musai, alejhisselam, ata nuk mundën të sakrifikonin qoftë edhe kënaqësitë shumë të vogla të kësaj bote, si qepët dhe hudhurat.

Nga ana tjetër, kristianët shpikën murgërinë, hoqën dorë totalisht nga kjo botë dhe e konsideruan mëkat nevojën njerëzore më themelore.

Islami, që është shpallja e fundit që i ka ardhur njerëzisë, qëndron larg këtyre dy ekstremeve. Islami ka vendosur ekuilibrin ndërmjet fesë dhe botës. Këtë botë e pranon si arë të ahiretit dhe sugjeron që të përdoret në rrugë të Allahut (xh.xh.). Sipas Islamit, fusha më e rëndësishme në të cilën sprovohet myslimani, është lidhja e tij me këtë botë. Kur bota të përdoret për fenë dhe të jetë një mjet për ahiretin, atëherë është arritur qëllimi.

Por për fat të keq, mashtrimi dhe joshja e kësaj bote i ka devijuar shpeshherë njerëzit nga rruga e drejtë. Për këtë arsye, të mëdhenjtë e misticizmit i kanë paralajmëruar njerëzit e thjeshtë dhe ata të elitës në lidhje me çështjen e mashtrimit të kësaj bote.

Në këtë material do të ndajmë me lexuesit tanë këshillat e Imam Rabbanit, të cilat na ndihmojnë që të vendosim ekuilibrin ndërmjet fesë dhe kësaj bote. Sipas Imam Rabbanit, realiteti i kësaj bote është ky:

“O bir! Kjo botë është një vend sprovimi dhe vështirësie. Aparenca e saj është e stolitur dhe e zbukuruar me çdo lloj stolie. Fytyra e kësaj bote, me makiazhin me pikëla dhe vija ngjyra-ngjyra që ka bërë, me gërshetat dhe me faqet fallso që mezi i ka zbukuruar, i ngjan një gruaje të shëmtuar. Me shikim të parë duket joshëse, e bukur, e freskët, e re dhe vezulluese. Ndërsa në të vërtetë, i ngjan një kërmë mbi të cilën është hedhur erë e mirë dhe një vendi plehrash, drejt të cilit vrapojnë qentë dhe mizat. Ajo është një helm, e shfaqur si vegim në shkretëtirë dhe si diçka e ëmbël, të cilën njeriu i etur e pandeh se është ujë.” (Letra e 73.)

Me të vërtetë edhe sot, shumë njerëz mashtrohen ndaj kënaqësive të përkohshme të kësaj bote dhe punojnë për dynjanë, sikur nuk do të vdesin asnjëherë. Ata jetojnë dhe brengosen vetëm për këtë botë, duke e harruar ahiretin. Të shpëtosh nga këto lloj brengosjesh si një njeri me vlerë, është shumë e vështirë. Në këtë situatë, Imam Rabbani na këshillon që ta lëmë këtë botë, të paktën ligjërisht:

“Atij njeriu që dëshiron të fitojë ahiretin, i takon që ta lërë këtë botë. Për shkak se sot është e vështirë që ta lësh këtë botë në kuptim të plotë, atëherë është obligim që të lihet ligjërisht. Lënia e botës ligjërisht do të thotë:

Të lidhesh ashtu siç duhet pas ligjeve të shariatit të lartë në çështjet fetare, të respektosh kufijtë ligjorë në çështjet e ngrënies, pirjes dhe banimit. Të mos e teprosh në këto çështje, të japësh zekatin e pasurisë dhe të kafshëve, i cili është obligim. Nëse është e mundur që të stolisemi me ligjet e shariatit, është e mundur që të shpëtojmë edhe nga dëmet e kësaj bote. Ja, pikërisht atëherë është arritur ekuilibri ndërmjet botës dhe fesë.” (Letra e 72.)

Sipas Imam Rabbanit, myslimanët që janë mashtruar pas jetës së kësaj bote, janë ata që nuk kanë zbatuar urdhrat e fesë në lidhje me çështjen e pasurisë që kanë fituar. Këtë klasë njerëzish, Imam Rabbani e përkufizon kështu:

“Nëse një njeri nuk mund ta lërë këtë botë, qoftë edhe ligjërisht, ky lloj njeriu është jashtë temës sonë. Besimi i tij në këtë formë, nuk do t’i bëjë dobi në ahiret.” (Letra e 72.)

Imam Rabbani tregon se është shumë e vështirë për të ikur nga kjo botë dhe se janë shumë të paktë ata myslimanë që mund të shpëtojnë nga shërrti i saj. Ai thotë:

“Sa fatmirë është ai njeri që e dëgjon këtë fjalë të drejtë, edhe pse në këtë botë ka shumë shërbëtorë që shtiren, ushqime të shijshme dhe rroba të bukura që e ndihmojnë.

Ai që e ka mbyllur veshin ndaj thirrjes sime, nuk dëgjon!

Ia shpjegoj, qaj, por ai nuk pranon!” (Letra e 72.)

Imam Rabbani e përkufizon kështu këtë botë, e cila nënçmohet në Kuran dhe në hadithe:

“O bir! A e di çfarë është kjo botë? Kjo botë është çdo gjë, si gratë, fëmijët, pasuria, fama, pozita, argëtimi dhe loja që të largojnë nga Allahu Subhanehu ve Teala dhe të pengojnë që të arrish te Ai.” (Letra e 73.)

Faktikisht, këto mirësi janë krijuar për njeriun. Problemi nuk është në përdorimin e tyre, por, kur të përdoren, të mos humbasë synimi bazë dhe të mos lejohen që të pengojnë arritjen te Allahu Teala.

Ata, të cilët largohen nga Allahu, duke u kënaqur me këtë botë, faktikisht janë njerëz që e kanë humbur ekuilibrin mendor. Ata janë njerëz që e kanë këmbyer të përhershmen me të përkohshmen dhe të bukurën me të shëmtuarën. Njëkohësisht e kanë harxhuar edhe kapitalin e përjetësisë që kanë në duart e tyre:

“Ai që është dashuruar me të (dynjanë), konsiderohet shpërdorues dhe i marrë. Ai që ndjek atë, është i çmendur dhe i mashtruar. Kush jepet pas aparencës së atij njeriu, në fytyrë i vendoset vula e humbjes së përhershme.” (Letra e 73.)

Sipas Imam Rabbanit, njeriu së pari duhet ta njohë mirë mashtrimin e kësaj bote, në mënyrë që të mbajë ekuilibrin ndërmjet fesë dhe botës. Përndryshe, kjo botë e mashtron njeriun dhe e bën ta harrojë ahiretin.

“I mençur është ai që nuk mashtrohet pas një kënaqësie të tillë të thatë dhe që nuk ndjen interes për një gjë të prishur si kjo. Për këtë arsye, fakihët (juristët myslimanë) kanë thënë: “Nëse një njeri ua lë testamentin e pasurisë së tij njerëzve të mençur, pasuria e tij u jepet njerëzve asketë.” Sepse ata nuk ndjejnë interes ndaj kësaj bote. Kjo tregon mentalitetin dhe zgjuarsinë e lartë të tyre.” (Letra e 50.)

Këto fjalë të Hazretit Imam Rabbanit janë për ata njerëz të cilët mashtrohen ndaj bukurive të përkohshme të kësaj bote. Sikundër kësaj, Hazreti Imam Rabbani në letrat e tij është bërë shkak që t’u plotësojë nevojat e kësaj bote shumë njerëzve dhe që mundësitë që kanë njerëzit, të përdoren në shërbim të fesë. Ai e shprehte kështu faktin se pasuria që harxhohet për të ngritur

lart shëriatin te Allahu do të ketë shpërblim të pafund, duke thënë:

“Nëse me mijëra florinj harxhohen për të lartësuar shëriatin dhe fenë, edhe virtyti i tyre do të jetë shumë i lartë. Madje, edhe një grosh që harxhohet me këtë qëllim, është i barabartë me mijëra florinj që harxhohen për qëllime të tjera.” (Letra e 48.)

Të mëdhenjtë nakshibendij kanë vendosur parimin: “Dora në punë, Zemra te Zoti”, për t’i mbajtur në ekuilibër punët e fesë dhe ato të kësaj bote. Njerëzit e mëdhenj, si Musa Topbashi, që ishte prej të mëdhenjve të zinxhirit të hoxhallarëve dhe që e kemi humbur në një kohë të afërt, fitonin për hir të Allahut dhe pasurinë e tyre sa malet e harxhonin për të.

Kur këta miq të mëdhenj të Allahut shpenzonin për vete, ishin shumë kursimtarë, ndërsa kur bëhej fjalë për fenë e Allahut, xhelle xhelaluh, jepnin me lehtësi pasuri shumë të madhe, madje pa përdorur emrat e tyre.

Në këtë mënyrë e shtruan dynjanë poshtë këmbëve të tyre për hir të fesë, në vend që të harxhonin fenë për hir të kësaj bote dhe pasurisë e saj, që është arma më e madhe e shejtanit për të mashtruar myslimanët, e bënë kurban në rrugë të Allahut, Subhanehu ve Teala. Shkrimin tonë le ta mbyllim me këto fjalë të Hazretit Imam Rabbanit:

“Prej etikës së misticizmit është edhe parimi që ta ndash shumë pasurinë dhe të mos e kursesh atë, por pa i lënë në pozitë të vështirë fëmijët dhe gruan. Ai që e njuh Allahun, thesaret e Tij i shikon si një det, ndërsa veten e tij si një njeri të ulur në breg të atij deti. Ai, i cili qëndron në breg të detit, nuk ka nevojë që të mbartë ujë, për shkak se gjithmonë është pranë ujit.” (Sadik Dana, Ligjëratat e Alltënollukut, III, 52.)

I Nderuari Musa Topbash e vendosi lidhjen që kishte me këtë botë në një themel të tillë dhe harxhoi në rrugë të Allahut pa i trembur syri. I lutemi Allahut të Madhëruar që edhe ne të na ndihmojë ta arrijmë këtë moral shembullor që kishin miqtë e Tij me karakter të lartë.





Refleksione

- 5 -

Nuredin Nazarko

180. Trëndafilat e vërtetë nuk shterojnë me bukurinë dhe aromën e mirë. Artificialët mund të jenë të bukur, por mungesa e aromës ua shter bukurinë.
181. Gëzimi i zemrave qëndron tek mirësia që shpërndan. Bëj atë që duhet me zemër të pastër, nëse do që zemra dhe fytyra të të buzëqeshin edhe në ditë të vështira.
182. Janë disa syresh që edhe gjithë të mirat e botës po t'u bësh vetëm të shajnë e mallkojnë. Mos u trishto! Secili ecën në udhën e vet.
183. Dashuria e sëmurë për veten dhe fodullëku janë shkatërruese për njeriun. Nëse vëren se të afrohen ngrihu e lufto me ç'të mundesh, që të mos mundesh prej tyre.
184. Aty ku ka aheng e dëfrim nuk do të thotë se ka gëzim.
185. Mendjemadhi është njeriu më i nënçmuar. Urren të tjerët, por edhe vetë është i urryer.
186. Ligësia e shpirtligut mbaron vetëm me vdekjen e tij.
187. Sa më e thellë të jetë dashuria, aq më e thellë është dhimbja e humbjes së saj.
188. Njeriu ecën i verbër drejt fatit të vet.
189. Për të marrë trëndafilin duhet të çirresh nga ferrat e të shpohesh nga gjembat.
190. Sado kohë të flesh, një ditë do të zgjohesh.
191. Në pyje të errët udha humbet kollaj.
192. I ligu nuk lë gur mbi gur për të arritur shkrirjen me ligësinë.
193. Gjërat themelore qëndrojnë mbi themele të holla si qime floku.
194. Shpirti i bukur nuk ka nevojë për llomotitje zburonjëse.
195. Për të shpëtuar nga e keqja durimi duhet të jetë i jashtëzakonshëm.
196. Për shkak të shpifjeve edhe mund ta pësosh rëndë. Qofshin mallkuar gjuhëhuat!
197. Makuti nuk di të ndalet. Në do të shpëtosh veten qëndroji shumë larg makutërisë.
198. Në do të bëhesh mjeshtrë, bëhu nxënës i mjeshtrave.
199. Uria është sprovuese e rëndë.
200. Pa i rezistuar stomakut nuk mund të ngjitesh mbi veten.
201. Nuk ka armiq të pamposhtur. Është thjesht çështje kohe.
202. Vërtetimi i situatave nuk ka nevojë vetëm për fjalë. Duhet të jesh aq i mençur që të ruash provat. Mund të ketë plot smirëzinj që duan të fitojnë duke përdorur triumfin tënd.
203. Gjumi të largon nga kryerja e detyrave me përgjegjshmëri. Kujdes! Mos fli në kohë të papërshtatshme! Tinëzarët janë të gatshëm në çdo moment.
204. Nuk mund t'i kryejë të gjitha punët një i vetëm. Bashkëpunoh!
205. Nuk duhet vetëm mençuri, por duhet edhe guxim për veprim.
206. Në jetë asnjëherë nuk mund të ndodhë vetëm

- ngjitje në lartësi e paqes dhe gëzimit. Me siguri dikush, dikund do të korkolepset në udhën tënde. Është po aq e sigurt që korkolepsja do të të sjellë përfitime që as vetë paqja e gëzimi nuk do të t'i jepnin.
207. I ligu kupton vetëm gjuhën e forcës. Grumbullo fuqi!
208. Gjakënxehtësia në gjykim e në veprim është shkatërruese. Bëj kujdes! Pendimi nuk mund ta kthejë kohën pas.
209. Besnikëria është virtyt i rrallë. Nëse të është dhënë dije se je nga të rrallët. Hap sytë e mos u moleps nga kolera e vetëkënaqësisë.
210. E liga që vjen nga njeriu i afërt është më shkatërruesja.
211. Pa u pjekur mirë në hell edhe mishi më i mirë nuk ka shije.
212. Bezdisja e vazhdueshme nga mizat ta humb durimin.
213. Duhet durim i fortë për të mos folur për atë që nuk duhet.
214. Mos i ekspozo mirësitë e tua. Fshehja e tyre mban larg sytë tinëzarë dhe të ruan nga intrigat e ligësitë e tyre.
215. Fati gjithmonë shkon përtej përlogaritjeve njerëzore dhe i fal njeriut atë që kurrë se ka menduar e përfytyruar.
216. Çmoji dhe vlerësoji të mirat që të janë dhënë. Përpiqu të kënaqesh me atë që zotëron. Shumojë nëse mundesh me drejtësi, por kurrë mos u përpi nga fjalët “mençurake” të të tjerëve dhe të çosh në esfel veten me gjithçfarë zotëron.
217. Shpesh iu besojmë pa kushte fjalëve të të tjerëve dhe vendosim në dyshim fjalën e të afërteve. Në ndodhtë kështu nuk do të shpëtosh nga plagët. Kësisoj rezervojë nga besimi i verbër ndaj çdokujt.
218. Atë që nuk e zgjidh mendja e të madhit e zgjidh mendja e të voglit.
219. Shkapërdarët nuk bëjnë asnjëherë prokopi.
220. Vjen një ditë dhe bukuria fizike humb. Ajo që mbetet është karakteri, mirë apo keq qoftë. Mos rend pas asaj që humb, por pas asaj që mbetet.
221. Në të qëlloftë gruaja dorëshpuar mirë boll do t'i kesh punët.
222. Ndodh që të mos jesh ai që je, por ai që të tjerët shohin.
223. Dalja nga situata është çështje karakteri. Jo të gjithë kanë të njëjtën prerje.
224. Ulëri dhe do të dukesh më i madh dhe më i tmerrshëm se ç'je në të vërtetë.
225. Shtatë hile një trimëri na thotë proverbi. Nuk ka si të jetë ndryshe kur të duhet të përballësh me situata përtej mundësieve.
226. Shejtan budalla. Do ti që ka nevojë bota edhe për këta.
227. Dinakët janë më të urryerit njerëz.
228. Nëse je pajtuar në një punë, kryerja siç duhet është amanet.
229. Dinakët mund të dalin nga situatat me dredhitë e tyre. Por jo gjithmonë zë lepur qeni.
230. Kur ke fuqi mos i shtyp të dobëtit, të pambrojturit, të varfërit. Do të bëhet havale ndonjë gjë e do të të hajë kokën.
231. Nëse të kaplon varfëria në vendin ku je, dil e kërkoje rriskun tënd. Është duke të pritur dhe askush nuk mund ta marrë veç teje.
232. Mos u lodh nëse je duke rendur pas rriskut. Nëse ke arritur në një pikë, nuk do të thotë se aq ishte. Vazhdo rendjen, sepse mundësitë shtrihen para teje.
233. Mos u jep prej lutjeve e përgjërimeve të atyre që bëjnë sikur japin edhe shpirtin për ty. Do të godasin aty ku nuk e pret në çastin më të parë, kur të vërejnë pavëmendjen tënde.
234. Njerëzit i nënshtrohen forcës dhe jo të drejtës. Bëhu prej atyre që i nënshtrohen të drejtës me vullnet të lirë dhe nuk do të ketë forcë të të nënshtrojë shpirtin.
235. Guximi dhe mençuria vlejné më tepër se dinakëria dhe përfitimet prej saj.
236. Mos u krekos! Mos u fodullo me zgjuarsinë që ke. Vjen dita dhe e pëson, e nuk të hyn në qese as zgjuarsia e as vetja.
237. Dy vetë mund të thonë të njëjtat fjalë, të bukura, të sajdisura, të ëmbla dhe plot dashuri. Ajo që i bën të ndryshëm këta të dy është lloji i zemrës që ka folur. Nuk mund të jenë kurrë njësoj fjalët e zemërmirit dhe zemërkeqit.
238. Kur vjen fjala tek paraja dhe pushteti të gjithë të huaj të bëhen, vetëm e vetëm që të arrijnë t'i rrëmbejnë, duke menduar se do t'i gëzojnë përgjithmonë.
239. Mos u nxito në gjykimin ndaj tjetrit, duke i vendosur llagape pa e njohur ende. Vjen koha dhe e drejta triumfon, e do të të duhet të përulesh para atij që fyeve e përçmove.

Këtu përfundojmë këtë cikël refleksionesh. Përfundimi nuk do të thotë shterim. Mundësitë reflektive shtrihen para nesh. Kalimi i kohës fizike me siguri do të na japë më shumë lëndë për reflektim. Ashtu siç është i pashtershëm burimi i refleksionit, ashtu duhet të jetë dhe vetë refleksioni. Urtësitë që përfitojmë nga përsiatjet janë thelbësore. Shumë prej tyre vijnë nga thellësitë e kohës dhe nuk ndryshojnë aspak. Çdokush mund ta shkundë pluhurin e shekujve dhe të ndjejë aromën misk të tyre. Për këtë mjafton një zemër e pastër, një vullnet i fortë dhe lutje të përsheptshme për të shpëtuar nga kurthet e vetëkënaqësisë.



Udhëzimi i Kuranit për paqen familjare

— Dr. Adem Ergyl —

Allahu i Madhëruar, i cili e filloi historinë njerëzore me Ademin (a.s.), fill pas tij krijoi edhe shoqen e tij¹. Në këtë mënyrë, duke formuar jetën familjare dëshiroi që ata të gjenin paqen dhe qetësinë me miqësi, mëshirë dhe dashuri ndaj njëri-tjetrit.

Fjala “zeuxh / bashkëshorte” e cila përmendet në ajetet kuranore që flasin në lidhje me këtë temë, tregon një të vërtetë shumë të rëndësishme në shndërrimin e institucionit familjar në një vend paqeje dhe qetësie. Nga studimet që janë bërë në lidhje me këtë temë, kanë dalë këto përfundime:

“Nëse Kurani përmend fjalën “zeuxh”, kur bëhet fjalë për kompaktësinë e besimit, ndjenjave dhe vlerave midis bashkëshortëve, por në fakt kjo kompaktësi nuk është arritur, atëherë aty përdoret shprehja “gruaja e filanit”, që tregon se bëhet fjalë për një marrëdhënie martesore thjesht me fjalë. Në ajetet kuranore, në lidhje me bashkimin e Ademit (a.s.), me nënën tonë Hava² dhe marrëdhëniet familjare midis Rasulallahut (a.s.), dhe bashkëshortëve të tij³, përdoret fjala “zeuxh / bashkëshorte”. Ndërsa, kur përmenden gratë jobesimtare të Nuhut (a.s.) dhe Lutit (a.s.), përdoret fjala “grua”⁴. Kjo tregon se ata nuk kishin një familje, ku mbizotëronte paqja dhe qetësia. Gjithashtu edhe kur përmendet Faraoni me gruan e tij Asije, përdoret fjala “gruaja e Faraonit”⁵. Kjo, sepse Asija ishte besimtare, ndërsa Faraoni jobesimtar dhe për këtë arsye, familja e tyre nuk ishte kompakte në besim.”

Kjo hollësi, tregon se në paqen familjare, në radhë

të parë vjen mendimi kompakt i të dyja palëve në besim dhe vlera. Prandaj, kushti themelor i paqes në një martesë, nuk është bukuria e trupave, por kompaktësia e vlerave dhe afërsia e shpirtëve. Ky fakt shprehet më së miri edhe në këtë ajet fisnik:

“Mos u martoni me paganet, gjersa të bëhen besimtare. Skllavja besimtare është më e mirë se pagania, edhe nëse kjo e fundit mund t’ju pëlqejë. Mos i martoni myslimanet me paganë, gjersa ata të bëhen besimtarë. Skllavi besimtar është më i mirë se pagani, edhe nëse ky i fundit mund t’ju pëlqejë. Ata ju thërrasin në zjarr, kurse Allahu, me mirësinë e Tij, ju thërret në Xhenet e falje (të gjynaheve). Ai ua shpjegon njerëzve shpalljet e Veta, që ata të mendojnë.” (Bekare, 221.)

Në rrugën e jetës, gëzimi dhe paqja familjare mund të arrihen vetëm me bashkim zemrash dhe karakter të mirë. Për këtë arsye dhe Profeti ynë (a.s.), në lidhje me zgjedhjen e bashkëshortës, ka tërhequr vëmendjen tek morali i bukur.

Këtë të fshehtë mund ta shohim edhe nga kjo pikëpamje. Të ndërtosh një fole të qetë familjare me dikë që nuk ka qetësi shpirtërore, është shumë e vështirë. Sipas Kuranit, shpirt i qetë, është shpirti që ka gjetur Allahun⁶. Ndërsa besimi, është shkalla e parë e kësaj gjetjeje dhe çdo ligj i islamit është një eliksir më vete i paqes dhe i qetësisë. Devotshmëria e jetuar me vetëdijen se je gjithmonë nën vëzhgimin e Allahut, është zhytje në detin e gjerë të paqes. Themeli i prishjes së qetësisë, është shpirtngushtësia. Ndërsa islami, është një nur, i cili zgjeron shpirtat.

Kurani Kerim shprehet se familja duhet të ruhet

1. Surja Nisa, 1.
2. Surja Bekare, 35.
3. Surja Ahzab, 6.
4. Surja Tahrim 10.
5. Surja Kasas, 9.

6. Surja Ra'd, 252.

vazhdimisht nga ana e besimit dhe islamit, përndryshe jeta e përjetshme do përfundojë me xhehenem⁷. Në veçanti, urdhëron që të tregohemi të përpiktë në lidhje me faljen e namazit⁸, sepse namazi është një adhurim, i cili e ruan njeriun nga gjynahet dhe çdo veprim i pahijshëm⁹.

Dihet se gjynahet më të mëdha që e prishin qetësinë familjare, madje e shkatërrojnë atë, në të shumtën e rasteve bëhen si rezultat i mosfrenimit të epsheve. Për shkak se prish zemrat dhe cenon besnikërinë, Kurani Kerim e ka ndaluar shikimin e haramit. Kthimi i syve dhe i zemrave të bashkëshortëve nga njëri-tjetri dhe jo përreth, është e mundur vetëm me dëshirimin e të lejueshmes dhe zbatimin e të drejtave të njëri-tjetrit në mënyrën më të bukur. Kurani Kerim, i ka këshilluar shumë besimtarët edhe në këto çështje. Madje, mund të thuhet se ligjet më të detajuara në Kuran, janë ato që kanë të bëjnë me familjen.

Çdo njeri që nuk e ka gjetur shokun e shpirtit, është edhe i trazuar shpirtërisht, edhe i mbetur përgjysmë. Është i trazuar shpirtërisht, sepse, siç shprehet edhe Mevlana: “Nëse njëra prej këpucëve të shtrëngon, edhe tjetra nuk të hyn në punë”. Është i mbetur përgjysmë, sepse bashkëshortët janë dy pjesë të veçanta që plotësojnë njëra-tjetrën. Mungesa e njërit, e lë përgjysmë edhe tjetrin. Ky është edhe shkaku që një nga dëshirat e veçanta të robërve të mirë të Rrahmanit, ndaj Zotit të tyre, është që të kenë “bashkëshort/e dhe fëmijë, që do të bëhen drita e syrit dhe lumturia e shpirtit të tyre.”¹⁰

Të bëhesh bashkëshort/e që e plotëson bashkëshortin e vet, duhet të jetë qëllimi kryesor i çdo bashkëshorti. Ndërsa kjo është e mundur, vetëm nëse çdo njëri prej bashkëshortëve luan me përpikëri rolin e tij. Nëse gruaja merr mbi supe rolin e burrit ose burri bën punët e gruas, paqja dhe qetësia e familjes nuk do të jetë e mundur, sepse çdo gjinie i janë dhënë aftësi të veçanta. Pikërisht në lidhje me këtë çështje, transmetohet një hadith i Profetit tonë (a.s.):

Një ditë, Ummu Seleme (r.anha.), i thotë Rasullahut (a.s.): “O i Dërguar i Allahut! Burrat luftojnë, ne nuk mund të luftojmë dhe në trashëgimi marrim sa gjysma e tyre”. Ajo i kërkon një shpjegim për këtë dhe veçanërisht për faktin se, përse hixhreti i grave nuk përmendet në Kuran. Gjithashtu, ajo e pyet edhe për faktin se përse për të dëshmuar duhen dy gra, në vend të një burri dhe se a do të marrin gratë shpërblim për punët e tyre njësoj si burrat. (Tirmidhi, Tefsir 4/8-9.) Në lidhje me këto pyetje, u zbrit ky ajet fisnik:

“Mos i lakmoni ato gjëra, me anë të të cilave Allahu i ka bërë disa nga ju të dallohen mbi të tjerët: meshkujt do të kenë pjesë prej asaj që kanë punuar e po ashtu edhe femrat do të kenë pjesë

7. Surja Tahrir, 6.

8. Surja Ta-Ha, 132.

9. Surja Ankebut, 45.

10. Surja, Furkan, 74.

prej asaj që kanë punuar. Kërkoni prej Allahut nga mirësitë e Tij. Vërtet, Allahu është i Dijshëm për çdo gjë.” (Nisa, 32.)

Ashtu si në çdo udhëtim, edhe në këtë udhëtim të jetës që fillon me martesën, gjithmonë është e mundur të përjetohen gjëra të papëlqyeshme. Në këto raste, këshilla e parë e Kuranit, është që çështjen ta shohësh nga një pikëpamje pozitive:

“...Jetoni e silluni mirë me to (gratë)! Në qoftë se ato nuk ju pëlqejnë aq shumë, (duronit!) sepse është e mundur që juve të mos ju pëlqejë diçka, por që Allahu në atë do t’ju sjellë shumë të mira.” (Nisa, 19.)

Ndonjëherë, në familje mund të ndodhin edhe ngjarje të papëlqyeshme, të cilat mund të shkojnë edhe deri në armiqësi ndërmjet bashkëshortëve. Në këto raste është këshilluar të tregohemi të matur dhe të jemi falës e tolerantë:

“O besimtarë! Në të vërtetë, ju keni armiq në radhët e grave tuaja dhe të fëmijëve tuaj, andaj ruajuni prej tyre! Por, nëse nuk i vini re fyerjet e tyre dhe ua falni, ta dini se Allahu është vërtet Falës dhe Mëshirëplotë.” (Tegabun, 14.)

Por në rast se shtohen prishja e qetësisë dhe dobësitë morale, propozohen mënyra të tjera kurimi. Pikësëpari, këshillohet me butësi, pastaj ndahen shtretërit dhe më në fund rrihet lehtë.¹¹

Për të shpëtuar familjen dhe si zgjidhje e fundit, kërkohet ndërhyrja e dy personave dashamirës prej të afërmeve të bashkëshortëve, me qëllim pajtimi¹². Të gjitha këto mënyra, në Kuranin Kerim tregohen pjesë-pjesë dhe kjo tregon qartë rëndësinë që i ka dhënë Allahu institucionit të martesës.

Fëmijët, që janë edhe frytet e pemës familjare, njëkohësisht janë edhe elemente që plotësojnë lumturinë familjare. Në përgjithësi, prej atmosferës paqësore familjare, që formojnë bashkëshortët, rriten breza të shëndoshë. Ndërsa, në foletë familjare ku mungon dashamirësia dhe dashuria, është e vështirë të rriten fëmijë që do të bëhen drita e syrit.

Padyshim se edukimi i fëmijëve të mirë dhe jo plangprishës, varet nga marrëdhëniet e mira familjare. Nëse prindërit hapin krahët e mëshirës dhe dashurisë ndaj fëmijëve të tyre, edhe të vegjlit do të tregojnë mirësjellje dhe respekt ndaj më të mos-huarve dhe kjo do ta kthejë familjen në një bahçe xheneti.

Si përfundim, duam të theksojmë edhe faktin se ndërtimi i një foleje të qetë familjare, në fillim, në vazhdim dhe madje, që të vazhdojë deri në xhenet, gjithmonë ka nevojë për ndihmën dhe mëshirën hyjnore. Për të arritur këtë, kërkohet që bashkëshortët dhe fëmijët të bëjnë një jetë të mbushur me lutje dhe adhurime. Kjo është një nga recetat udhëzuese që na ka treguar Kurani Kerim, për të arritur paqen dhe qetësinë familjare.

11. Surja Nisa, 34.

12. Surja Nisa, 35.



Jeta si ripohim i paktit të kryehershëm me Zotin

— Vehap S. Kola —

I gjithë angazhimi njerëzor në jetë mund të përkufizohet kështu: ripohim i paktit të kryehershëm me Zotin. Është fjala pikërisht për atë pohim, betim, besëlidhje, e cila që në kryehershmëri qëndron në themel të marrëdhënies ndërmjet njeriut dhe Zotit dhe i jep frymëmarrje vetë vazhdimësisë së shoqërisë njerëzore. Historia e ekzistencës së njeriut nis atëherë *“Kur Zoti yt nxori nga kurrizi i bijve të Ademit pasardhësit e tyre dhe i bëri të dëshmojnë kundër vetes së tyre: “A nuk jam Unë Zoti juaj?” Ata u përgjigjën: “Po, dëshmojmë se Ti je.” Kështu bëri Ai, në mënyrë që ju (o njerëz) të mos thoni në Ditën e Kiametit: “Këtë nuk e kishim ditur.”¹ Që atë çast, njeriu është i ngarkuar me përgjegjësinë për ta ripohuar këtë pakt përmes jetës, pa mundësinë për ta tjetërsuar apo transferuar këtë përgjegjësi. Përpjekjes së disa shoqërive për të zhveshur veten nga pesha e këtij amaneti, Zoti i përgjigjet *“Mbajeni fort atë që ju dhamë dhe kujtoni çfarë përmban ajo, që të ruheni nga gjynahet.”²**

Sot, shoqëria njerëzore përpëlitet në të njëjtën përpjekje shfajësuese dhe arratiake dhe për pasojë, mbi kokat e njerëzve bën hije mali i peshës së shfajësimit për braktisjen e besëlidhjes. Ndërsa dimë përfundimin e historisë, së cilës i referohet Kurani, ne nuk jemi aspak të sigurt rreth përfundimit që do të ketë ajo e jona. Ne jemi të sigurt vetëm për hapësirën e mundshmërive të saj: nëse e pohojmë

besëlidhjen e vjetër, do të mund të vazhdojmë jetën, në të kundërt, mali do të bjerë mbi ne dhe jeta e shoqërisë njerëzore mund të ndërpritet. Është frikëndjellëse të dëshmosh sesi ne, njerëzit, ashtu si jemi sot dhe me atë drejtim që kemi, kemi zgjedhur një rrokullisje drejt mundësisë më të keqe, asaj fatales. Nevojitet një kthim i shpejtë dhe i fortë drejt besatimit të moçëm, që kjo mundësi të mos bëhet e pashmangshme.

Debatit se ku është e ruajtur dhe kush është dëshmitar i kësaj marrëveshjeje midis Allahut dhe bijve të Ademit, i jep fund vetë qenia e njeriut. Ajo gëzon, trashëgon, përmban në thelb të saj këtë betim në formën e natyrës së pastër burimore. Është kjo arsyeja pse të shpëtuar, në ditën e Gjykimit, do të quhen ata që dalin përpara Zotit të tyre me zemër të pastër. Është ruajtja e pastërtisë së zemrës, që Zoti ka vendosur në njeriun, ajo që garanton rikonfirmimin e kërkuar të paktit të kryehershëm. Në ç’shikallë është ruajtur kjo natyrë burimore e zemrës, përcakton edhe forcën me të cilën njeriu aspiron të njohë dhe dëshmojë Zotin në unitet të kulluar. E thënë më ndryshe, është qartësia e jehonës së atij pohimi – *“Po, dëshmojmë se Ti je.”* – kumbimi i tij në zgafellat e qenies njerëzore, që shkakton këtë aspiratë të njeriut.

Kurani, ashtu si vetë krijimi i njeriut përsëpari, i bën jehonë këtij pakti dhe i bën apel njeriut të kthejë sytë nga vetja, ashtu si nuk i bën apel kaq të fortë të hedhë vështrimin jashtë tij. Sepse gjurma më e qartë dhe, me gjasë, më e ruajtur e kësaj besëlidhjeje gjendet pikërisht në vetë njeriun. Me leximin ritual të tij, myslimani e rigjen atë gjuhë të vjetër dhe e rishqipton atë aspiratë, duke e ripërtërirë dhe

1. *Kuran*, surja El-A'râf, 172.

2. *Kuran*, surja El-A'râf, 171.

realizuar potencialisht. “Fjala është një kumbim i brendshëm.” Ky kumbim buron pjesërisht (në mos kryesisht) nga objekti që shënon fjala. Por, nëse nuk e shohim vetë objektin dhe dëgjojmë thjesht emrin e tij, në kokën e dëgjuesit lind një imazh abstrakt, një objekt i çmaterializuar që ngjall menjëherë dridhje në zemër³. Por Kurani nuk është një hajmali, një formulë e pakuptueshme apo një relike magjike. Ai ofron parimet udhëheqëse të jetës, që rikonfirmon paprerë besëlidhjen e vjetër.

* * *

Myslimanët e shekullit të njëzetë dhe njëzetënjëtë janë të troshitur ndërmjet objektivash qendërikëse të suksesit, progresit dhe mirëqenies. Islami u mëson atyre të bëjnë një jetë të moderuar, të drejtë dhe shpirtërore. Mësimet e fesë u thonë atyre të mos derdhen në konsum, luks dhe kënaqje, pasi ky është trualli i teprimit, shpërdorimit dhe idhujtarisë. Vënia e jetës në shërbim të përjetësisë, apo shërbimi ndaj jetës si një synim autonom, kjo është dilema. Në fakt, përgjigja në rrafshin teorik është e qartë: jeta është një mundësi, jo një synim. Çfarë ngjall diskutim është sfera e konkretes, e të përditshmes dhe fusha e veprimit të myslimanit të thjeshtë. Sharrimet moderne të kuptimeve të gjërave në fenë islame, e kanë kthyer dukshëm vështrimin e myslimanit nga kjo botë.

Të jesh mysliman i gjithëfarlojshëm është e mundur sot: mysliman praktikant, modern, progresist, europian, amerikan, paqësor, moderator, i vërtetë etj. Mirëpo, të gjithë këta togfjalësia gjymtues e përdorjnë emrin mysliman si një identitet socio-politik, si një përkatësi solidare, si një model sociologjik e që këtej, injorojnë thelbin e ngarkesës kuptimore e intelektuale dhe kuadrin e plotë të pritshmërive që duhen përmbushur për të merituar këtë emër. Por, pasi e ka zhbërë myslimanin bashkëkohor përmes asaj makinerie instrumentash dhe metodash mendjebjerrëse dhe shpirtngurtësuese, qytetërimi bashkëkohor i dëftën atij se mund ta gëzojë titullimin mysliman, vetëm duke e trajtësuar atë sipas karakterizimeve të reja, kryekreje të palidhura me, dhe shpeshherë reduktuese të qenësisë myslimane.


Të jesh mysliman, sipas kuptimësisë dhe ngarkesës që mbart ky nocion, është ajo që kërkohet dhe mjafton për njeriun. Meqenëse, nuk është e mundshme të shkruhet një platformë e plotë apo manual i hollësishëm i myslimanit shembullor, është

e mundur të theksojmë çfarë mungon më shumë në jetën e besimtarit mysliman shqiptar: shpirtërorja e mirëfilltë. Në vend që të keqkuptohet si një shtim sasior i adhurimeve, jeta shpirtërore duhet të kuptohet si një shtrirje e pranisë së përmasës shpirtërore të gjërave në të gjithë veprimtarinë e njeriut. Jeta shpirtërore duhet të konsistojë në përkushtimin në adhurim, përkushtimin e tërësishëm ndaj Allahut, Më të Lartit, mospërfillje ndaj stolive dhe bukurisë së botës, vetëpërmbajtje nga kënaqësia, pasuria dhe prestigji i vërejtur në shumicën e njerëzve dhe veçimi prej të tjerëve për të adhuruar në vetmi. Ky ishte rregulli i përgjithshëm i shokëve të Profetit (a.s.).

Gjithçka në jetë dhe qytetërim duhet të jetë në funksion të shpirtit. Shtëpia, puna, bashkëshortët, qeverisja, qyteti dhe festa kanë si funksion të shërbejnë si lëvozhgë për bërthamën shpirtërore të ekzistencës sonë. Qëndrimi i myslimanit në shtëpi nuk duhet të dallojë nga qëndrimi në xhami: në të dy rastet, njeriu duhet të jetë njësoj i vetëdijshëm mbi praninë e Allahut, mbi plotvështrimin dhe gjithëdëgjimin e Tij. Namazi në shtëpi, në punë apo në festë duhet të jetë i njëjti: gjithëherë një takim me Zotin dhe një ndijim i pranisë hyjnore. Ndarja dhe kategorizimi i gjërave në shpirtërore dhe të kësaj bote, është e huaj dhe gjithëpoaq e helmët.

Së fundmi, është me vend të kthehet vëmendja edhe tek përfaqësuesi *par excellence* i veprimtarisë shpirtërore: *dhikri*. Për një shumicë njerëzish, ai është një akt vullnetar dhe shfaqet në formën e shqiptimit të përsëritur të disa formulave të shkurtra në gjuhën arabe. S’do mend se dhikri është (duhet të jetë) thelbi i adhurimit dhe veprimit njerëzor në tokë. Çdo gjë që i ndodh njeriut, duhet t’i kujtojë atij Zotin. Ndërkaq, çdo gjë që ai (njeriu) bën, duhet bërë si formë e rivendosjes së lidhjes së kryehershme me Qiellin. Mirëpo, shfaqja më klasike e dhikrit është kredhja (në vetmi ose në kuvend) në përmendjen e Allahut, që shërben si mekanizëm korrigjues i deformimeve shpirtërore e intelektuale, përsheptues i afrimit pranë Tij dhe amplifikues i thirrjes së brendshme (*fitra*) për ripohimin e paktit të kryehershëm. Rikthimi i traditës së kuvendeve të dhikrit është një sfidë kryesore për myslimanët dhe një domosdoshmëri e patjetërsueshme. Për sa kohë ato mungojnë apo shikohen me frikë si shtojca në fe dhe aq më tepër nuk njihen, Islami do të vijojë të shihet si ideologji, identitet social dhe si krenari politike. Dhe, ç’është më e keqja, Islami nuk do të jetë rruga e urtë drejt lumturisë së përjetshme, por rruga e shkurtër dhe e vrazhdë kah gara për këtë jetë gjithaq të shkurtër dhe të vrazhdë.

3. Vasili Kandinski, *Mbi Shpirtëroren në Art*, Botime Perpjekja, Tiranë 1998, fq. 38.



Boshti i TEUHIDIT

— Idris Arpat —

Në themel të luftës së Profetëve ka dy parime universale, të cilat nuk ndryshojnë asnjëherë: Teuhidi përballë shirkut (bërja shok Allahut), dhe drejtësia përballë dhunës.

Fjala teuhid do të thotë të njësoh, të bësh një, ndërsa si term, teuhid do të thotë të pranosh se Allahu Teala nuk ka të ngjashëm as në thelbin ekzistencial dhe as në thelbin cilësor. Fraza e teuhidit është një aforizëm, i cili shpreh obligimin që ka myslimani për të njësuar Allahun Teala dhe për këtë arsye, Profeti (a.s.), thotë: “Ai që thotë, La ilahe il-lallah, shpëton.”

Kur themi njëshmëria e Allahut, ajo që na vjen në mendje në fillim është njëshmëria në esencën e besimit, ndërsa njëshmëria me vepra është pika e dytë, e cila do të thotë se rregullat e vlerësimit të të gjitha veprimeve tona merren nga një burim i vetëm dhe ajo që është e lejueshme, përcaktohet nga këto rregulla.

Meqënëse tokat, qiejt, pasuria dhe bota e ekzistencës, bota e dukshme dhe e padukshme janë të Allahut Teala, edhe autoriteti dhe pushteti janë të Tijat.

Allahu Teala nuk ka të ngjashëm as në thelbin ekzistencial dhe as në thelbin cilësor. Ai nuk është i lindur dhe s’ka lindur askënd. Cilësitë e Tij nuk kanë fund e kufi. (Shih. Sure Ihlas.)

Allahu Teala është Qenia Madhështore të cilin Kur’ani dhe Sunneti e përshkruajnë me 99 emrat më kryesorë. Ashtu sikur nuk e dimë se sa janë në të vërtetë emrat e Allahut, ashtu nuk mund të dijmë në mënyrë të saktë se ç’kuptim kanë dhe se ç’farë ndikim ka pasqyrimi i tyre në jetën njerëzore dhe në univers. Kështu që, ato që dijmë për Allahun Teala nuk janë të qarta dhe të mjaftueshme. Sikur t’i njihnim të gjitha dimensionet e “Esmau’l Husna” (Emrat më të bukur të Allahut) dhe të merrnim mësim prej kësaj njohurie, do të zotëronim një botëkuptim më të bukur se atë që kemi sot dhe do të kishim një jetë më cilësore. Botëkuptimi ynë njerëzor dhe shikimi ynë kundrejt materiales do të ishte shumë më i ndryshëm dhe më me nivel.

Kuptimi i teuhidit (njëshmërisë) është i lidhur me kuptimin e “Esmau’l Husna”. Nuk na hyn në punë një teuhid i kuptuar si: “Allahu është një dhe nuk është dy”. Ç’është përmbajtja e kësaj njëshmërie dhe si pasqyrohet ajo në jetë? Çfarë botëkuptimi zgjon tek ata që e pranojnë? Kjo pra është edhe pika më e rëndësishme.

Allahu është zotërues i vullnetit dhe Krijuesi Madhështor. Ashtu siç ka caktuar ekzistencën e gjith-

çkaje, po ashtu cakton edhe qëllimin e saj. (Shih: Sure Nahl, 9.) Allahu rregullon të gjitha çështjet e jetës. Flamurtarët e teuhidit meditojnë për të gjitha çështjet që përmbajnë jetë. Ata zotërojnë një mënyrë shikimi kritik.

E kundërta e teuhidit është adhurimi i tagutit. Tagut është çdo lloj fuqie, institucion apo person, që merr mbi vete kompenzat e Allahut dhe mundohet t'i skllavërojë dhe t'i bëjë njerëzit adhurues të tij. Taguti e vazhdon sundimin e vet duke prishur dhe shtrembëruar rregullat e besimit.

“Ju, në jetën tuaj mund të mos kryeni adhurime ndaj njerëzve sikur dilni përpara Allahut dhe falni namaz. Mund të mos prisni kurban për ta, mirëpo, kur këto njerëz ndalojnë diçka kundër vullnetit dhe dëshirës së Allahut, ju nuk i veproni dhe ruheni prej tyre. Dhe, megjithëse këto urdhëra dhe ndalesa bien në kundërshtim me urdhërat dhe ndalesat e Allahut, ju u bindeni atyre. Ja pra, kjo do të thotë shirk (t'i bësh shok Allahut).” (Prof. Dr. H. Karaman, Ensar Vakfi Bülteni Mart-Nisan 1993. s.6.)

Teuhid do të thotë, t'i bëshesh rob vetëm Allahut.

“Thuaj: Namazi im, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime janë thjesht për Allahun, Zotin e botëve. Ai nuk ka shok (nuk adhuroj tjetër). Me këtë (thjeshtësi të adhurimit vetëm për Zotin) jam i urdhëruar dhe jam i pari i myslimanëve (i pari që pranoj dhe bindem)!” (En'am, 162-163.)

Profeti ynë (s.a.u.s.), urdhërohet që krahas adhurimit që bënin mushrikët ndaj putave (zota), tërë jetën e Tij t'ia përkushtonte vetëm Allahut Teala, me namazet, me kurbanet dhe me gjithë qenien e Tij, deri në vdekje, dhe të jetë myslimani i parë që e merr mbi vete këtë detyrë. Kështu, që të deklarojë me besim të plotë dhe të sigurt se kurrë nuk do të njohë zot tjetër përveç Allahut Teala. (Kur'an Yolu, 2. C.)

Pjesa “...Vetëm Ty të adhurojmë” do të thotë, besim, adhurim dhe rregull social. Fjalja “vetëm prej teje kërkohet ndihmë”, shpreh sinqeritetin dhe njësimin e Allahut me vepra (të mos e ulim kokën para askujt përveçse para Tij dhe të mos njohim askënd tjetër me cilësitë dhe kompetencat që i takojnë vetëm Atij). Fjalja “Udhëzoni (përforconi)

në rrugën e drejtë!” mbart në vetvete, adhurimin, disiplinën, mendimin dhe moralin. (Kuran Jollu, Shpjegimi i Sures Fatih)

Meqenëse ne kemi premtuar se do të adhurojmë vetëm Allahun dhe jemi shprehur se jetën tonë ia kemi kushtuar vetëm Atij, do të thotë se ne kërkohet një jetë, boshti i së cilës të jetë Allahu. Jeta që ka si bosht Allahun, është një jetë që ka për bosht Kurandin, Sunnetin, natyrshmërinë dhe ndërgjegjen. Kurani dhe Sunneti janë shpallja e vullnetit hyjnor. Natyrshmëria është gjendja e parë e njeriut, e cila është rregulluar nga Allahu. Ndërsa ndërgjegjja është zëri i Allahut brenda nesh, i cili është futur në zemrën tonë.

“Jetën time ia kushtova Allahut” do të thotë: “Për mua, kënaqësia e Allahut është gjithmonë në plan të parë.” Por ç'është e kundërta e kësaj? Ajo është të kushtuarit e jetës vetëm njeriut ose gjërave të tjera që janë nën nivelin e tij ose e thënë ndryshe të shpërdoruarit e jetës pas dëshirave dhe epsheve.


Të kushtuarit e jetës një krijese me të njëjtin nivel, apo edhe më të ulët, nuk përputhet me urtësinë, por gjithashtu nuk është as diçka e logjikshme dhe e natyrshme.

Meqenëse zotëruesi i Tokës dhe i gjithë universit është Allahu i Madhëruar, ndërhyrja në to bëhet vetëm me vullnetin e Tij dhe me aq sa lejon Ai.

“La ilahe” është refuzimi i gabimeve dhe “il-lallah” është pranimi i së drejtës. Shkrimtarë dhe mendimtarë si Niçja, Sartri, Kamy dhe të tjerë, parullën “la ilahe” e përhapën në një fushë të gjerë, por nuk mundën të hynin në kopshtin e “il-lallah”. Kjo i çoi ata nga gabimi në gabim. Dhe më në fund, ata u përpëliten në moçalin e të pashpresëve dhe vuajtën shumë.

Nëse pranohen të drejtat pa u refuzuar gabimet, ndodh përplasje midis të vërtetës dhe të gabuarës. Kjo është një sintezë (lidhje) që tashmë e ka humbur interesin për të vërtetën. Ne myslimanët, ashtu siç jemi të urdhëruar të mos e fshehim të vërtetën, po ashtu jemi urdhëruar edhe të mos e ngatërrojmë të vërtetën me të pavërtetën. (Shih: Bakara, 42.)

E vërteta është ajo, e cila i përshtatet caktimit të Allahut, ndërsa e pavërteta është ajo e cila nuk i përshtatet atij. Teuhidi nuk i pranon as idetë e paqarta që do t'i ngatërronte mendjet. Çdo të thotë të rrih



e të thuash “la ilahe”, ndërsa je duke i hedhur me dhjetra heshta të helmatisura mendjes dhe zemrës? Ashtu siç shprehet dhe Imam Gazzaliu, “Nëse ti nuk e kupton të vërtetën e teuhidit dhe të ndarjes që përmban “kelime-i teuhid” (fjala e njësimit të Allahut), atëherë ti nuk je duke thënë “la ilahe il-lallah”. Për këtë e ka fjalën edhe ajeti i nderuar kur shprehet: **“Mjerë për ata, të cilët nuk falen, janë të pakujdesshëm ndaj namazit”** (Maun 4-5.) Ne jemi të obliguar që më parë të kuptojmë pastaj të përkujtojmë, të dimë pastaj të flasim.

Ashtu si shprehja “Eudhu bil-lahi mineshejtani rrahim” nënkupton strehimin tek Allahu për t’u shmangur gabimeve, ashtu edhe shprehja “Bismillahi Rrahmani Rrahim” nënkupton pranimin e gjërave të drejta. Nga një këndvështrim, teuhid do të thotë, të jetosh jetën me qëllime të pastra, me rregulla të drejta dhe ndjenja të bukura. Për ne, burimi i së drejtës dhe së bukurës është Kurani Famëlartë dhe Sunneti i Profetit tonë (s.a.u.s.). Çdo rregull që përshtatet me Kuranin dhe Sunnetin është brenda kornizës Islame. Si myslimanë që jemi, duhet të studiojmë të gjithë kulturën botërore, dhe duke e pranuar çdo gjë të drejtë mund ta pasurojmë në përmasa të mëdha kulturën dhe botëkuptimin tonë.

Teuhidi pasqyrohet në jetën tonë edhe si drejtësi dhe sinqeritet. Dhe nga ky pasqyrim, lind një pavarësi nga të tjerët, përveç Allahut, dhe një cilësi e mrekullueshme e jetës, sepse gjëja kryesore është që Allahu të pëlqejë qëllimin dhe veprën tonë. Veprat dhe qëllimet që do të paraqiten në një post më të lartë, duhet të jenë pa të meta. Nuk kërkohet pëlqimi i njerëzve, por i Allahut.

Ekzistenca dhe njëshmëria e Allahut e përfshin njeriun nga jashtë dhe nga brenda. **“Vërtet, ata dyshojnë në takimin me Zotin e tyre, por le ta dinë se Ai ka nën kontroll çdo gjë.”** (Fusilet 54.)

E ka përfshirë aq shumë sa që nuk ka asnjë gjethe që bie nga pema dhe Ai të mos e dijë. (Shih: Sure En’am 59.) Për këtë arsye, ashtu si zemra e myslimanit është e mbushur vazhdimisht me dashurinë ndaj Allahut, ashtu edhe çdo mrekulli në këtë botë ia mban gjallë emocionin hyjnor, ndërsa fryti i kësaj është mosdhënia rëndësi gjërave të kësaj bote, ose thënë ndryshe, të kalosh përfundimisht nga bota e vdekshme dhe të qëndrosh tek Allahu.

Teuhidi është përqendrimi i miliarda njerëzve në një qendër dhe në një zë dhe nga kjo, lindin rregulla dhe emocione të përbashkëta.

Njeriu do të përqendrohet tek zëri, i cili tregon për ngjarje shumë të rëndësishme si: ardhja dhe ikja nga kjo botë, një zë që tregon një nga një çdo

gjë që ka lidhje me jetën tjetër. Ky është një zë që e qetëson mendjen dhe shpirtin e njeriut.

Një pasqyrim tjetër i teuhidit në jetën e myslimanit është ajo që e bën atë (myslimanin) të marrë pjesë në korin kozmik. Teuhidi me gjithë universin rrotullohen vazhdimisht në të njëjtën qendër tërheqjeje. Besimtari, i cili mendon dhe e di se i gjithë universi i përshtatet ligjeve të Allahut, e ndien veten si vëllai i universit, ndërsa njeriu i përkulet ligjeve të shkruara, të gjitha krijesat e tjera u përkulen ligjeve të cilat Allahu ka caktuar për natyrën. Megjithatë, edhe në trupin e njeriut ka pjesë, të cilat u përkulen ligjeve natyrore si, rrahjet e zemrës, lëvizja e gjakut etj. Njeriu nuk duhet t’i bindet vullnetit të vet, por vullnetit të Allahut dhe nga kjo sigurisht që do të lindë vëllazëria fetare. Kështu që, midis njeriut dhe natyrës (botës) ka një lidhje vëllazërore dhe jo një luftë e përgjakshme për mbijetesë ashtu sikur pretendon filozofia materialiste. Nëse e shikojmë nga pikëpamja Islame, vëmë re se midis njeriut dhe natyrës nuk ka asnjë lloj përplasjeje, por në të kundërtën, shohim një sakrificë vëllazërore. Bota dhe krijesat që ndodhen në të, i janë vënë në shërbim njeriut dhe kaq! Në të njëjtën kohë, kjo është një kompetencë e kufizuar që i është dhënë njeriut, sepse, njeriu nuk është zoti i të gjitha këtyre krijesave, madje as edhe i trupit të tij, por veçse një ruajtës amaneti dhe patjetër që ruajtësi i amanetit duhet të jetë i sigurt (që e mban amanetin). Më i rëndësishëm është vullneti i Atij që jep amanetin.

Teuhid do të thotë, të dalësh prej moçalishtes së shumësit dhe të futesh në ujërat e qarta dhe të ëmbla të njësimit.

Teuhid do të thotë, qartësim i të vërtetave, metodave dhe rrugëve.

Teuhid do të thotë, të ecësh me hapa të sigurt në këtë botë.

Teuhid do të thotë, të përqafosh universin me një emocion të pasqor, të cilin na e ka futur në zemër zotëria i tij (universit).

Teuhidi do të thotë, të shohësh botën e ngurtë dhe të ngushtë materiale nga majat e larta dhe madhështore të shpirtit.

Teuhid do të thotë të refuzosh shndërrimin në një qënie mekanike dhe të qëndrosh në rrugën e të qenit njerëzor.

Të gjitha krijesat iu bindën me dëshirë thirrjes së Allahut, gjithashtu edhe një pjesë e njerëzve, mirëpo, iblisi dhe shumica e njerëzve nuk morën pjesë në korin e teuhidit, madje nuk u mjaftuan me kaq, por u munduan ta sabotonin atë.

Sa guxim i çmendur!



— Neslihan Nur Turk —

A nuk është kjo humbja jote më e madhe? Ti nuk mund të gjesh kohë, për shkak të ankesave dhe, në këtë mënyrë, nuk mund të falënderosh. Por, nëse do ta falënderoje Zotin, nuk do të kishe kohë për asgjë tjetër. Prandaj, falëndero! Falëndero Allahun Teala që të bëri umet të Muhamedit, sallallahu alejhi ve sellem, i cili, me çdo gjendje të tij, është shembulli më i përkryer për njerëzinë.

Allahu të fali imanin dhe Islamin. Të dha fuqi për ta adhuruar atë dhe mëshirë për të bërë të mira. Ndërsa, përpara disa ditësh ti ankoheshe “për shkak se nuk kishe një fëmijë”, edhe pse të ka dhënë gjithë ato të mira.

Allahu të formoi ty nga një pikë e vogël. Të bëri të qeshësh kur ishe foshnjë. Të bëri të ulesh, të ecësh dhe të rritesh. Krijoi shkaqet për t’u realizuar këto. Prindërit dhe ata që të donin, i stolisi me dhembshuri. Ndërkohë që ti nuk dije asgjë rreth botës, ajo rrotullohej rreth teje. Ishe fëmijë, u bërë i ri dhe u rrite. Tani ndoshta je i moshuar apo pret të plakësh...

Sa herë që ke parë pasqyrën në çdo periudhë dhe gjendje, ke pasur një fytyrë për të parë. Allahu i Madhëruar të ka dhënë vetullat, sytë, hundën, nofullën, veshët dhe faqet. Ndërkohë që këtë mëngjes duhej ta falënderoje Allahun (xh. xh.), për këto, ti shqetësohesh për një puçërr të vogël që të ka dalë në faqe.

Ai të dha gjuhë. Të mësoi si të shprehësh hallin tënd. Të mori uria. Qave dhe të erdhi qumështi. Qeshe, u kënaqe dhe të erdhi buzëqeshja. Përballë ke pasur gjithmonë një bashkëbisedues. Shumicën e kohës që ke thënë se je vetëm, ke pasur pranë dikë. Ndoshta nuk e ke ndjerë, por edhe kur nuk ke pasur asnjë, ke pasur Allahun. Në fakt, asnjë çast nuk ke qenë vetëm. Të ka mbrojtur, të ka vëzhguar, të ka ushqyer dhe të ka dashur. Edhe për këtë, ka krijuar shkaqe.

Ai të ka vëzhguar edhe në momente kur je mër-zitur e ke qarë, kur ke rënë në neglizhencë dhe ke bërë gabime. Të fshehtën tënde nuk ia tregoi askujt, përveç atë që ka qenë në të mirën tënde.

Ushqimet që t'i bëri kësмет për sofrën tënde, i përtype me dhëmballët që të ka dhënë. Ëmbëlsinë e mirësive e shijove me gjuhën që të ka dhënë. Shpesh herë ke harruar, por bukën e ke zbutur me ndihmën e pështymës që ka krijuar ai.

Të ka dhënë një fyt, me anë të të cilit e gëlltit ushqimin. Të ka dhënë një stomak funksionues dhe e ke tretur atë. Të ka dhënë veshka e zorrë të shëndosha dhe e nxore jashtë trupit tënd tepriçën e ushqimit. Ndërkohë që çdo muskul, i cili punon dhe çdo qelizë që shërben duhet të jetë shkak për ta falënderuar Allahun Teala.

Të dha flokët fije fije që ti i kreh dhe u jep formë. Ndërkohë ata të zbukurojnë. Ke një lëkurë të bukur e të mbrojtur nga plagët dhe sëmundjet. Të ka dhënë thonj të shëndetshëm. Këmbët e tua mund të ecin. Krahët të zgjaten. Gjunjët dhe kyçet, mund të përthyhen. Gishtat e kyçet i ke pa mangësi dhe bërrylat nuk të dhembën. Ke një hundë që nuhat dhe një sistem nervor të mrekullueshëm që të mundëson të ndjesh të mirën duke u ndikuar nga e bukura.

Ke gjak që qarkullon. Ke mendje që të përzihet. Ke zemër që punon. Ndërkohë që ke gjithë ato mirësi, të cilat i zotëron pa dhënë asnjë mundim dhe pa paguar asnjë çmim, ti dje, me pretekstin se nuk ke një shtëpi më të madhe, ankoheshe për mysafirët që të erdhën.

Përsëri ti i bëre këto, edhe pse të ka dhënë mbulesë mbrojtëse për sytë, virtyt për fjalët, dashuri dhe vizion. Mbi të gjitha, të është bërë kësмет namazi. Ti je njeri, madje mysliman. Allahu ta ka dhënë këtë përsosmëri. Nuk të krijoi mace. Ti nuk e kërkon ushqimin tënd nëpër koshat e plehrave. Shumë njerëz, në të njëjtën kohë, e nxjerrin ushqimin e tyre nga mbeturinat. Zoti nuk të krijoi qen. Ti nuk fle nëpër rrugë. Shumë njerëz, në të njëjtën kohë, flenë nëpër rrugë. Je në pëllëmbë të dorës. Shumë vëllezër të tu, në të njëjtën kohë, shtypen nën këmbët e tiranëve. Allahu ta vendosi emrin “krijesa më fisnike”.

Krijuesi të tha “mëkëmbësi im”.¹ Veshët të dëgjojnë, sytë të shikojnë dhe zemra të ndjen. Në të njëjtën kohë, shumë të tjerë si ti janë krijuar “bel hum edal”.² Ndërkohë që mund t'i shtosh mirësitë duke e falënderuar Allahun Teala, ti ankohesh se nuk ke arritur kulmin dhe shumë gjëra të tjera. Ndërkohë që premtimi i Allahut është i qartë dhe shpërblimi për falënderimin është i

bollshëm,³ pak më parë ankoheshe se nuk ke fituar më shumë para.

Në anën tjetër, ka robër që falënderojnë edhe për vështirësitë. Ka robër të devotshëm që falënderojnë edhe për varfërinë. Ata e pranuan të mirë çdo gjë që u vinte nga ai. Në çdo gjë që u ndodhte, panë mirësi. Ata e pranuan për mirësi atë që u jepej dhe atë që nuk u jepej. Falëndero Zotin! Ty nuk të kanë ndodhur fatkeqësi më të mëdha!

Ndërkohë që ti e kthen mirësinë në fatkeqësi me vesveset e tua, ka shumë robër që e kthejnë fatkeqësinë në mirësi duke menduar mirë për Zotin. Ka shumë robër që janë të kënaqur me urinë dhe sëmundjen, ndërkohë që ti nuk kënaqesh me tejngopjen dhe shëndetin...

Mos u habit nesër, nëse vonohet hyrja jote në xhenet. Falënderoje atë që të ka lajmëruar për këto që të mos ndodhë kjo vonesë dhe të bëhesh prej atyre që arrijnë rehatinë e përhershme. Mos u fut te mosmirënjohësit që janë shumë, por futu te falënderuesit që janë pak.⁴ Nuk e di. Shumë njerëz kanë një sëmundje prej së cilës nuk mund ta ndjejnë të ngrohtit. Për këtë arsye, nuk mund ta kuptojnë edhe nëse u digjet lëkura. Ata e kuptojnë se janë djegur, kur nuhasin erën e mishit të djegur. Ndërkohë që duhet të falënderosh për trupin tënd që ndjen, verën e kaluar ankoheshe se koha ishte shumë e nxehtë.

Po ashtu, Zoti bëri që të flasin edhe gurët, në mënyrë që të kuptosh. Duhet të mendosh apo jo? Guri ametist është një gur i thjeshtë për atë që e shikon nga jashtë, por ai e ka të fshehur brenda fytyrën e tij shumë të bukur, për ata që e ndajnë atë me durim dhe besim.

Çdo gjë pret me mallëngjim njeriun që ta perceptojë urtësinë e saj. Duhet të mendosh apo jo? Përse Hizri e shpoi anijen? Përse e ngriti murin? Përse e goditi fëmijën?⁵

Falënderim i vërtetë, nuk është ai falënderim që bëhet vetëm kundrejt mirësive, por ai që bëhet edhe kundrejt vështirësive, sepse vështirësia nganjëherë të mbron nga fatkeqësi më të mëdha dhe nganjëherë të shpie te mirësi të reja më të mëdha. Mbi të gjitha, falënderimi kundrejt Allahut është falënderim për shkakun! Është perceptim i mirësisë që ndodhet në brendësi të ngjarjeve, sido që të jenë në aparençë dhe përkujtim i asaj

1. (el-Bakara 30.)

2. (el-A'raf 179.)

3. (el-Fatir 30.)

4. (en-Neml 73.)

5. (el-Kehf 82.)

që ke perceptuar. Ne nuk duhet të kënaqemi vetëm me atë që na jep, por edhe me atë që nuk na jep. Ndërkohë që duhet të veprojmë kështu, më parë ti ankoheshe se poshtë vetullës, ke syrin.

Je në të drejtë dhe mërzitësh se nuk mund ta marrësh të drejtën tënde. Falëndero! A është më mirë sikur të ishte ti i padrejti? Brengosesh se të ka ikur namazi. Falëndero! A do të ishte më mirë sikur të mos e kishe një hall të tillë? Falëndero për plagët dhe dhimbjet, që gjithmonë të bëjnë të thuash: “Aman o Zot!” A do të ishte më mirë sikur të ishte prej neglizhentëve që nuk kanë plagë?

Falëndero për varfërinë tënde! A do të ishte më mirë sikur të ishte prej të pasurve koprracë? Lëre tani, mos e shiko si fëmijë akulloren që e ka dikush në dorë dhe po e lëpin! Falëndero për bukën që ke në dorën tënde! Kujto, sepse po harron shumë shpesh: ka shumë njerëz të përmalluar për atë copë buke që ke. Për hir të Allahut, mendo! Ndërkohë që shumë njerëz nuk kanë shtëpi për t’u ngrohur, dimrin e kaluar, ti ankoheshe për shkak se shtëpia jote nuk ngrohej mirë.

Falëndero në çdo lloj gjendjeje! Edhe kur të të gurëzojnë, më së paku ka dy shkaqe për të falënderuar: Nëse i ke merituar ata gurë, falëndero që ke njerëz besimtarë që të urrejnë për këtë. Nëse nuk i ke merituar, falëndero për shkak se të pastrojnë dhe të afrojnë te Allahu me anë të atyre torturave që të bëjnë t’i vuash! Mos u mërzit nga të mjaftuarit me atë që ke. Falëndero dhe gëzohu! Gëzohu dhe zbukurohu! Ndërkohë që zbukurohesh, përsëri falëndero! Kuptoje se asnjëherë nuk mund ta falënderosh Zotin aq sa duhet dhe përsëri falëndero!

Falëndero në çdo lloj gjendjeje! Edhe kur të të gurëzojnë, më së paku ka dy shkaqe për të falënderuar: Nëse i ke merituar ata gurë, falëndero që ke njerëz besimtarë që të urrejnë për këtë. Nëse nuk i ke merituar, falëndero për shkak se të pastrojnë dhe të afrojnë te Allahu me anë të atyre torturave që të bëjnë t’i vuash! Mos u mërzit nga të mjaftuarit me atë që ke. Falëndero dhe gëzohu! Gëzohu dhe zbukurohu! Ndërkohë që zbukurohesh, përsëri falëndero! Kuptoje se asnjëherë nuk mund ta falënderosh Zotin aq sa duhet dhe përsëri falëndero!

Istigfari

orientim dhe përtëritje

— M. Lutfi Arslan —

Meka u çlirua dhe komandanti fitimtar hyri në qytet në mënyrën më modeste, duke bërë istigfar dhe falënderuar Allahun: **“Kur të vijë ndihma e Allahut dhe çlirimi i Mekës e t’i shohësh njerëzit duke hyrë në fenë e Allahut grupe-grupe, atëherë madhëroje me falënderim Zotin tënd dhe kërko falje nga Ai, se Ai është vërtet Pranues i madh i pendimeve.”** (En-Nasr)

Pejgamberit fitimtar dhe triumfues i tregohet adresa e istigfarit. Qëndrimi që duhet të mbajmë në çdo sukses është përcaktuar në mënyrë të qartë. Do të bëjmë istigfar, sepse kjo është metoda e Pejgamberit (a.s.). Këtë kërkoi Allahu prej të Dërguarit të Tij, kur i dhuroi fitore dhe ndihmë në çlirimin e Mekës, sepse çdo fitore, mirësi dhe sukses është prej Allahut. Ne nuk mund të arrijmë përfundime të suksesshme me vullnetin dhe zgjedhjen tonë. Allahu na dhuron sukses dhe kërkon nga ne të biem në istigfar, në mënyrë që të shmangim mburrjen dhe mendjemadhësinë që mund të vijë prej suksesit.

Istigfari është përuļje dhe orientim drejt tevhidit, sepse aktet, veprimet dhe punët i dorëzon në adresën e saktë. Istigfari është energji për t’u bërë qëndresë sulmeve të shejtanit dhe egos.

Istigfari është vullneti për të qëndruar i pastër gjatë gjithë jetës. Ne kemi ardhur në këtë botë të

pastër dhe duhet të largohemi nga kjo botë të pastër. Detyra jonë e vërtetë është të largohemi nga kjo botë ashtu siç kemi ardhur dhe istigfari është ushqimi i domosdoshëm në këtë rrugë. Në çdo istigfar shpresojmë të hapen dyert e qiellit. Gjatë istigfarit, zemrat tona ndrijnë nga shkëlqimi; e shkuara, e tashmja dhe e ardhmja bashkohen në një pikë të vetme. Në atë pikë strehojmë jetën, sevapet dhe mëkatet tona. Në atë pikë hapet një dritare, prej së cilës dalin rreze të shpëtimit të përjetshëm, ajo dritë ndriçon jetën tonë, sevapet dhe mëkatet tona, Çdo istigfar bëhet dritë, e cila mbush zemrën tonë. Sa herë që mbajmë distancë nga istigfari, krijohet një boshllëk i madh midis nesh dhe të tjerëve. Kjo distancë zgjerohet aq shumë, saqë e shkuara, e tashmja dhe e ardhmja ndahen nga njëra-tjetra. E shkuara mbushet me pishmanllëk, e tashmja me gaflet, kurse e ardhmja me dëshpërim. Pa istigfar ne dalim nga të qenit vetvetja. Istigfari është një gjendje drithëruese. Nuk jemi të sigurt se çfarë jemi, çfarë do të bëhemi, deri sa të dëgjojmë thirrjen **“Bashkohu me robërit e mi dhe hyr në Xhenetin Tim.”** (El-Fexhr, 29-30.) Prandaj jemi të detyruar të bëjmë vazhdimisht istigfar, sepse në sajë të tij mund të na falen të gjitha mëkatet, por këtë garanci nuk mund të na e tregojë kush në këtë botë. Duhet të jemi vigjilentë dhe syhapur; vigjilenca duhet mbajtur e freskët me istigfar.

Njëherë, Aliu (r.a.) u pyet:

- Kemi bërë mëkat, çfarë duhet të bëjmë?
- Bëni istigfar.
- Bëmë istigfar, por përsëri bëmë mëkat.
- Përsëri bëni istigfar.
- Për sa kohë duhet të vazhdojmë me istigfar?
- Vazhdojeni istigfarin, deri sa shejtani të mundet dhe të presë shpresën e fitores ndaj jush.

Ne vazhdimisht bëjmë istigfar për mëkatet e bëra...

Bëjmë istigfar, ngaqë nuk jemi të sigurt për gjendjen në të cilën ndodhemi...

Bëjmë istigfar, sepse nuk e dimë të ardhmen që na pret...

Istigfari është vigjilenca jonë, është shkundja nga gjynahet. Ne duhet t'i shohim mëkatet si male të cilët po shemben mbi ne.

Abdullah ibn Mes'udi transmeton: *"Besimtari i shikon mëkatet si një mal, i cili është duke rënë mbi të, kurse keqbërësi i shikon si një mizë në hundën e tij, të cilën e largon tej me dorë."*

Besimtari kërkon falje prej Allahut, kur mërzi-tet dhe kur gëzohet. Besimtari duhet ta mbajë të njomur zemrën gjithmonë me istigfar. Vepërmirët e kanë kaluar gjithë jetën duke i kërkuar falje Allahut. Kjo është sjellje e atyre që duan të ndahen nga kjo botë të pastër ashtu siç kanë ardhur. Ne duhet ta bëjmë istigfarin mënyrë jetese. Ta bësh istigfarin mënyrë jetese, nuk do të thotë të jetosh me ndjenjën e pendimit, por të jetosh me ndjenjën e vigjilencës. Vigjilenca është vëmendje e kujdes për t'u ruajtur nga një rrezik, nga një veprim i dëmshëm apo një veprimtari armiqësore. Vigjilenca është një vëmendje ndaj anëve të errëta të nefsit tonë. Duhet të jemi shumë të kujdesshëm në këtë botë kalimtare, në të cilën jemi dërguar për t'u sprovuar. Me ndihmën e istigfarit armiku nuk mund të na bëjë asgjë.

Bajezid Bistani takoi një mjek, i cili po përgatiste ilaçe:

- Doktor! A ke ilaç për sëmundjen time?

Doktori e pyeti:

- Çfarë sëmundjeje ke?
- Sëmundjen e mëkatëve... u përgjigj.
- Unë nuk e di ilaçin e kësaj sëmundjeje i tha mjeku.

Në ato momente ndërhyr një i ri, i cili njihej si i çmendur, duke i thënë Bistanit: "E di unë ilaçin e sëmundjes tënde."

Bajezid Bistani gjithë gëzim, i thotë: "Tregomë."

I riu, i cili konsiderohej si i çmendur nga njerëzit, por që në të vërtetë ishte një njeri i urtë, e përkufizoi kështu ilaçin e mëkatit:

- Merr dhjetë dirhem rrënjë istigfari dhe dhjetë dirhem gjethe istigfari. Këto vendosi në havanin e zemrës dhe rrihi me tokmakun e istigfarit! Kaloji nëpër sitën e mëshirës dhe mbruji me lot dhe në fund piqi në furrën e dashurisë. Nga produkti i formuar, merr çdo ditë nga pesë lugë dhe do të shërohesh plotësisht.

Bajezid Bistani, pasi dëgjoi këto fjalë, mori frymë thellë dhe tha:


Medet për ata që e pandehin veten të mençur, duke e konsideruar një të urtë si të çmendur.

Çfarë mund t'i bëjnë armiq të një personi që e kujton mëngjesaksham këtë shprehje.

Përmes istigfarit rregullojmë jetën. Istigfari shërben si ekulibër dhe rregullator i mënyrës së jetës sonë.

"O Allah, Ti je Zoti im, nuk ka të adhuroar përveç Teje. Ti më ke krijuar dhe unë jam robi yt, do të qëndroj besnik në marrëveshjen dhe premtimin që kam bërë ndaj Teje sa të kem mundësi. Kërkoj mbrojtjen Tënde nga e keqja që kam bërë. Unë jam mirënjohës për mirësitë e Tua, i pranoj mëkatet e mia, të lutem më fal, sepse nuk i fal mëkatet askush tjetër përveç Teje". (Buhariu)

Përmes istigfarit i japim drejtim dhe ekulibrim jetës sonë në këtë botë.





Pse je i mërzitur?

Sait Çamllëxha

Je penduar 200 vite sa Ademi?

Apo je hedhur në zjarr si Ibrahim?

Je prerë me sharrë si Zekerija?

A mos vallë je hedhur në pus si Jusuf?

Apo je gjuajtur me gurë, të kanë hedhur të brendshmet e kafshëve kur po falje namaz, je pështyrë në fytyrë, je detyruar të shpërngulesh, je ndarë nga të dashurit, si Muhamedi?

Pse je i mërzitur?

Të është prerë hunda e veshët sikurse Hamzait?

Të janë prerë krahët sikurse të Musab Bin Umejrit?

Je plagosur me shigjetë, shtizë e shpatë sikurse Xhafer Bin Ebi Talibi?

Je torturuar sikurse Amari, Thumejeja, Jasiri (r.ahm)?

Të kanë shtrirë mbi rërën përvëluese dhe kanë vënë shkëmbinj mbi ty, sikurse Bilal Habeshiut (r.a.) ?

Të kanë hedhur në det sikurse Junusin (a.s.)?

Apo të kanë mbuluar plagët tërë trupin sikurse Eju-pit?

Çfarë po mendon, për problemet e dynjasë?!

Nëse do të mërzitesh, mërzitu pse e ke lënë namazin për kaza, që nuk u çove për namaz nate, që ia ke thyer zemrën dikujt, që nuk ke agjëruar të hënave dhe të enjteve...

Nëse do të mërzitesh, mërzitu pse sot nuk ke bërë vepër për hir të Zotit, mërzitu pse nuk i ke kënaqur Allahun dhe të Dërguarin e Tij...

Mërzitu për vëllezërit e tu të besimit, që po dhunohen dhe po vriten barbarisht në Palestinë, Burma, Siri dhe në të katër anët e botës...

Nëse do të mërzitesh, mërzitu pse nuk ke ndihmuar të vëfrit, pse nuk ke përkrahur jetimët...

Nëse do të mërzitesh, mërzitu për njerëzit që po luftojnë me skamjen dhe vdekjen në Afrikë apo në vende të tjera...

Nëse do të mërzitesh, mërzitu pse nuk e ke lexuar sa duhet Kuranin dhe pse nuk e ke zbatuar atë...

Nëse do të mërzitesh, mërzitu pse nuk e ke dashur Pejgamberin më shumë se pasurinë tënde, shpirtin tënd, pjesëtarët e familjes tënde dhe se gjithçka tjetër...

Nëse do të mërzitesh, mërzitu pse nuk je bërë në kuptimin e vërtetë të fjalës rob i Zotit, dhe pse nuk je bërë ymet i Pejgamberit...

Nëse do të mërzitesh, mërzitu nga frika se mund të të mos ndërmjetësojë Pejgamberi...

Ndoshta ke shumë halle...

Ndoshta thua me vete: "Mjaft më!"...

Ndoshta je edhe duke qarë...

Ndoshta je duke menduar nëse do të përfitosh ndonjë gjë nga fundi i atyre fatkeqësive që të kanë katandisur...

Dëgjo! Zoti yt, ty po të drejtohet:

"Vetëm ata që janë të durueshëm, do të shpërblehen pamasë." (Zumer, 10.)

Ndoshta je duke menduar, se pse Zoti pikërisht të ka zgjedhur ty që t'i përjetosh këto...

Në fakt, ata që i zgjedh Zoti janë të rëndësishëm:

"Ne do t'ju vëmë në sprovë ju, derisa t'i njohim ata midis jush, që luftojnë (në rrugën e drejtë) dhe durojnë." (Muhamed, 31.)

Në fakt, duhet të mërzitesh nëse nuk ke shqetësime!

Nëse je i shqetësuar, dije që ai të do...

Ja se ç'thotë ai që të do:

"Zoti fut në shqetësime njeriun, të cilit i do mirën."

(Hadith)

Ndoshta ti nuk ke vuajtur sa As'habi Uhdudi... Kur mbreti i tyre i pati hedhur në greminë të ndezuar me zjarr, vetëm pse kishin besuar...

Ndoshta ti nuk ke vuajtur sa Ebu Dheri (r.a.)... Xhaxhai i tij e pati mbështjellur me rrogos dhe e pati djegur, vetëm pse kishte besuar...

Ndoshta ti nuk ke vuajtur sa Vahshiu (r.a.), i dashuri i tij (Profeti), i pati thënë "mos m'u duk përpara"...

Ndoshta ti nuk ke vuajtur sa Jakupi (a.s.)... I qe marrë nga duart Jusufi (a.s.)...

Ndoshta ti nuk ke vuajtur sa Hatixheja (r.a.)... Ia patën dëbuar nga shtëpia Muhamedin (s.a.s.)...

Mos harro! Zoti nuk e ngarkon njeriun më tepër sesa ai mund ta përballojë...

Ndoshta zemra të vuan...

Ndoshta trupi...

Ndoshta është shpirti, ai që përpëlitet...

Ndoshta është vetmia, ajo që ty të ka mbështjellë...

Ndoshta një mijë e një të panjohura...

Në çfarëdolloj gjendjeje qofsh,

Një lutje që t'i shkon gjuhës tënde mbaje gjithnjë:

"La ilahe il-la ente subhaneke inni kuntu minedh-dhalimin!"

Zoti im, më fal gjithçka kam bërë, që Ty nuk të pëlqen.

Nuk ka zot tjetër përveç Teje!

Ti je larg çdo të mete.

Vërtet, unë i bëra keq vetes sime.

Mëshiromë!

Zoti im! Nuk ka zot tjetër përveç Teje!

"Allahu ju manifeston argumentet; se Allahu është i Urtë, i Gjithëdijshëm." (Nur, 18.)

AKOMA NË GJUMË

Muhamed El-Gazali

Pasi mbajta një bisedë përpara një auditori të madh, prita të dëgjoj pyetjet e njerëzve dhe çfarë kisha ndikuar tek ata. Mendova se pyetjet do të ishin rreth konfliktit të Gjirit Persik, sepse edhe fjala ime ishte për njërin prej qyteteve të Gjirit; për situatën tepër të dhimbshme të saj dhe ndikimet që la pas, të cilat tejkaluan vendet pjesëmarrëse, duke u shpërndarë në të gjithë popullatën islame kudo në çdo vend.

Por pyetja që më befasoi ishte në një drejtim tjetër dhe numri i atyre që pyetën ishte i madh, saqë ishte e pamundur t'i anashkaloja.

Njerëzit më pyetën: “A e dinë shpirtat se si jemi ne? Dhe, të vdekurit tanë prej të afërmeve dhe miqve a na i shikojnë punët tona dhe a kërkojnë falje për gjynahet tona?...”

U vonova në përgjigje duke urryer pyetjen dhe pyetësit. Njerëzit janë të zënë me çfarë ka pas materies dhe jo me vetë materien; janë të zënë me botën e padukshme dhe jo me botën e dukshme. Sikur ata të kenë përfunduar çështjet e prekshe dhe tani nuk u ka mbetur gjë tjetër, përveçse të merren me çështje të tjera...!!

Duke u rënë tërthorazi atyre thashë: “Në qoftë se juve ju preokupon kërkimi i faljes për gjynahet, atëherë melekët, siç thotë Kurani, kërkojnë falje për ju: *“Zoti ynë, çdo gjë e ke përfshirë me mëshirë dhe dituri; falu gjynahet atyre që janë penduar dhe pasuan rrugën Tënde.”* (Gafir, 7) Madje, puna është edhe më e madhe se kaq, sepse **“krijesat më të larta – meleul eala”** i vështrojnë banorët e pafat të këtij planeti që bëjnë gjynahe dhe shpresojnë te Mëshiruesi që ata t'i falë: *“Qiejt atje lart gati sa nuk pëlçasin dhe melekët i bëjnë tesbih (lavdërojnë), duke falënderuar Zotin e tyre dhe kërkojnë falje për ata që janë në Tokë.”* (Shura, 5)

Pyetësit thanë: “Këtë e dimë dhe nuk po të pyesim për të. Ne po ju pyesim për Pejgamberin tonë, njerëzit e mirë të këtij umeti, për familjarët dhe të afërmit tanë të mirë. A janë ata të gjallë dhe a e dinë gjendjen tonë? A interesohen për punët tona dhe a bëjnë lutje për ne?”

Përsëri u zura ngushtë me këtë pyetje të urryer dhe u thashë se ata janë të gjallë, për këtë nuk ka aspak dyshim! Por, ata janë të gjallë te Zoti i tyre, ndërsa a janë ata që interesohen dhe shqetësohen për punët tona, çfarë kemi bërë dhe çfarë kemi lënë pa bërë **“Çdo njeri është peng i asaj që ka punuar”** (Tur, 3)

Njerëzit në dynja nuk e dinin të fshehtë (gajbin),

as që do ta dinë atë pas vdekjes së tyre dhe nuk do ta dinë përfundimin e njerëzve të tjerë, përveçse kur ata do të kalojnë pranë tyre në botën tjetër. Prandaj është më mirë për ju, o popullatë myslimane, të rregulloni veten, t'u përvisheni punëve tuaja dhe të drejtoheni nga kënaqësia e Zotit, në vend që të merreni me këtë çështje, e cila nuk ju intereson.

Në këtë moment, u ngrit një fetar, shejkh me bindje të fortë në veten e tij, duke thënë: “Bile, shpirtat e dinë se në çfarë gjendjeje jemi dhe na vështrojnë neve; dhe i pari prej këtyre shpirtave është i Dërguari më i madh, i cili ka thënë: ‘Jeta ime është më e mirë për ju dhe vdekja ime është më e mirë për ju. Punët tuaja më shfaqen mua dhe kur ju shoh ndonjë të keqe, i kërkoj Allahut falje për ju’”; në librin *Er-Rruh – Shpirti të Ibnul Kajimit* ka shumë argumente në lidhje me këtë që po them.

Edhe një herë tjetër më shikoje se si rrëshqisja në një debat shterpë të atij lloji që e urrej. Por pa-tjetër duhet të sqaroj, prandaj i drejtohem shejkhut kundërshtues: “Në hadithin e saktë ka ardhur se **disa njerëz prej shokëve të të Dërguarit të Allahut, të afërm të tij, tërhiqen larg nga ai, në Ditën e Llogarisë, ndërsa ai thotë: «Shokët e mi, shokët e mi; ku po i çoni shokët e mi?»**, i thuhet: **«Ti nuk e di se çfarë kanë bërë pas teje?»**” Ky tekst tregon se ai nuk e di gjendjen e njerëzve më të afërm të tij, ndërsa hadithi yt, të cilin e përmende, nuk vlen asgjë. Libri “Er-Rruh – Shpirti”, i Ibnul Kajimit, po qe se do të vërtetohej se është i tij, është libër opinionesh dhe tregimesh, prej të cilit nuk ndërtohet ndonjë gjykim fetar.

Filloi zhurma, të cilën e kisha frikë, sepse fetari, shejkh dhe grupi i tij nuk e pëlqyen thënien time. Nuk më shqetësoi mospëlqimi i tyre, por ajo që më shqetësoi është fakti se njerëzit janë në një luginë dhe ne jemi në një luginë tjetër; debatojnë për çështje në të cilat nuk ka dobi dhe as nuk kanë përgjegjësi për to, pastaj ndahemi për shkak të tyre të konfliktuar, në kohën që armiqtë e Islamit përpiqen ta zhdukin atë së bashku me umetin e tij.

Ngjarje e ndodhi të mëdha kanë kaluar për ne, të cilat duhet të na kishin zgjuar nga gjumi dhe të na e kishin prishur qetësinë e pavëmendjes. Por, siç duket, sëmundjet e vjetra akoma vazhdojnë të na shkatërrojnë e të na konfliktojnë njëri me tjetrin, duke bërë që disa njerëz të luftojnë për shkak se nuk lejohet që edhe një qime e vetme të hiqet prej mjekrës; ndërsa harrojnë dredhitë e mastrimet që tundin e lëkundin shtetet e njerëzimit.

Antibiotikë që nuk skadojnë

Vjeshta ka shtrirë këmbët edhe pse dielli në këto ditë të bën të mendosh se je në pranverë, por njerëzit që kolliten, teshtijnë dhe që nuk duken në punë se janë sëmurë, tregojnë se ka filluar stina e ftohtë. Është një realitet i trishtë që muajt e ftohtë bashkohen me të ftohtët e gripin, por është një fakt.

Madje edhe më të fiksuarit ndaj higjienës dhe dezinfektantëve të duarve nuk i shpëtojnë dot virozave. Mundësia për t'u sëmurë varet më shumë nga gjendja juaj shëndetësore sesa nga sa herë i lani duart apo i dezinfektoni, por kjo s'do të thotë që s'duhet të bëni kujdes ndaj ambientit.

Kur vjen puna për t'u mbrojtur nga sëmundjet kujdesi nuk është asnjëherë i tepërt.

Nëse plani juaj për të mos u sëmurë këtë vjeshtë fillon dhe mbaron me të konsumuarit të një gote më shumë lëng portokalli, ndoshta bëni mirë ta rimendoni këtë strategji.

Çaji mbetet ilaçi kryesor për të gjithë, por cili çaj funksionon më mirë?

ÇAJI I MALIT

Të gjithë e kemi shijuar çajin e malit, një tisanë unike e shumë e shëndetshme, thesari i paçmuar nga i cili mund të përfitohet, jo vetëm duke e konsumuar.

Çaji i malit është një bimë e egër, që rritet në lindje të Mesdheut, veçanërisht në Ballkan.

Ashtu siç edhe emri e tregon më së miri, në male në lartësi që variojnë nga 1500 deri në 1900 metra, shpesh herë në sipërfaqe shkëmbore.

Të huajt mbarojnë për çajin tone të malit, ndërsa shqiptarë janë mësuar me të dhe drejtohen shpesh ndaj çajrave të botës.

ÇAJI I MENTES

Ky çaj lehtëson dhimbjet dhe problemet e ndryshme të stomakut dhe ndihmon procesin e tretjes.

Lehtëson të përzierat dhe çrregullimet e spazmave, forcon sistemin imunitar ndaj gripit dhe lehtëson problemet në frymëmarrje.

Eliminon aromën e keqe të gojës dhe ndihmon në ekuilibrimin e oreksit.

ÇAJI I XHENXHEFILIT OSE XHINXHER

Përmban nivele të larta të vitaminës C, magnezit dhe mineraleve të tjera. Një kupë çaji para udhëtimit, parandalon të përzierat nëse ju zë makina.

Përmirëson performancën e stomakut në tretje dhe uron problemet e ndryshme në sistemin e frymëmarrjes duke nisur nga ftohja deri te alergjitë e ndryshme.

Përmirëson qarkullimin e gjakut dhe lehtëson dhimbjet e ciklit menstrual dhe qetëson muskujt.

Për shkak të nivelit të lartë të antioksidantëve, forcon sistemin imunitar dhe ndihmon në çlirimin e stresit dhe qetësimin e sistemit nervor.

ÇAJI JESHIL

Çaji i gjelbër përmban përbërje bioaktive që përmirësojnë shumë parametra të shëndetit të njeriut.

Përbërësit e çajit të gjelbër përmirësojnë funksionin e trurit dhe rrisin nivelin e djegies së yndyrave duke përmirësuar performancën fizike.

Në moshë të thyer, çaji i gjelbër ul riskun e Alzheimerit dhe Parkinsonit. Çaji i gjelbër vret bakteret duke ndihmuar në shëndetin e dhëmbëve dhe uljen e riskut për infeksione.



Lëngu i gjetheve të ullirit

SHËNDET DIREKT NGA NATYRA

Përdorimi i çajit të gjetheve të ullirit e ka origjinën e përdorimit tek Hipokrati, babai i mjekësisë. Studimet bashkëkohore vërtetojnë se gjethet e ullinjve janë plot përbërës kundër viruseve dhe mikro-organizmave të dëmshëm.

Ato arrijnë të ndikojnë në organizëm më fuqishëm se shumë prej antibiotikëve të farmacive. Lëngu i përftuar nga zierja e gjetheve të gjelbra të ullirit ofron veti dhe efekte mirëbërëse në organizëm. Ai ndihmon për të parandaluar një sërë shqetësimesh dhe sëmundjesh të ndryshme.

Këtu mund të përmendim disa tipe gripi, infeksione virale të mushkërive, por edhe goditje më të rënda shëndetësore. Të tilla mund të përmendim sëmundje si tuberkulozi, meningjiti, hepatiti B, dhe bronkopneumonitë serioze.

Lëngu i gjetheve të ullirit arrin të bëjë mrekulli edhe ndaj infeksioneve. Këtu vlen të përmendim vlerat e forta kundër infeksioneve në traktin urinar, por edhe te infeksionet post-kirurgjikale.

Përbërësit aktivë dhe esencialë të gjetheve të ullinjve fuqizojnë sistemin e imunitetit, rrisin energjinë dhe luftojnë mikrobet e parazitët.

Një efekt surprizë i këtij çaji është aftësia për të normalizuar tensionin e lartë të gjakut. Madje arrin edhe të ekuilibrojë nivelin e sheqerit në gjak, ndaj këshillohet fort për diabetikët.

Gjethet e ullirit përmbajnë një antioksidues shumë të fuqishëm që quhet taninë dhe që i jep gjetheve një shije të hidhur. Gjethet kanë veti rrudhëse, tonike dhe kundër temperaturës së lartë.

Lëngu i gjetheve të ullirit përdoret me rezultate shumë të mira kundër arteriosklerozës dhe rasteve kur shfaqen sëmundje të shoqëruara me temperaturë të lartë.

Falë vetive diuretike që përmbajnë këto gjethe, çaji i tyre është një nga mjekimet më funksionale të mjekësisë popullore.


Si ta përgatisni Lëngun e Gjetheve të Ullirit

Për të përgatitur lëngun nga gjethet e ullirit, duhet të përdorni gjethet të thata, ose të njoma në kushtet e shtëpisë. Merrni një enë metalike, të cilën duhet ta mbushni me 300 ml ujë dhe ta vini të vlojë. Kur arrihet pika e vlimit, hidhni një sasi prej rreth 20 deri 25 gjethe të thara të ullirit.

Uji së bashku me gjethet duhet të vlojë sërish për 4-5 minuta dhe më pas hiqeni nga zjarri dhe lëreni të ftohet. Këshillohet që lëngun ta pini të ngrohtë pasi të shtoni lëng limoni dhe të tresni pak mjaltë.

Lëngu i gjetheve të ullirit ofron një shije mrekullisht të kënaqshme dhe të ëmbël, e cila e bën një zgjidhje që nuk duhet ta ndani nga vetja në çdo stinë. Tri gota në ditë janë një sasi e këshilluar nga specialistët.





SI TA DALLONI NËSE NJË BATERI ËSHTË E KONSUMUAR APO JO?

Tashmë, bateritë janë pjesë e pandashme e jetës sonë të përditshme. Ato i përdorim në shumë aparate elektronike, pajisje shtëpiake, e deri tek lodrat e fëmijëve. Kur vjen koha për t'i ndërruar ato, vështirë se do të mund të qëlloni se cila është ende e mbushur, e cila është harxhuar plotësisht. Pra, kontrollimi i tyre është pothuajse i pamundur, pasi që vetë pak njerëz i kanë pajisjet e duhura për ta bërë këtë në shtëpi.

Sidoqoftë, këtë problem mund ta harroni, duke aplikuar këtë metodë efektive për t'i kontrolluar bateritë tuaja:

E marrim baterinë dhe e lëshojmë nga një lartësi e vogël (7-8 cm). Bateria e pa konsumuar plotësisht do të qëndrojë në këmbë. Kurse ajo që është e konsumuar do të rrëzohet.

ZBULOHET PLANETI KU NJË VIT ZGJAT 20 DITË

Zbulimi i pazakontë i një planeti u realizua nga një ekip shkencëtarësh indianë. Është hera e parë që gjendet një planet që orbiton një yll shumë të ngjashëm me Diellin. Planeti është pagëzuar me emërtimin EPIC 211945201b ose K2-236b dhe është mjaft i madh, rreth 27 herë më i madh se Toka.

Ky zbulim e vendos Indinë mes vendeve të pakta që konfirmojnë ekzistencën e një planeti jashtë sistemit tonë diellor. Lokalizimi i ekzoplanetëve

nuk është një risi në ditët tona. Në fakt janë konfirmuar më shumë se 3700 të tillë, pjesa më e madhe janë zbuluar dhe konfirmuar nga teleskopi Kepler i Nasa-s. Kohët e fundit, ky planet u zbulua edhe nga Kepleri si një kandidat për planet, por ishte ekipi i shkencëtarëve indianë që konfirmuan ekzistencën e planetit dhe jo një kometë, apo ndonjë objekt astronomik.

Ekspertëve iu desh 1 vit e gjysmë në Observatorin

Gurushikhar të PRL-së në Mount Abu, Indi duke studiuar ndryshimet e dritës që vinin nga ylli i planetit dhe konfirmuan masën e tij. Planeti orbiton një yll të ngjashëm me Diellin, por është 7 herë më afër yllit të tij se Toka me Diellin, çka do të thotë se temperatura mund të shkojë 600 °C dhe madje shumë i nxehtë dhe i thatë për të pasur jetë.

Për pasojë një vit në këtë planet zgjat afërsisht 19.5 ditë. Ka një masë rreth 27 herë masën e tokës dhe vlerësohet se rrezja është 6 herë më e madhe.

Megjithatë të dhënat fotometrike të K2 nuk dhanë konfirmimin e natyrshëm planetar të këtij sistemi, kështu që një vlerësim i pavarur i masës ishte i nevojshëm për këtë zbulim që u realizua nga spektrografi PARAS. Edhe pse mundësitë e gjetjes së shenjave të jetës janë të pakta për K2-236b, astronomët sinjalizojnë se gjetja e tij është shumë domethënëse sepse ndihmon astronomët të gjejnë më shumë detaje sesi planetë të këtij lloji si Neptuni apo Saturni janë të aftë të formohen aq afër yllit të tyre.

KËTË VIT DO TË HYJË NË PËRDORIM RJETI 5G

Rrjetet 5G janë brezi i ardhshëm i lidhjes mobile në internet, duke ofruar shpejtësi më të shpejta dhe lidhje më të besueshme në telefonat e zgjuar dhe pajisje të tjera, si kurrë më parë.

Duke kombinuar teknologjinë e fundit të rrjetit dhe kërkimin më të fundit, 5G duhet të ofrojë lidhje që janë shumë më të shpejta se lidhjet aktuale, me shpejtësi mesatare shkarkimi prej rreth 1GBps që pritet të jenë së shpejti normë.

Rrjetet do të ndihmojnë një rritje të madhe në teknologjinë e Internetit të gjërave, duke siguruar infrastrukturën e nevojshme për të kryer shuma të mëdha të të dhënave dhe duke lejuar një botë më të zgjuar dhe më të lidhur.

Me zhvillimin e mirë, rrjetet 5G pritet të fillojnë në të gjithë botën deri në vitin 2020, duke punuar së bashku me teknologjinë ekzistuese 3G dhe 4G për të siguruar lidhje më të shpejta që mbeten në internet pa marrë parasysh se ku jeni.

MBETJE ORGANIKE NË MARS

Në fillim të javës NASA doli me një deklaratë se në ditët në vijim do të publikonte informacione të rëndësishme nga gjetjet që janë bërë falë robotit “Curiosity”, që endet prej vitit 2012 në sipërfaqen e Marsit.

Të enjten, Agjencia Amerikane e Hapësirës shoi kureshtjen e të gjithëve përmes një deklarate të gjatë e shkencore, që vetë studiuesit e NASA-s, e cilësojnë një prej zbulimeve më emocionuese të bëra deri më tani në sipërfaqen e “Planetit të Kuq”.

Sipas NASA-s, Curiosity ka zbuluar materie organike në sipërfaqen e Marsit, një zbulim që përforcon akoma më shumë bindjen mes shkencëtarëve se dikur ky planet kishte jetë.

Megjithatë, skeptikët thonë se zbulimi jo domosdoshmërisht do të thotë se Marsi ka qenë dikur shtëpi e një forme jete aliene, apo që mund të jetë ende një e tillë, por rezultatet mirëpritur edhe prej tyre.

“Mundësitë për të gjetur shenja jete antike në Mars në misionet e së ardhmes sapo na u shtuan”, deklaroi i emocionuar Ashwin Vasavada, shkencëtar në projektin Curiosity.

Ekspertët kërkojnë që të shkohet më tej dhe puna

të përqendrohet tek kërkimet e gjetjes së formave të jetës aktuale në Mars, që sipas tyre, mund të ekzistojnë ende në forma mikroskopike.


“Me këtë zbulim, Marsi na thotë që të vazhdojmë punën kërkimore për gjetjen e formave të jetës. Jam i bindur që në misionet e së ardhmes do të zbulojmë të tjera të dhëna më të emocionuese për Planetin e Kuq”, thotë Thomas Zurbuchen, shkencëtar i NASA-s.

Materiet organike janë mbetje që krijohen vetëm nga forma jete dhe zbulimi për ekzistencën e tyre në Mars është bërë nga dy grupe të ndryshme shkencëtarësh, që në fund kanë arritur në të njëjtin rezultat.

Tashmë, puna e shkencëtarëve do të bazohet tek përpjekjet për të tërhequr në Tokë mostra të këtyre mbetjeve organike, për t’iu nënshtruar analizave më të detajuara, që do të shpjegojnë prejardhjen dhe formën e organizmit që ka lënë pas këto gjurmë.

Aktualisht, sipërfaqja e Marsit është e pabanueshme, por shkencëtarët besojnë fort se miliona vite më parë ai ka qenë i populluar dhe këto pretendime i bazojnë tek gjurmët e lëna nga lumenjtë që dikur besohet se rridhnin në sipërfaqen e tij.





O Zoti ynë!
Mos lejo që zemrat
tona të shmangen
(nga e vërteta), pasi na
ke udhëzuar në
rrugën e drejtë,
dhe jepna mëshirë
prej Teje;
vërtet, Ti je
Dhuruesi i Madh!

(Âl 'Imran, 8)